


2017-2020

RAPORTI 4-VJEÇAR I ZBATIMIT

TË AGJENDËS KOMBËTARE
PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Prill 2021



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E SHëndetësisë
DHE MBROJTJES SOCIALE

Ky dokument është përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë. Dokumenti është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, me ekspertizën dhe asistencën teknike të UNICEF-it në Shqipëri, ofruar përmes Organizatës 'Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve'. Kjo mbështetje është siguruar përmes Fondit të Përsheptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB Shqipëri. Mendimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi e institucioneve raportuese dhe nuk pasqyrojnë ato të Kombeve të Bashkuara dhe të UNICEF-it në Shqipëri.



Norwegian Embassy



2017-2020

RAPORTI 4-VJEÇAR I ZBATIMIT

TË AGJENDËS KOMBËTARE
PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Përmbajtja

SHKURTIME	5		
HYRJE	8		
METODOLOGJIA	11		
ZËRI I FËMIJËVE	15		
SHTYLLA STRATEGJIKE 1:			
<i>Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve</i>	18		
OBJEKTIVI 1: Përmirësimi i funksionimit të mekanizmave për të drejtat e fëmijëve	20		
OBJEKTIVI 2: Avancimi i të drejtave të fëmijëve, si pjesë e agjendës kombëtare	26		
SHTYLLA STRATEGJIKE 2:			
<i>Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve</i>	32		
OBJEKTIVI 3: Përmirësimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për një sistem të integruar dhe të efektshëm të mbrojtjes së fëmijëve	34		
OBJEKTIVI 4: Përmirësimi i aksesit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve	42		
SHTYLLA STRATEGJIKE 3:			
<i>Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët</i>	56		
OBJEKTIVI 5: Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (0 – 6 vjeç)	57		
OBJEKTIVI 6: Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit në arsim për fëmijët në arsimin bazë	60		
OBJEKTIVI 7: Përmirësimi i mekanizmave për mjedise gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar	64		
OBJEKTIVI 8: Përmirësimi i proceseve demokratike në shkolla	67		
OBJEKTIVI 9: Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në drejtësi	70		
		OBJEKTIVI 10: Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor për foshnjat dhe fëmijët	77
		OBJEKTIVI 11: Krijimi i një mjedisi mbështetës për ofrimin e praktikave optimale të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve	82
		OBJEKTIVI 12: Përmirësimi i sistemit shëndetësor dhe shërbimeve që ofrohen për adoleshentët, duke i bërë ato miqësore për ta	85
		OBJEKTIVI 13: Fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve për të ofruar mbrojtje dhe përkujdes shoqëror më të mirë ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë	88
		OBJEKTIVI 14: Fuqizimi i familjes për të trajtuar rreziqet dhe pasojat e varfërisë, si dhe parandaluar ndarjen e fëmijës nga familja	95
		SHTOJCA	100
		Lista e institucioneve raportuese	101

Shkurtime

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve	NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar	NJVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive	OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
AP	Avokati i Popullit	OJF	Organizata Jofitimprurëse
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve	OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
BE	Bashkimi Evropian	PAK	Personat me Aftësi të Kufizuar
CRCA	Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri	PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
DRSH	Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë	PSV	Procedurat Standarde të Veprimit
GDMF	Grupi i Deputeteve 'Miqte e Fëmijëve'	SC	Save the Children
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial	SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
INSTAT	Instituti i Statistikave	SHQK	Shkolla si Qendër Komunitare
IPSH	Institucione të Përkujdesit Shoqëror	TDH	Terre des Hommes
IZHA	Instituti për Zhvillimin e Arsimit	UNICEF	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
KDF	Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve	UNHCR	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
KIE	Këshilli i Evropës	IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migrimit
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve	FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
KKMDF	Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve	UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	WV	World Vision Albania
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MB	Ministria e Brendshme		
MBU	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit		
MD	Ministria e Drejtësisë		
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale		
MEPJ	Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme		

Fjala përshëndetëse



Të dashur bashkëpunetorë,

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 si një dokument i qeverisë shqiptare tashmë i konsoliduar, pasqyron tërësinë e veprimeve për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim me të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor, nisur gjithnjë nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Për herë të parë në procesin e realizimit të Agjendës, ne patëm edhe përfshirjen e fëmijëve, të cilët kanë dhënë një kontribut të vyer, përmes mendimeve dhe sugjerimeve, për procese që lidhen me jetën e tyre, duke i dhënë kështu një vlerë të shtuar këtij dokumenti të rëndësishëm.

Dua të shpreh vlerësimin dhe mirënjohjen për hartimin e Raportit të vlerësimit në përfundim të dokumentit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, i cili paraqet jo vetëm punën që ka bërë Ministria e

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për të gjitha insitucionet tona në të gjitha nivelet.

Një falenderim të veçantë, kam për të gjitha organizatat që punojnë me fëmijët dhe për fëmijët, për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në çdo fushë të lidhur me mirëqenien dhe interesin më të lartë të çdo fëmije.

Përmes këtij raporti është sjellë jo vetëm informacion, si një detyrim institucional, por është pasqyruar gjithë puna e bërë, në realizimin e objektivave të përcaktuara. Përmes një analize në mënyrë të detajuar dhe profesionale, janë nxjerrë në pah edhe sfidat e ndeshura, të cilat do të adresohen në dokumentin e ri që do të hartohet në vazhdimësi, për të cilat është i nevojshëm kontributi i të gjithë aktorëve të fushës.

Situata që po kalojmë është vërtet një sfidë e jashtëzakonshme, e cila kërkon jo vetëm angazhimin e një tëresie burimesh financiare, infrastrukturore e njerëzore, apo ekspertize të veçantë për përballimin e të papriturave, por edhe mirëkuptimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin

e të gjitha insitucioneve, organizatave dhe komunitetit në tërësi.

Në rrugën drejt së ardhmës akoma më të mirë, duke i konsideruar fëmijët të parët, nëpërmjet pjesëmarrjes së bashku me ta, do të bashkojmë përpjekjet tona për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, për të përballuar sfidat që kemi përpara, për të garantuar suksesin në betejat për sigurinë e shëndetit dhe mbrojtjen e jetës e të ardhmës së fëmijëve dhe familjeve tona. Së bashku, do të bëjmë të mundur që fëmijët të jetojnë në një vend akoma më të sigurtë dhe më të mirë, ku mund të zhvillojnë të gjithë potencialet e tyre, duke siguruar njëkohësisht dhe burimet e duhura për mirëqenien e familjeve të tyre.

Ogerta Manastirliu

Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



Hyrje

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 (tani e tutje, referuar si Agjenda), është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 372, dt. 26.04.2017. Agjenda përbën një dokument strategjik, vizioni i të cilit është të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe psiko-social të fëmijëve, për përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha proceset, nëpërmjet mbrojtjes dhe promovimit të efektshëm të të drejtave të fëmijëve, duke u mbështetur në parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të tyre.

Agjenda është hartuar nën frymën e:

- Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF);
- Rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve në Kombet e Bashkuara;
- Strategjisë së Këshillit të Evropës (KiE) për të Drejtat e Fëmijëve 2012 – 2015 dhe 2016 – 2021;
- Agjendës së Bashkimit Evropian (BE) për të Drejtat e Fëmijëve.

Agjenda e aprovuar në vitin 2017 përmbledh një total prej 265 masash dhe 75 treguesish të rezultateve, që janë parashikuar për realizimin e 14 objektivave, të ndara sipas tri shtyllave strategjike të përshkuara më poshtë. Gjatë raportimit afatmesëm numri i masave dhe treguesve u rishikua nga institucionet përgjegjëse, duke vajtur në 287 dhe 76 respektivisht.

Në këtë raport raportohet për progresin e 287 masave dhe 76 treguesve.

Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Agjenda synon përfundimin e kuadrit rregullator dhe institucional, duke përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues; përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve, në mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika të efektshme; si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendimmarrje.

Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve.

Agjenda synon ngritjen e një sistemi të integruar dhe të efektshëm për mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional, të përmirësuar ndjeshëm.

Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve: zhvillimi, arsimimi, drejtësia, shëndeti, ushqyerja dhe mbrojtja sociale

Në këtë aspekt, është synuar, më së shumti, evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

Në përputhje me autoritetin që i jep Ligji 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës", si edhe detyrimet e përcaktuara në Agjendë, Ministria e Shëndetësisë

dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) bashkërendoi procesin e monitorimit të zbatimit të Agjendës për vitet 2017-2020. Procesi u mbështet nga UNICEF-i në Shqipëri, i cili përmes Organizatës 'Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve', mundësoi ekspertizën teknike për hartimin e metodologjisë, si dhe analizimin paraprak të informacionit, raportuar nga institucionet përgjegjëse.


Raporti paraqet ecurinë e zbatimit të Agjendës për periudhën 2017 –2020, duke analizuar progresin 4-vjeçar të punës së institucioneve përgjegjëse dhe partnerëve të tyre për zbatimin e masave të miratuara. Raporti u hartua mbështetur në të dhënat e mbledhura nga institucionet e nivelit qendror dhe vendor në të gjithë vendin, si dhe nga konsultimet me grupet e interesit, ku përfshihen edhe shoqëria civile dhe grupet e fëmijëve.

Raporti është strukturuar në mënyrë të tillë që të japë informacion të hollësishëm për çdo objektiv të Agjendës, si edhe përmbledhje të informacionit kryesor në nivel shtyllash strategjike. Sfidat e hasura në realizimin e masave të planifikuara dhe reflektimet e institucioneve raportuese janë integruar në secilin objektiv.


Në total, institucionet kanë raportuar progresin në realizimin e treguesve të rezultatit, siç paraqiten edhe në mënyrë të përmbledhur në grafikun 1.

Të dhënat e grumbulluara nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror e vendor japin informacion për 269 prej 287 masave të parashikuara në Agjendë, sipas ndarjes së treguar në grafikun 2.

GRAFIKU 1. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVETË REZULTATEVE (NË %)




GRAFIKU 2. NIVELI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË %)



Ecuria e progresit të masave të raportuara shprehet si më poshtë në grafikun 3.

GRAFIKU 3. STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT PËR 2017 - 2020 (NË %)



Sa u përket **parashikimeve financiare/buxhetore**, raporti analizon shpenzimet faktike të periudhës 2017-2020, të kryera në funksion të zbatimit të Planit të Veprimit të Agjendës. Raporti synon të analizojë lidhjen që ekziston midis parashikimit të shpenzimeve buxhetore të Planit të Veprimit dhe shpenzimeve faktike të kryera nga burimet e ndryshme të financimit.

Përfundime kryesore që dalin nga analiza listohen më poshtë:

- Sipas raportimeve, për periudhën 2017-2020, shpenzimet faktike për zbatimin e planit të veprimit, në ato masa veprimi që janë të buxhetuara dhe janë raportuar të realizuara, arrijnë në shifrën e rreth 1159 milionë lekëve. Realizimi i shpenzimeve për këto masa është në nivelin **86.9%**.
 - 58.8% e shpenzimeve faktike të raportuara janë mbuluar nga fonde të buxhetit të shtetit dhe 41.2% nga fonde të donatorëve.
 - Shpenzimet faktike të realizuara për periudhën 2017-2020 janë sa **71.1%** e shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara për zbatimin e Planit të Veprimit.
- Shpenzimet faktike të mbuluara nga buxheti i shtetit për zbatimin e veprimtarive të periudhës 2017-2020 janë sa **81.4%** e shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara për t'u mbuluar nga buxheti i shtetit për zbatimin e masave të Agjendës.
 - Realizimi i shpenzimeve ndryshon sipas objektivave, duke filluar nga 39.1% (nën-realizim) deri në 124.7% (mbi-realizim).

Metodologjia

Raporti prezanton një analizë të përmbledhur të cilësisë së zbatimit të aktiviteteve të Agjendës gjatë periudhës 2017 – 2020, administrimin e burimeve dhe rezultatet e arritura. Raporti përmban një pasqyrë të ndërhyrjeve dhe masave të marra nga qeveria shqiptare, në bashkëveprim me bashkëpunëtorët e saj institucionalë, partnerët ndërkombëtarë dhe organizatat e shoqërisë civile, duke marrë parasysh dhe ndryshimet apo përshtatjet e kryera gjatë 4 viteve, të ardhura si nevojë e zhvillimeve më të fundit në vend.

Në vijim të bashkëpunimit tashmë disaveçar, edhe në këtë proces, MSHMS-ja pati mbështetjen e UNICEF-it në Shqipëri për të ndërmarrë të gjithë hapat e duhur për përgatitjen e këtij raporti.

Në total, rreth 21 institucione përgjegjëse në nivel qendror, 42 Njësi të Qeverisjes Vendore (NjQV) dhe 10 organizata ndërkombëtare dhe kombëtare kanë dorëzuar informacionin mbi të cilin është hartuar ky raport.

Për të pasur një pasqyrim sa më të qartë të realitetit, përfshirë këtu progresin dhe sfidat e ndeshura, u studiuuan dhe vlerësuan një sërë

raportesh të tjera të botuara gjatë kësaj periudhe në Shqipëri. Përpunimi i informacionit të mbledhur u mbështet në vlerësimin dhe krahasimin e tij në raport me matjet fillestare (baseline) të kryera në fazën e hartimit të Agjendës, përkundrejt synimit afatmesëm (2018), si dhe atij afatgjatë (2020).

Kështu, raporti integron edhe gjetjet e paraqitura në Raportin Afatmesëm të Zbatimit të Agjendës.

Për të siguruar vijimësi metodike në raportimin nga institucionet, informacioni i marrë gjatë 2017 – 2018-s u pasurua me informacionin e marrë gjatë 2019 – 2020-s, për të cilin u përdorën të njëjtët instrumente. Gjatë monitorimit afatmesëm të zbatimit të strategjisë, instrumenti i raportimit të ecursisë së zbatimit të masave përfshiu një seksion ku çdo institucion përgjegjës vlerësonte nevojën për rishikim të masës dhe ofronte sugjerimin përkatës, përfshirë periudhën kohore të rishikuar të realizimit. Në këtë mënyrë, instrumenti i vlerësimit përfundimtar të zbatimit të Agjendës përmban edhe masat e rishikuara/sugjeruara dhe mat realizimin përkundrejt këtij rishikimi.

Procesi për hartimin e raportit kaloi përmes fazave të mëposhtme:

MBLEDHJA E INFORMACIONIT PËR REALIZIMIN E MASAVE TË VEPRIMIT TË AGJENDËS

Për të raportuar mbi zbatimin e masave të parashikuara në Agjendë, u hartua një model instrumenti, i cili identifikon të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitet 2017-2020. Për secilin aktivitet, instrumenti iu kërkon institucioneve të raportojnë statusin e realizimit/zbatimit të aktivitetit, sfidat dhe problematikat e ndeshura gjatë zbatimit, aktorët e përfshirë në zbatim, si edhe informacionin mbi shpenzimet e kryera. Instrumentet u përshtatën për secilin institucion, për të dyja etapat e raportimit që parashikohet të ketë një rol udhëheqës ose bashkëveprues, përgjatë zbatimit të Agjendës.

U kërkua që statusi i realizimit dhe zbatimit të aktiviteteve të raportohet sipas disa kategorive të sqaruara në tabelë. Kjo u bë për të siguruar një harmonizim midis raportimit narrativ të veprimtarisë dhe vlerësimit të progresit në zbatimin e aktivitetit prej institucionit raportues.

LEGJENDA E VLERËSIMIT TË PROGRESIT TË ZBATIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT

Legjenda	Shpjegimi
Realizim	Aktiviteti ka përparuar sipas parashikimeve (rezultate dhe afate kohore).
Progres	Zbatimi i aktivitetit ka filluar, por nuk ka përparuar sipas planit (rezultate dhe/apo afate kohore).
Alternim	Aktiviteti ka pësuar ndryshime apo shtesa nga parashikimi/ Zbatimi i aktivitetit të ri ka filluar apo ka përfunduar.
Shtyrje	Zbatimi i aktivitetit është shtyrë, por mbetet domethënës.
Mosrealizim	Aktiviteti nuk do të ndërmerret.

SFIDAT E IDENTIFIKUARA

Jo të gjithë institucionet përgjegjëse, si në nivel qendror dhe atë vendor, kanë raportuar mbi zbatimin e masave, duke sjellë boshllëqe në paraqitjen reale të nivelit të realizimit. Është për t'u vlerësuar përpjekja e shtuar e NjQV-ve, duke pasur parasysh faktin që, në fazën e raportimit 4-vjeçar, raportuan dyfishi i atyre që e bënë këtë në raportimin afatmesëm. Gjithsesi, raportimi i plotë në nivel vendor nuk është bërë i mundur.

Institucionet raportuese, në shumicën e rasteve, kanë dhënë një informacion të përciptë për ecurinë e Masave të Veprimit, duke krijuar vështirësi në analizimin real të situatës. Përgjithësisht, informacioni, brenda një objektivit, është i fragmentuar, duke pasqyruar kështu qasjen sektoriale në zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

Edhe pse u nxit raportimi përtej masave të planifikuara në Agjendë, institucionet nuk e kaluan këtë kufi raportimi, duke iu përmbajtur vetëm kornizës së Agjendës aktuale. Kjo mund të lidhet me ngarkesën e shtuar të raportimit, mungesën e bashkërendimit brenda institucioneve për të mbledhur informacion nga të gjithë departamentet përkatëse, etj.

Ajo që del e dukshme nga procesi i monitorimit të Agjendës është mungesa e një qasjeje të strukturuar të institucioneve raportuese dhe përfshirjeje të tyre të vazhdueshme në hartimin, monitorimin dhe raportimin e strategjive ndërsektoriale. Disa herë është ngritur shqetësimi nga institucionet se masat e përfshira janë ose të

panjohura për ta, ose nuk kanë lidhje me to, edhe pse vete Agjenda është hartuar në bashkëpunim dhe konsultim me ta.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT MBI TREGUESIT E REZULTATIT

Agjenda përmban 76 tregues rezultati, mes tyre, tregues të profilit ndërsektorial/të përbërë, për të cilët kërkohet raportimi i disa ministrive apo institucioneve, si dhe tregues të thjeshtë, pra, sektorialë, ku kërkohet raportimi i një sektori.

Për të mbledhur informacion mbi progresin e arritur të treguesve, u hartuan instrumente që iu përkushtohen secilit institucion përgjegjës për të raportuar. Instrumentet, përpos kërkesës për të dhënë informacion për vlerën numerike dhe statistikore, apo shpjegim narrativ, kërkojnë informacion të klasifikuar si në tabelën e mëposhtme:

I arritur	Targeti i synuar është arritur.
Pjesërisht i arritur	Arritja e targetit kundrejt atij të synuar është në proces - shpjegoni më tej në kolonën e komenteve.
I paarritur	Targeti nuk është arritur - shpjegoni më tej në kolonën e komenteve arsyet e mosarritjes.
I pamatur	Në rastet kur kanë munguar të dhënat për matjen e treguesit, shënohet "I pamatur" dhe, në kolonën e komenteve, qartësohen arsyet e mosmatjes së treguesit.

SFIDAT E IDENTIFIKUARA

- 71% e treguesve nuk përmbajnë informacion për matjet fillestare (vlera të baseline);
- 81% e treguesve nuk kanë, të paktën, një nga vlerat, matjen fillestare apo targetin e synuar;
- 12% janë të pamatshëm/të paraportueshëm.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT PËR SHPENZIMET FINANCIARE

Informacioni financiar përfshin shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike¹ për periudhën 2017-2020, në funksion të zbatimit të çdo veprimtarie, si dhe burimet e financimit. Institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Agjendës iu është kërkuar informacion për çdo masë të planifikuar. Informacioni i grumbulluar për shpenzimet faktike për masat e raportuara të realizuara² është paraqitur në këtë raport, sipas objektivave që vijojnë:

- Shpenzime faktike, të kryera nga të gjitha burimet e financimit;
- Realizimi i shpenzimeve kundrejt shpenzimeve të planifikuara;
- Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit (buxheti i shtetit apo financime të donatorëve);
- Në këtë raport, nuk janë raportuar shpenzime faktike për masat e mosrealizuara.

1. Shpenzime faktike -shuma totale e parave që institucionet qendrore, institucionet e pavarura dhe Bashkitë kanë shpenzuar në një vit financiar (p.sh Janar-Dhjetor 2017) për zbatimin e Agjendës

2. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet realizimit të veprimeve në kuadër të masës së përcaktuar

SFIDAT E IDENTIFIKUARA

- Buxheti i nevojshëm për zbatimin e Planit të Veprimit nuk është zbrëthyer për çdo vit buxhetor, por shifrat janë parashikime, që mbulojnë të gjithë periudhën e zbatimit. Kjo mënyrë paraqitjeje iu krijon vështirësi institucioneve përgjegjëse dhe grupeve të interesit në monitorimin vit pas viti të shpenzimeve të planifikuara dhe ato faktike.
- Agjenda është miratuar me VKM nr. 372, datë 26.04.2017. Në Planin e Veprimit të Agjendës janë përfshirë, gjithashtu, edhe veprimtari që duhet të zbatoheshin në vitin 2016. Raporti pasqyron informacion për shpenzimet e planifikuara dhe shpenzimet faktike vetëm për periudhën 2017-2020, pasi, vetëm për këtë periudhë, mund të krahasojmë planin me faktin.
- Për 18% të masave të planifikuara (në fillim dhe në fazën e rishikimit afatmesëm) nuk është planifikuar buxhet. Për këto masa, është e vështirë të identifikohet kostoja, pasi kjo do të kërkonte një analizë të re, të mbështetur në targetet e planifikuara.
- 83 masa të kostuara, ose **35.6%** e totalit të masave të kostuara, raportohen të porealizuara nga institucionet.
- Për 4 masa të buxhetuara, ose 1.5% të tyre, institucionet kanë raportuar shpenzime faktike më të mëdha sesa kostoja e planifikuar. Këto raste janë të lidhura me shpenzime faktike të raportuara nga OJF-të dhe donatorët, ku shpenzimet faktike e tejkalojnë koston e planifikuar gjatë hartimit të planit.



Foto kredit: UNICEF/Albania

Zëri i Fëmijëve

Ndër grupet e interesit të konsultuar mbi zbatimin e masave të Agjendës, vëmendje e veçantë iu kushtua marrjes së mendimit nga vetë fëmijët.

Së pari, gjatë fazës së raportimit afatmesëm (2017 – 2018), u organizuan 6 seanca konsultimi në 4 qytete të Shqipërisë, Tiranë (zona Bathore), Shkodër, Dibër e Korçë, me pjesëmarrjen e 106 fëmijëve-nxënës të shkollave, me përfshirjen edhe të fëmijëve më aftësi të kufizuara dhe fëmijëve të pranishëm në institucione rezidenciale (Shkodër). Konsultimi ka respektuar elementet etike dhe standardet e sigurisë së fëmijëve në mbledhjen e të dhënave. Konsultimi ishte i informuar, vullnetar dhe i lehtësuar nga persona që u janë përbajtur të gjitha vlerave morale e profesionale dhe me përvojë në punën me fëmijët.

Së dyti, gjatë përgatitjes së këtij raporti përfundimtar, referencë i bëhet botimit nga UNICEF-i në Shqipëri³, që shqyrton një sërë dokumentesh të hartuara me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe përmbledh mendimet e tyre për çështje kryesore në jetën e tyre. Më poshtë, paraqiten fushat për të cilat fëmijët raportojnë

privimet më të mëdha dhe shkeljet e të drejtave të tyre, përkundrejt dëshirës për të parë më shumë realizime dhe përpjekje nga ana e të rriturve përgjegjës në këtë drejtim.

EDUKIMI MBITË DREJTAT

- Fëmijët theksojnë se institucione/aktorët përgjegjës duhet të bëjnë shumë më tepër për ta bërë informacionin dhe shërbimet më miqësore për fëmijët, duke marrë parasysh dhe vënë në jetë edhe këshillat e vetë fëmijëve.
- Fëmijët kanë nevojë t'iu lehtësohen/ mundësohen akses/qasja në informacion të përshtatshëm me moshën dhe aftësitë e tyre.
- Fëmijët shprehën se dokumente të rëndësishme - si Agjenda Kombëtare për Fëmijët, Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, roli dhe detyrat e institucioneve në realizimin e të drejtave të fëmijëve - duhet të njihen mirë nga të rriturit e çdo sektori dhe të shtrihet njohuria edhe tek fëmijët.
- Shërbimet e Avokatit të Popullit të promovohen më mirë tek fëmijët/adoleshentët, në mënyrë që ata të kenë mundësi t'i marrin ato në rast nevojë.

3. w.unicef.org/albania/documents/child-rights-issues-child-participatory-focussed-documents

VARFËRIA / PËRJASHTIMI

- Fëmijët përshkruajnë varfërinë si arsyen kryesore të përjashtimit/izolimit të tyre nga shoqëria (shokët/shoqet).
- Ata theksojnë ndikimin e varfërisë që i detyron fëmijët të punojnë dhe, në këtë mënyrë, të largohen nga shkolla, si dhe rrezikun për t'i çuar ata në krim apo sjellje të rrezikshme.
- Disa fëmijë përmendin se të ardhurat në familjen e tyre janë zvogëluar gjatë pandemisë Covid-19 dhe shprehin frikën e rritjes së vështirësive ekonomike në të ardhmen.

PJESËMARRJA / QASJA NË INFORMACION

- Fëmijët dëshirojnë të mësojnë më shumë mbi të drejtat e tyre, por të njëjtën njohuri duhet ta marrin dhe të rriturit, qofshin ata prindërit, mësuesit, kujdestarët apo ofruesit e shërbimeve.
- Fëmijë të moshave të ndryshme kanë informacion të paqartë lidhur me të drejtat dhe shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve, gjë që ka çuar në mungesën e besimit tek autoritetet përgjegjëse dhe mundësi më të pakta për të ngritur pretendime mbi të drejtat e tyre.
- Fëmijët shprehin të shqetësuar se të rriturit nuk i marrin seriozisht pikëpamjet e tyre dhe se ata nuk janë në gjendje të ndikojnë në vendimet e rëndësishme të jetës së tyre, si në familje, shkolla, kontekstin e pushtetit qendror dhe atë vendor.
- Pjesa më e madhe e fëmijëve shprehin se e shohin të ardhmet e tyre vetëm jashtë Shqipërisë.

- Veçanërisht, fëmijët me aftësi të kufizuara ndihen të veçuar, kërkojnë pjesëmarrje dhe të kenë qasje në internet.
- Fëmijët mendojnë se ka ende punë për të bërë për të fuqizuar struktura si Qeverinë e Nxënësve dhe për t'i bërë ato funksionale në përcjelljen e mendimeve të të gjithë fëmijëve në proceset vendimmarrëse të shkollës.

MBROJTJA, VEÇANËRISHT, NDAJ BULLIZMIT DHE DHUNËS

- Fëmijët shprehin se mungesa e informacionit për mbrojtjen e fëmijëve shton rrezikun ndaj tyre. Ata mendojnë se dhuna është e përhapur në Shqipëri dhe shprehin shqetësim për pasojat e saj. Fëmijët kërkojnë që vetëdija e të rriturve për efektet e dhunës të rritet.
- Fëmijët janë të vetëdijshëm për rreziqet në internet dhe shumica (vajzat më shumë se djemtë), që kanë qenë dëshmitarë të dhunës dhe abuzimit në internet, ishin të mërzitur nga kjo.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara, ose pa kujdes prindëror, janë më të shqetësuar se të tjerët për rrezikun në internet.
- Prania e formave të ndryshme të dhunës dhe pasiguria që kanë në kontekste të ndryshme, përfshirë shkollat, raportohet nga fëmijët si një çështje që kërkon vëmendje të veçantë. Fëmijët raportojnë për dinamika shqetësuese marrëdhëniesh mes vetë fëmijëve, të cilat jo gjithmonë identifikohen apo trajtohen nga trupa mësimore.
- Jo të gjithë fëmijët janë në dijeni të faktit që në shkollë ka një psikolog⁴.

4. Nga aktivitetet e zhvilluara nga Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" në shkolla

LOJA DHE KOHA E LIRË

- Fëmijët mendojnë se nuk ka hapësira të mjaftueshme publike dhe mjedise sportive për argëtimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete sportive.
- Kur u pyeten për internetin, fëmijët thanë se e konsiderojnë atë si një nga të paktat opsione që kanë për të kaluar kohën e lirë.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara dëshirojnë të kenë mundësinë dhe kushtet për t'u përfshirë më tepër në aktivitete në kohën e tyre të lirë.
- Fëmijët në institucione të kryerjes së dënimeve mendojnë se iu ofrohet mjaftueshëm kohë për t'u marrë me ushtrime fizike.

ARSIMI

- Fëmijët shprehen se duhen më shumë shkolla të mirëpajisura me kushte më të mira mësimore dhe mësues që kanë aftësitë e duhura të mësimdhënies.
- Fëmijët theksojnë problemet e dhunës në shkolla. Ata shprehën se shkollat duhet të bëjnë më shumë për të bërë të disponueshëm informacionin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara dëshirojnë mundësi të njëjta për vazhdimin e arsimit.
- Fëmijët në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale raportuan mundësi të pamjaftueshme arsimimi dhe trajnimi.



Foto kredit: UNICEF/Albania

SHTYLLA STRATEGJIKE 1

Mirëqeverisja në
funksion të promovimit,
respektimit dhe
mbrojtjes së të drejtave
të fëmijëve

1
Objektivi


2
Objektivi

SHTYLLA STRATEGJIKE 1 NË SHIFRA


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (në nr. & %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në nr. & %)



MASAT E BUXHETUARA DHE TË RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në nr. & %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ⁵	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ⁶	83,207,500	92.5%	86,962,199	104.5%	62.9%	37.1%
2 Mosrealizim ⁷	6,749,500	7.5%	-	-		
Gjithsej	89 957 000	100.0%	-	-		

5. Përqindjet janë rumbullakosura

6. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

7. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

OBJEKTIVI 1

Përmirësimi i funksionimit të mekanizmave për të drejtat e fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Zbatimi i Agjendës njih arritje të qenësishme në drejtim të plotësisë të kuadrit ligjor dhe të politikave që synojnë promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në të gjithë sektorët: drejtësi, shërbime shoqërore, arsim, shëndetësi dhe kulturë.

Me miratimin e Ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”⁸, si dhe të 18 akteve të tij nënligjore (5 Vendime të Këshillit të Ministrave dhe 13 Udhëzime⁹), të cilat e bëjnë atë zbatueshëm nga institucionet përkatëse, si në nivel qendror dhe në atë vendor, është plotësuar kuadri ligjor për të drejtat e fëmijëve. Risia dhe përparësia që ka sjellë ligji i ri është mandati i qartë i strukturës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMF), mekanizmi vendor i parashikuar po ashtu nga ligji 18/2017 për identifikimin dhe administrimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në marrjen e masave të mbrojtjes dhe në administrimin e rastit, duke mbushur kështu një

hendek të mëparshëm ligjor e funksional. Përmes tij, është arritur një fuqizim i rolit të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) si pjesë e strukturës së Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), si dhe është përcaktuar standardi minimal për 1 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve për çdo 3 000 fëmijë banorë.

Paketa e akteve nënligjore të parashikuara nga ligji në fjalë shtjellon konkretisht mënyrat e funksionimit, rolet dhe përgjegjësitë e mekanizmave qendrorë të mbrojtjes së fëmijëve; mbledhjen dhe administrimin e informacionit, mënyrën dhe fushat e raportimit për çështje të mbrojtjes së fëmijëve nga ana e PMF-ve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve; ngritjen dhe mënyrat e funksionimit, rolet dhe përgjegjësitë e grupeve teknike ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve; procedurat standarde të veprimit, rolet dhe përgjegjësitë e strukturave vendore dhe qendrore në administrimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, etj.

8. Link

9. Link

Në përputhje me Ligjin 18/2017, me urdhër të Kryeministrit nr. 40, dt. 01.03.2018, është ngritur Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili, tashmë, ka nisur nga puna dhe ka realizuar katër takime gjatë të cilave është miratuar Udhëzimi për 'Zgjedhjen e përfaqësuesve të fëmijëve në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve', diskutuar dhe vlerësuar raporti i ndërmjetëm i zbatimit të Agjendës Kombëtare për Fëmijët, si dhe është diskutuar Projekt-plani i Veprimit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge, 2019 – 2021. Në përbërje të Këshillit Kombëtar, ka përfaqësues të shoqërisë civile dhe të fëmijëve, të cilët kanë një status vëzhguesi gjatë mbledhjeve të Këshillit. Në këtë kuadër, është miratuar, gjithashtu, një Udhëzim specifik për përfshirjen e fëmijëve në Këshillin Kombëtar.

Është hartuar dhe miratuar Ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"¹⁰, i cili ka sjellë një qasje të re në sistemin e drejtësisë, duke vënë në qendër të miturin, duke forcuar kështu sistemin e drejtësisë, në përputhje me parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF) dhe me standardet e normat ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt me ligjin, mbështetur në interesin e tyre më të lartë. Në zbatim të Kodit, janë miratuar **gjashtë** Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), **nëntë** urdhra dhe udhëzime të Ministrit të Drejtësisë, si dhe një projekt-vendim, duke

garantuar në këtë mënyrë, mbrojtjen e fëmijëve. Ligji nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"¹¹ mundëson qasje të fëmijëve në situata vulnerabël në programet e strehimit social, ndërsa Ligji Nr. 111/2017 "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti"¹² synon ofrimin e shërbimeve profesionale, që mundësojnë ndihmë ligjore për grupet vulnerabël, duke përfshirë këtu, fëmijët në kontakt me ligjin dhe fëmijët që janë nën kujdes alternativ.

Në fushën e Arsimit Parauniversitar, është rishikuar Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, nr. 69/12 i ndryshuar. Gjatë këtij rishikimi, është vlerësuar nevoja për përmirësime të tij në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe të gjithë legjisllacionit tjetër që lidhet me fëmijët. Është plotësuar kuadri ligjor edhe me 5 VKM të reja, të cilat synojnë lehtësimin e aksesit në arsimin parauniversitar të fëmijëve nga të gjitha shtresat e cenuara. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) ka hartuar rregullisht, me një shpeshtësi çdo dy vjet, raporte të analizës së buxhetit dhe të shpenzimeve për fëmijët, të përfshira në projektbuxhetin për arsimin dhe të botuara në buxhetin e MASR-së, në faqen e internetit.

Ligji nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" është pasuar nga hartimi dhe miratimi i, të paktën, 8 VKM-ve dhe një sërë udhëzimeve¹³, të cilat përcaktojnë standarde të shërbimeve të kujdesit

10. Link

11. Link

12. Link

13. Link

shoqëror, përfshirë atyre me fokus familjen dhe fëmijët.

Është miratuar Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025¹⁴, me objektiv specifik për edukimin përmes kulturës. Ministria e Kulturës, mbështetur në programin qeverisës, ka ndër politikat përparësore edhe edukimin artistik, përfshirë atë të fëmijëve. Gjatë periudhës së raportimit, ka rritje të numrit të veprimtarive ndërgjegjësuese/ edukuese, artistike përmes promovimit të industrive krijuese në rang vendi. Në këtë linjë, Ministria e Kulturës, vit pas viti, çel thirrjen publike për projektpropozime në fushat projekt- art-kulturë dhe trashëgimi kulturore, nga të cilat, pas miratimit të tyre, 30% e projekteve fituese janë me fokus edukimin përmes art-kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Gjatë 2019-s, Ministria e Kulturës ndër mori dhe konkretizoi realizimin për herë të parë të projektit “Fondi i Krijimtarisë Letrare për Fëmijë”, në të cilën u përzgjedhën, kundrejt një gjykimi të paanshëm dhe profesional, emra autorësh të spikatur në fushën e letërsisë.

Në lidhje me mbledhjen dhe administrimin e të dhënave mbi gjendjen e zbatimit të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe, në zbatim të VKM-së Nr. 636, Agjencia ka mbledhur rregullisht të dhënat statistikore vjetore nga institucionet përkatëse. Për të nxitur përdorimin e treguesve nga aktorët e interesuar, Agjencia, në bashkëpunim me UNICEF-

in, ka përfunduar ndërtimin e një platforme dixhitale online për vizualizimin e treguesve, e cila mendohet të vihet në funksion brenda fundit të 2020-s.

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave në nivel kombëtar është përmirësuar me miratimin e Ligjit 17/2018 “Mbi Statistikat Zyrtare”¹⁵. Ky ligj fuqizon rolin e INSTAT-it, i cili siguron se çdo agjenci që prodhon statistika zyrtare përdor standardet, përcaktimet, klasifikimet dhe metodologji të Kombeve të Bashkuara dhe Eurostat-it.

INSTAT-i, gjatë vitit 2019, ka bërë përmirësimin e treguesve për mbrojtjen e fëmijëve sipas instrumentit TRANSMONEE dhe raporton në mënyrë vjetore sipas pyetësorëve specifikë pranë Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, është bërë e mundur prodhimi i Modullit të Treguesve të Fëmijëve, në bashkëpunim me UNICEF-in, “Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri, periudha 2016 – 2018”¹⁶, dhe një përditësim i këtij botimi pritet të botohet në fillim të vitit 2021. Ky botim përbën risi, pasi përmbledh në një material të vetëm 83 tregues me fokus fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë në Shqipëri. Pjesa më e madhe e treguesve janë përpunuar dhe raportuar për herë të parë përmes këtij botimi. Për formulimin e treguesve, janë marrë për referencë botimet ndërkombëtarë të fushës dhe, për herë të parë,

14 VKM nr. 903, Nr. 903, datë 24.12.2019 - Link

15. Link

16. Link

janë listuar treguesit sipas Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Burimi i të dhënave është një kombinim i raportimeve administrative të institucioneve shtetërore dhe anketave të kryera nga INSTAT-i. Është realizuar Studimi Demografik dhe Shëndetësor për Shqipërinë¹⁷, i cili paraqet të dhëna të një game të gjerë, duke mundësuar matjen e progresit në disa fusha, por, në të njëjtën kohë, ofron të dhëna të nevojshme për të raportuar ecurinë e shtetit shqiptar në përmbushje të OZHQ-së.

Në fushën e arsimit, mbledhja e të dhënave bëhet përmes sistemit Sokrates, që administrohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe përfshin në fushat e raportimit indikatorë të cilët lidhen me situatën e fëmijëve, si p.sh. fëmijë me prindër të divorcuar, me aftësi të kufizuara, romë, egjiptianë, etj.

ECURIA E MASAVE TË PARASHIKUARA

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse paraqet të dhënat e mëposhtme:


STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



17. Link


Në këtë kuadër, ecuria e masave të raportuara paraqitet si më poshtë:

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020

STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)



MES TREGUESVE TË REZULTATIT TË


REALIZUAR, PËRFSHIHEN:

- Rritja e buxhetit të ASHDMF-së në vitin 2018 me 35.2% në krahasim me 2017-ën;
- Përgatitja e më tepër se 80 raporteve institucionale në kuadër të raportimeve kombëtare e ndërkombëtare, të cilat referojnë të dhëna / informacion për fëmijët.

INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për objektivin 1 është rreth 20.8 milionë lekë¹⁸, ose 1.3% e koston së përgjithshme të Agjendës. 47.7% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiivi duhet të mbulohej nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët.


STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 53.3% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 7 masa (ose

46.7%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit përkojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të parealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



Pesha e shpenzimeve të planifikuara për masat e realizuara është sa 84.6% e shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për objektivin 1. 51.3% e shpenzimeve faktike të raportuara kanë si burim financimi buxhetin e shtetit, ndërsa 48.7% financimin nga donatorët.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Stati i Progresit të Masave	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzime të planifikuara në % ¹⁹	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ²⁰	17 612 500	84.6%	28 646 120	162.6%	51.3%	48.7%
2 Mosrealizim ²¹	3 212 000	15.4%	-	-		
Gjithsej	20 825 000	100.0%	-	-		

18. Shifra e plotë 20,825,000

19. Përqindjet janë rumbullakosura

20. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi në kuadër të masës së përcaktuar

21. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të vënë në dukje peshën e koston/buxhetit në raport me masat e tjera.

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Në kuadër të qeverisjes efektive për të drejtat e fëmijëve dhe rolit të rëndësishëm që luan në këtë aspekt Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, qëndron si domosdoshmëri forcimi i mëtejshëm i këtij mekanizimi. Jo vetëm përmes takimeve më të shpeshta, por edhe hartimit të një agjende pune të përvitshme, në shërbim të trajtimit të çështjeve të rëndësishme dhe monitorimit të zbatimit të vetë Agjendës. Mbetet ende e pazbatuar VKM-ja në kuadër të ngritjes së Grupit Teknik të Mbrojtjes së Fëmijëve, apo grupeve të tjera të punës.

Një sërë masash të planifikuara nuk kanë gjetur zbatim, si edhe të tjera nuk kanë gjetur hapësirën e nevojshme për t'u realizuar në mënyrë të efektshme. Mes tyre janë:

- Hartimi i metodologjisë dhe kryerja e vlerësimit të impaktit të legjislacionit me perspektivën/ interesin e fëmijëve. Institucionet raportojnë se nuk ka pasur një autoritet përgjegjës për të ndjekur realizimin e këtij aktiviteti, si dhe mungesë të kapaciteteve institucionale për të ndërmarrë këtë masë. Gjithashtu, organizatat ndërkombëtare nuk e kanë vënë si përparësi këtë masë në kuadër të mbështetjes së tyre. Kjo masë mbetet e vlefshme për të ardhmen, duke pasur parasysh rëndësinë e planifikimit që në gjenezë me fokus interesin e fëmijëve.
- Buxhetimi për fëmijët është një fushë veprimi problematike. Në këtë drejtim, kërkohet që të investohet në burimet e duhura për të zhvilluar në mënyrë periodike analizë buxhetore me fokus fëmijët, ngritje kapacitetesh/instrumentesh për të realizuar buxhetimin me qendër fëmijën në

nivel qendror dhe vendor, dhe, mbi të gjitha, të rriten alokimet financiare në të mirë të fëmijëve. Në kuadër të analizës buxhetore, "Analizë e investimeve për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara"²² mund të shërbejë si modele të mira për t'u shtrirë më tej si në nivel territorial, ashtu dhe tematik.

- Pavarësisht arritjeve në forcimin e kapaciteteve të punonjësve që mbulojnë fushën e mbrojtjes dhe shërbimeve të fëmijëve, përparësi mbetet bashkërendimi i punës, ofrimi i trajnimeve të specializuara dhe njohura nga institucionet bashkërenduese lidhur me këtë fushë.
- Sistemet sektoriale të administrimit të informacionit dhe treguesit për fëmijët duhet të mbeten në vëmendje, duke pasur parasysh dinamikën e fushës. Problematikë mbeten mbledhja dhe raportimi i të dhënave administrative (për fëmijët), të agreguara sipas seksit, grupmoshës, gjendjes së aftësisë së kufizuar, përkatësisë ndaj një pakice kombëtare, shtetësisë, etj. Prodhimi (pasurimi) i rregullt i treguesve për fëmijët, në përputhje me OZHO-në, duhet të mbështetet me burime financiare të pandërprera për INSTAT-in dhe institucionet e tjera raportuese.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Kulturës, INSTAT-i, si dhe organizma ndërkombëtare që punojnë në fushën e fëmijëve – UNICEF-i, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Save the Children, World Vision, Terre des Hommes.

22. Link

OBJEKTIVI 2

Progresi i të drejtave të fëmijëve, si pjesë e agjendës kombëtare

ARRITJET KRYESORE

Një rol themelor në progresin e të drejtave të fëmijëve dhe përmbushjes së angazhimeve të marra në kuadër të Agjendës ka edhe raportimi dhe llogaridhënia e institucioneve përgjegjëse në zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara në Agjendën kombëtare, si dhe ndjekja, zbatimi dhe monitorimi i angazhimeve ndërkombëtare (Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, dhe në kuadrin e procesit të integritimit evropian).

Në bashkëpunim me MSHMS-në dhe institucionet e tjera, në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ), mbështetur nga UNICEF-i përgatiti Raportin e pestë dhe të gjashtë periodik kombëtar për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës të Kombeve të Bashkuara (Komiteti)²³, miratuar me VKM-në nr. 551, datë 31.7.2019. Raporti përfshin zbatimin e Konventës së OKB-së 'Për të drejtat e fëmijëve' dhe të të dy protokolleve opsionale të saj "Për përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur" dhe "Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë me fëmijë". Pas paraqitjes së Raportit Kombëtar, sipas procedurës së organeve monitoruese, Komiteti

i Ekspertëve ka vendosur të fillojë procesin për shqyrtimin e këtij raporti në korrik të vitit 2021. Në këtë drejtim, objektiv i rëndësishëm është ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të ciklit të mëparshëm të raportimit. Në funksion të dialogut konstruktiv me Komitetin, është e domosdoshme pjesëmarrja e gjerë e përfaqësuesve të institucioneve me aftësitë dhe kompetencat profesionale të fushës, në delegacionin shqiptar që do të marrë pjesë në sesionin për shqyrtimin e Raportit nga Komiteti (institucionet përgjegjëse, qendrore, të varësisë, vendore dhe institucionet e pavarura).

Kuvendi i Shqipërisë ka ndërmarrë një rol aktiv në avancimin e të drejtave të fëmijëve dhe fuqizimin e qeverisjes të përqendruar tek fëmijët, duke riaktivizuar Grupin e Deputetëve "Miq të Fëmijëve" (GDMF), i cili drejtohet nga Kryetari i Kuvendit dhe përbëhet nga 32 deputetë -28 anëtarë dhe 3 zëvendëskryetarë. Megjithë ndryshimet e krijuara nga lënia e mandatit të disa prej anëtarëve, GDMF-ja ka vijuar punën duke iu dhënë përparësi çështjeve të fëmijëve përmes legjislativitetit, nxitur llogaridhënien nga ana e Qeverisë për ecurinë e përmbushjes së objektivave të caktuara në Agjendë, ofruar hapësirë për dialog me fëmijët, në mënyrë

23. [Link](#)

që ata të shprehin mendimet e tyre dhe të ngrenë çështje që i shqetësojnë në prani të anëtarëve Kuvendit. Gjithsesi, nuk ka një forum të caktuar dhe të rregulluar për konsultim/pjesëmarrje të fëmijëve, por ata mund të thirren si grup interesi, nëse gjykohet kështu nga rendi i ditës dhe çështja në diskutim.

GDMF-ja ka zhvilluar 29 takime në periudhën kohore deri në 2020-n, qoftë si pjesë e seancave parlamentare, seancave dëgjimore me ministra dhe anëtarë të qeverisë, apo organizata të shoqërisë civile dhe grupe fëmijësh. GDMF-ja ka organizuar dëgjesa me qëllim paraqitjen e raporteve të hartuara prej fëmijëve dhe të rinjve nga bashki të ndryshme mbi nivelin e respektimit dhe gëzimit të të drejtave të tyre, sidomos nga institucionet shtetërore, dhe rolin që luan pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrjen publike. Është paraqitur raporti i monitorimit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve, i hartuar nga fëmijët dhe të rinjtë e Kuvendit Rinor, mbi gjendjen e respektimit të të drejtave të fëmijëve, ku përmenden problemet kryesore që i shqetësojnë fëmijët dhe adoleshentët në Shqipëri.

Institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut kanë demonstruar rritje profesionale dhe kanë intensifikuar veprimtarinë e tyre në trajtimin e proceseve apo politikave të cilat influencojnë mirëqenien e fëmijëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), përgjegjës për të drejtat e fëmijëve, anëtar i ENOC-it²⁴, ka fuqizuar kapacitetet e veta në trajtimin e çështjeve që

përfshijnë fëmijët, duke marrë cikle të plota trajnimi për kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar të të drejtave të fëmijëve. Plani Strategjik 2019-2022²⁵ i institucionit ka vendosur fëmijët në përparësitë e tij, veçanërisht, ata që i përkasin grupeve vulnerabël. AP-ja, përmes Seksionit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (Seksioni), në mënyrë proaktive, ka nxitur bashkëpunimin me grupet e fëmijëve dhe paraqitur mënyrat e bashkëveprimit me AP-në në çdo rast që ka nevojë të ngrihen shqetësime për cenimin e të drejtave të fëmijëve, përmes një 'Udhëzuesi praktik për mënyrat e bashkëveprimit të fëmijëve me Avokatin e Popullit'. AP-ja ka përfunduar, gjithashtu, doracakun "Për edukimin ligjor për/rreth të drejtat e njeriut dhe, në veçanti, të drejtat e fëmijëve".

Në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara gjatë kësaj periudhe kohore, janë trajtuar nga Seksioni 183 raste, prej të cilave, 172 me iniciativë dhe 3 ankesa drejtpërdrejt nga vetë fëmijët. Vetëm në vitin 2020, Seksioni ka hartuar dhe trajtuar gjithsej 17 rekomandime, prej të cilave, 14 janë pranuar, 2 janë në proces shqyrtimi nga organet shtetërore, dhe 1 pa përgjigje. Janë realizuar 11 inspektime tek institucionet e përkujdesit social rezidencial, institucionet e edukimit, si dhe inspektimi i Komisariateve të Policisë, me qëllim monitorimin e zbatimit të masave anticovid -19. AP-ja ka organizuar 66 veprimtari promovuese online, me qëllim për t'iu siguruar dhe garantuar fëmijëve dhe familjeve të tyre të drejtat e tyre, në frymën e KKBDF-së, si dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtare dhe evropiane të rëndësishme

24. European Network of Ombudspersons for Children

25. Link

për të drejtat e njeriut. Ndërkohë, ka përfunduar përgatitja e Raportit sintezë të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve gjatë pandemisë COVID-19 dhe Raportit sintezë të Vlerësimit të Impaktit të të Drejtave të Fëmijëve (CRIA) në Shqipëri. Është në proces raporti lidhur me përcaktimin e masës së detyrimit ushqimor të fëmijëve në rastet e divorcit.

AP-ja i ka përqendruar përpjekjet në çështjen e fëmijëve që vuajnë privimin nga liria dhe, si rezultat, edhe me bashkëpunimin me UNICEF-in, fëmijët në 3 qendra të paraburgimit, tek të cilat mjediset e fëmijëve nuk ishin të ndara nga ato të të rriturve, u vendosën në institucionin e përshtatur për fëmijët.

Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë një proces monitorimi me fokus të veçantë fëmijët në arsim. Qëllimi i këtij studimi është paraqitja e situatës në zbatimin e legjisllacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijët romë e egjiptianë, si dhe për ecurinë në arsim për vitin shkollor 2018 - 2019 dhe 2019 – 2020. Në përfundim të këtij procesi, Zyra e Komisionerit do të dalë me një Raport Monitorimi me fokus të veçantë fëmijët në arsim brenda fundit të vitit 2020. Ndryshimet e fundit ligjore²⁶ synojnë të përmirësojnë efektshmërinë e proceseve institucionale, përfshirë mundësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe qasjes së tyre ndaj shërbimeve që siguron Zyra e Komisionerit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka realizuar

aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve në lidhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë në internet. Në kuadër të Ditës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale (2020), në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale, TIK “Hermann Gmeiner”, u organizua konkursi me temë “Të rinjtë dhe privatësia”, në të cilin morën pjesë 10 grupe nxënësish të kësaj shkolle, duke paraqitur projektaplikacione, në të cilët politikat e privatësisë ishin elementi kryesor i vlerësimit nga një juri profesioniste. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka nisur fushatën ndërgjegjësuese “Edukimi online, luaj dhe mëso – Happy Onlife”. Janë realizuar aktivitete në sistemin arsimor parauniversitar, me fokus përdorimin e sigurt të mjedisit digjital nga fëmijët dhe të rinjtë, në qytete si Kavajë, Rrogozhinë, Cërrik, Belsh, Peqin dhe Gramsh.

ASHDMF-ja, në bashkëpunim me organizatën Save the Children, kanë hartuar një dokument orientues për institucionet që punojnë me fëmijë, organet vendimmarrëse etj. për realizimin e pjesëmarrjes kuptimplote të fëmijëve në çështje që iu përkasin atyre, në përputhje me disa standarde cilësie. Udhëzuesi ‘Për kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitete, procese konsultuese dhe vendimmarrëse’ është miratuar me Urdhër të Ministrit të MSHMS-së nr. 367, datë 09.06.2020, dhe paraqitur në disa bashki të vendit, përkatësisht, Durrës, Elbasan, Dibër, Klos, Burrel.

Është ngritur portali “Zëri i fëmijëve”, nën administrimin e ASHDMF-së, si një faqe interaktive

26. Link

web-i për të nxitur komunikimin dhe për t'u konsultuar me fëmijët. Aktualisht, është në proces dhe një vlerësim i jashtëm i kornizës kurrikulare për arsimin parauniversitar nga pikëpamja e edukimit, promovimit dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve.

ASHDMF-ja kryen rregullisht monitorimin e medias për të identifikuar rastet e shkeljeve të të drejtave të tyre, si edhe të raportimit joetik të tyre në media. Si rezultat, 237 raste të fëmijëve (në nevojë për mbrojtje), të bëra publike / të identifikuar nga media, iu referuan strukturave të mbrojtjes së fëmijëve për të filluar administrimin e rasteve. Përveç kësaj, 70 ankesa iu janë drejtuar mediave të shtypura dhe elektronike për publikimin e lajmeve në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve (27 ankesa të paraqitura pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive – AMA) dhe 51 në gazeta, portale dhe në Këshillin e Mediave Shqiptare).

Paralelisht, Këshilli i Ankesave pranë AMA-s ka mbikëqyrur në mënyrë të vazhdueshme dhe rigorozë të gjitha rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve e, në veçanti, rastet e dhunës ndaj tyre. Në vitet e fundit, ankesat me fokus fëmijët përbëjnë 40% të ankesave të paraqitura. AMA ka rritur bashkëpunimin me ASHDMF-në, si dhe ka organizuar aktivitete e tryeza diskutimi të përbashkëta me GDMF-në dhe OJF që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Në fokusin e tyre ka qenë edhe monitorimi dhe vlerësimi i rasteve të shkeljeve të kërkesave ligjore për reklamat e pijeve të gazuara dhe me përmbajtje të shtuar të

sheqerit, në zbatim të ligjit nr. 9518, dt. 18.4.2006, "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit". AMA vazhdon të advokojë për zgjerimin e buketës programore të Transmetuesit Publik për fëmijët, si edhe përfshirjen e gjuhës së shenjave në kanalet ekzistuese²⁷.

ASHDMF-ja po ndjek një rol proaktiv në rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të fëmijëve mbi çështje të të drejtave të tyre në përgjithësi dhe çështje të veçanta, si dhuna dhe abuzimi, mekanizmi i referimit të shqetësimeve, siguria në internet etj. Janë realizuar 7 takime ndërgjegjësuese me nxënësit në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në bashkitë Malësi e Madhe, Divjakë, Gramsh, Tiranë, ku është ofruar informacion mbi të drejtat e fëmijëve, si dhe mbi mekanizmat e strukturat e angazhuara për mbrojtjen e tyre, rëndësinë e raportimit nga vetë fëmijët në çdo rast kur ndihen të dhunuar apo të abuzuar. Gjatë takimeve janë shpërndarë dhe fletëpalosje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe broshura mbi raportimin online. Janë realizuar, gjithashtu, 4 takime informuese/ndërgjegjësuese, në kuadër të javës së internetit të sigurt për fëmijët me nxënësit në shkollat e bashkisë Tiranë: "Myslym Keta", "Hasan Vogli", "Lidhja e Prizrenit" dhe "Kongresi i Lushnjës". Edukimi për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve është pjesë përbërëse e politikës së arsimit parauniversitar, e konkretizuar si parim themelor në kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar, dhe është pjesë e kurrikulës së lëndës Qytetaria, klasa 1-10, dhe në tekste të tjera shkollore të lëndëve shoqërore.

27. [Link](#)


PROGRESI I MASAVETË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)



INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për objektivin 2 është rreth 69.1 milionë lekë²⁸, ose 4.2% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 66.9% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiivi duhet të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët. Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 81.8% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 4 masa (ose 18.2%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të porealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



28. Shifra e plotë 69,132,500

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

	Statusi i Progresit të Masave	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzime të planifikuara në % ²⁹	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi financimit	
						Buxheti	Donatorët
1	Realizim ³⁰	65 595 000	94.9%	58,316,079	88.9%	68.6%	31.4%
2	Mosrealizim ³¹	3 537 500	5.1%	0.0	0.0		
	Gjithsej	69 132 500	100%				

Pesha e shpenzimeve faktike për masat me status të realizuara është sa 84.4% e shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për objektivin 2. 68.6% e shpenzimeve faktike të raportuara kanë si burim financimi buxhetin e shtetit dhe 31.4% fondet e donatorëve.

REFLEKTIVE PËR TË ARDHMEN

Në përfundim të periudhës së zbatimit të Agjendës, mbeten të pazbatuara masat në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe parimet e biznesit, ndërsa institucionet raportuese kanë shprehur mungesë kapacitetesh teknike dhe burimesh financiare për të realizuar këto veprimtari në bashkëpunim me sektorin privat. Fusha të tjera të rëndësishme që duhet të mbeten përparësi janë:

- Raportime/ndërveprime të rregullta dhe të shpeshta të aktorëve të ndryshëm që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve tek Kuvendi i Shqipërisë, si edhe ngritja e mekanizmave pjesëmarrës gjithëpërfshirës dhe të efektshëm të fëmijëve/adoleshentëve pranë këtij institucioni.
- Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore pranë institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut, për të siguruar vazhdimësi dhe cilësi të punës e, mbi të gjitha, për t'i promovuar ato tek fëmijët dhe familjet/kujdestarët e tyre.

- Zbatimi i udhëzuesit të pjesëmarrjes së fëmijëve nga të gjitha institucionet përgjegjëse dhe monitorimi i zbatimit etik të tij. Për më tepër, mbetet e rëndësishme ngritja e mekanizmave të përshtatshëm në nivel qendror dhe vendor të përfshirjes së efektshme të fëmijëve/adoleshentëve;
- Bashkërendimi dhe angazhimi i të gjithë aktorëve përgjegjës për një paraqitje sa më etike të fëmijëve në media, sigurimit të hapësirës së nevojshme të tyre në transmetimet publike, ngritjen e kapaciteteve të gazetarëve/medias dhe vetëm fëmijëve në këtë fushë.
- Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë të bashkërenduar, cilësore dhe gjithëpërfshirëse, si dhe përpjekjet për të ndërgjegjësuar fëmijët dhe të rriturit për të drejtat e fëmijëve.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit - Drejtoritë Arsimore Rajonale - Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, Avokati i Popullit – Komisioneri për të Drejtat e Fëmijëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Njësitë e Qeverisjes Vendore, si edhe partnerë të tjerë, si UNICEF-i, Save the Children, World Vision etj.

29. Përqindjet janë rumbullakosura

30. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së të paktën një veprimi në kuadër të masës së përcaktuar

31. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera.

SHTYLLA STRATEGJIKE 2


Eliminimi i të gjitha
formave të dhunës ndaj
fëmijëve

3
Objektivi


4
Objektivi

SHTYLLA STRATEGJIKE 2 NË SHIFRA


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (në nr. & %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në nr. & %)



MASAT E BUXHETUARA DHE TË RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në nr. & %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzime të planifikuara në % ³²	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit Buxheti	Donatorët
1 Realizim ³³	260 470 000	89.7%	220 730 000	76%	58.1%	41.9%
2 Mosrealizim ³⁴	30 032 500	10.3%	-	-		
Gjithsej	290 502 500		-	-		

32. Përqindjet janë rumbullakosura

33. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

34. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

OBJEKTIVI 3

Përmirësimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionale për një sistem të integruar dhe efektiv të mbrojtjes së fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"³⁵; Ligji nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"³⁶ dhe Ligji nr.121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"³⁷, të cilët përcaktojnë të drejtat dhe shërbimet që gëzon çdo fëmijë, si dhe mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, janë plotësuar me të gjitha aktet nënligjore³⁸ në zbatim të tyre. Kjo paketë ligjore sjell një qasje tjetër ndaj mënyrës se si konceptohen të drejtat e fëmijës dhe masat konkrete të mbrojtjes, që duhet të merren nga strukturat përgjegjëse për të parandaluar, rehabilituar dhe mbrojtur në vazhdimësi fëmijën që është subjekt (përfshirë potencialisht) i dhunës, abuzimit dhe neglizhimit³⁹.

Po kështu, edhe Ligji nr. 9669/2006, i ndryshuar, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ka sjellë si ndryshim sigurimin e një mbrojtjeje të fëmijëve dëshmitarë dhe personave me aftësi të kufizuara⁴⁰.

Në 2018-n, si pjesë e bashkëpunimit të UNICEF-it, UNCHR-së dhe GDMF-së, u ndryshua Ligji "Për Gjendjen Civile"⁴¹, i cili adresoi rrezikun e fëmijëve për të mbetur pa shtetësi. Ligji gjeti zbatim të menjëhershëm në rastin e, të paktën, 1 340 fëmijëve të identifikuar në atë kohë me probleme në regjistrimin në lindje.

Në vijim të Urdhrit Nr.75, datë 09.06.2020, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional

35. Link

36. Link

37. Link

38. 13 VKM dhe 5 udhëzime në kuadër të Ligjit nr. 18/2017; 6 VKM dhe 10 urdhra e udhëzime në kuadër të Ligjit 37/2017; 8 VKM dhe një sërë udhëzimesh në kuadër të Ligjit 121/2016

39. Korniza rregullatore për mbrojtjen e fëmijëve është përshkruar në mënyrë më të zgjeruar tek shtylla strategjike.

40. Link


41. Link

të punës për përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe trajtimit të dhunës ndaj të miturve”, nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë (MD), janë ngritur dy grupe pune për analizën e problematikave të dhunës në familje, si dhe përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe adresimit të abuzimit seksual ndaj të miturve. Ndërkohë është përfunduar analiza e legjislacionit në fuqi dhe janë nxjerrë rekomandimet përkatëse për plotësimin e këtij procesi. Është nxjerrë një udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor në muajin qershor 2020 lidhur me “Përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”⁴².

Në kuadër të zbatimit të kuadrit ligjor të sipërpërmendur⁴³, janë emëruar dhe ofrojnë shërbime gjithsej 236 Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) pranë NjQV-ve (Bashki dhe Njësi Administrative), nga të cilët vetëm 45 kryejnë vetëm funksionin e PMF-së. Në njësitë administrative që kanë më pak se 3 000 fëmijë, PMF-të kryejnë funksione të ndërthurura si administrator social dhe specialist për çështjet gjinore e dhunën në familje. Vetëm 78⁴⁴ e PMF-ve janë me formim punonjës social. Gjatë vitit 2020, 87% e Njësave për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMF) kanë raportuar të kenë administruar raste të fëmijëve në rrezik. Kjo shënon një rritje në krahasim me vitin 2018 (79%). Ndërkohë, numri i

rasteve të administruara ndër vite është në rritje (grafiku 4). Pavarësisht progresit në ngritjen dhe shtrirjen e PMF-ve, nga puna me rastet konkrete, janë konstatuar vonesa dhe vështirësi në ushtrimin e funksioneve të tyre. Për të trajtuar disa nga këto problematika, ASHMDF-ja dhe UNICEF-i, prej vitit 2019, kanë ngritur një njësi lëvizëse profesionistësh, e cila vepron në terren, duke ofruar mbështetje teknike të drejtpërdrejtë për PMF-të. Ekipi i dha përparësi atyre zonave ku raportet vjetore demonstuan rezultate të dobëta dhe numër të ulët të rasteve të administruara, duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë teknike për 80 profesionistë.

GRAFIKU 4. NUMRI I RASTEVE TË MANAXHUARA NGA PMF-TË NDËR VITE



Janë ngritur Grupet Teknike Ndërsektorale (GTN) në çdo NjQV që ka një PMF, si një nga mekanizmat kryesorë vendorë për administrimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Nga raportimet, vlerësohet një zhvillim pozitiv në funksionimin e tyre, tashmë me role dhe detyrime të përcaktuara qartë brenda sistemit vendor të mbrojtjes. Gjithsesi, është konstatuar se, në disa raste, GTN-të nuk mblidhen në kohë dhe, për pasojë, nuk e

42. Link

43. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.186, datë 04.04.2019 “Për kriteret për punësimin e punonjësve të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe të punonjësve që punojnë me fëmijët”

44. 33%

ushtrojnë funksionin e tyre siç duhet, sidomos në NjQV-të e qyteteve të vogla, apo të zonave periferike, ku ka edhe mungesë të personelit që mbulon funksionet e GTN-ve.

NjQV-të raportojnë për progresin e hartimit të Planeve Sociale Vendore, pjesë e të cilave janë bërë edhe planet për mbrojtjen e fëmijëve. Procesi ka ndjekur një metodologji të njëjtë në çdo bashki, përmes një vlerësimi të nevojave në nivel vendor, identifikimit të grupeve dhe faktorëve të vulnerabilitetit dhe planifikimit për shërbimet përkatëse. Në shumë bashki, ka ndodhur edhe konsultimi me grupe të fëmijëve. Në planet sociale vendore, iu është dhënë rëndësi ngritjes, fuqizimit dhe funksionimit të mekanizmave vendorë të mbrojtjes sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve, bashkërendimit ndërsektorial, si dhe ngritjes së shërbimeve të munguara. Mbi 90% e bashkive që kanë raportuar se kanë miratuar planin social vendor raportojnë se ai është i shoqëruar me buxhetimin përkatës.

Gjatë vitit 2020, situata paraqitet si më poshtë:

- 50 bashki kanë hartuar dhe miratuar planin social vendor - pjesë e të cilit janë dhe planet për mbrojtjen e fëmijëve;
- 10 bashki janë në proces;
- 14 bashki kanë përfituar financime nga Fondi Social gjatë vitit 2019.

Në kuadër të vlerësimit të kostove për administrimin e rasteve, një minimum NjQV-sh raportojnë për dhënie të një buxheti minimal për rastet emergjente, duke përberë kështu një arritje

në sajë të përcaktimit të një zëri buxhetor që nuk ka ekzistuar më parë.

Ngritja e kapaciteteve profesionale të PMF-ve ka pasur një ecuri pozitive, si rezultat edhe i bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe bashkërendimit që ASHDMF-ja ka pasur me donatorë dhe aktorë të ndryshëm. Në 2018-n, u botua studimi "Hartëzimi i strukturave bazë të Mbrojtjes së Fëmijëve (në nivel vendor) dhe prioritizimi i nevojave të tyre për aftësim profesional"⁴⁵, realizuar në bashkëpunim me Terre des Hommes. Gjithashtu, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve, si edhe të atyre që punojnë me fëmijët, si dhe krijimit të një sistemi të qëndrueshëm të edukimit përgjatë punës, me mbështetjen e UNICEF-it, ASHDMF-së dhe, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP) e Terre des Hommes, është njohur dhe certifikuar kurrikula e trajnimit si pjesë e edukimit përgjatë punës për Çështjet e Mbrojtjes së Fëmijëve. Për shkak të kufizimeve të vendosura si rrjedhojë e pandemisë globale të COVID-19-s, ASPA-ja, përmes platformave të saj, mundësoi lehtësimin online të trajnimit, sipas formateve dhe standardeve institucionale. Si rezultat, janë trajnuar thuhetse 90 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve dhe grupe të tjera do të vijojnë të trajnohen.

Në të njëjtin kuadër, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, është ngritur kursi pasuniversitar për "Administrimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje", si dhe kursi pasuniversitar për "Shërbimet e kujdesit alternativ". Të dy këto

45. Link

kurse janë ngritur me qëllim ofrimin e trajnimit në vazhdueshëm për të gjithë profesionistët e fushës së mbrojtjes së fëmijëve. Këto programe mbeten ende të paakredituara, si pasojë e ngërceve procedurale. Megjithatë, miratimi i VKM-së nr. 624, datë 29.07.2020, "Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror"⁴⁶, si dhe VKM-së nr. 848, dt. 28.10.2020, "Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre"⁴⁷, pritet t'i japë zgjidhje problematikës së krijuar.

Në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve në situata të jashtëzakonshme, fillimisht për shkak të nevojës së shpejtë për mbështetje të diktuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 e, më pas, pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, pranë MSHMS-së, me mbështetjen e UNICEF-it, u ngrit Grupi i Emergjencës për Mbrojtjen e Fëmijëve, ku përfshihen mes aktorëve të tjerë edhe organizata si World Vision, Terre des Hommes, Save the Children, ADRA Albania, Alo Mik, SHIS Albania, Sanita di Frontiera. U hartua Udhëzuesi i Përgjigjes Minimale i mbështetur në standarde të unifikuara në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në rastet e emergjencës. Si rezultat i ndërhyrjeve të mirëbashkërenduara, u trajnuan 81 profesionistë për të ofruar një ndërhyrje të standardizuar në kushte emergjence, u krijuan 36 hapësira miqësore për fëmijët, u mbështetën 3059 fëmijë dhe 747 të rritur me ndihmesë psiko-sociale, 751 fëmijë me këshillim psikologjik individual, ndërkohë që 12 raste u referuan pranë NJMF-ve.

46. [Link](#)

47. [Link](#)

48. [Link](#)


Ndërkohë, për të t'iu përgjigjur sfidave të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve të diktuar nga COVID-19, me mbështetjen e UNICEF-it, nga maji 2020, organizata Nisma për Ndryshim Shoqëror - ARSIS ka mbështetur profesionalisht 51 punonjës të sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, si PMF, punonjës të qendrave komunitare, online dhe drejtpërdrejt, me qëllim identifikimin dhe referimin e menjëhershëm e marrjen në mbrojtje të fëmijëve. Është ofruar mbështetje teknike për vlerësimin e nivelit të riskut dhe përgatitjen e planit të mbrojtjes. E gjithë ndihmesa është përqendruar në aftësimin për ofrimin e një mbrojtjeje të efektshme për rastet e fëmijëve në risk të lartë dhe mbështetjen e bashkësive vulnerabël. Në të njëjtin kuadër, janë ofruar edhe shërbime të drejtpërdrejta për 231 fëmijë.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar informimit dhe orientimit profesional online të punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve, duke u përqendruar në parashikimet dhe zbatimin e Udhëzimit Nr. 253, dt. 10.04.2020, "Për administrimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, për arsye të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19"⁴⁸. ASHDMF-ja ka përcjellë udhëzimet e duhura dhe ka ofruar ndihmesë teknike për PMF-të lidhur me procedurat e reja për mbrojtjen e fëmijëve gjatë COVID-19-s. Me mbështetjen vijuese të UNICEF-it, Save the Children, Terre des Hommes, World Vision, WHO etj., është ofruar një cikël sesionesh informuese mbi shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale në situata të jashtëzakonshme për profesionistë të ndryshëm të

mbrojtjes së fëmijëve dhe ofrues shërbimesh. Duke parë nevojën e standardizimit të shërbimit emergjent të sigurt për fëmijët në nevojë për mbrojtje, World Vision ka përfunduar gjatë vitit 2019 hartimin e kornizës së Standardeve dhe Protokollit për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes emergjente për fëmijët në rrezik të lartë të dhunës dhe abuzimit. Standardet sigurojnë që fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës, ose që kanë qenë dëshmitarë dhe/ose janë viktima të trafikimit të mund të aksesojnë shërbime miqësore që iu përgjigjen nevojave të tyre, duke pasur në çdo rast në fokus interesin më të lartë të fëmijës. Synimi është që standardet e reja të shërbimit emergjent të sigurt të pilotohen në Qendrën e re të Emergjencës në Durrës. Ky bashkëpunim ndërmjet Bashkisë Durrës dhe World Vision është financuar pjesërisht nga Fondi Social. Por, për shkak të situatës së jashtëzakonshme shkaktuar nga tërmeti dhe COVID-19, procesi ka qenë i ngadaltë dhe sfidues. Po ashtu, kalimi i fondeve nga MSHMS-ja është vonuar për shkak të situatës së jashtëzakonshme.

PROGRESI I MASAVETË PARASHIKUARA


STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



49. Shifra e plotë 274,652,500


Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 92% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020

STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)




INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për objektivin 3 është rreth 274.7 milionë lekë⁴⁹, ose 16.8% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 52.7% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiv duhet të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët.


Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet i raportuar nga institucionet përgjegjëse është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMITË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 48.8% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 21 masa (ose 51.2%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të parealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMITË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



Pesha e shpenzimeve faktike për masat me status realizim është raportuar nga institucionet përgjegjëse qendrore dhe 57.3% e NjQV.

Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 83.9% e shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për masat e realizuara. 56.6% e shpenzimeve faktike të raportuara kanë si burim financimi buxhetin e shtetit dhe 43.4% fondet e donatorëve.

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Struktura monitoruese dhe inspektimi i standardeve të punës së NJMF-ve mbetet një masë ende për t'u realizuar.

Nuk ka përfunduar analiza e kuadrit ligjor në sektorë të ndryshëm dhe përafrimi i tij me Ligjin nr. 18/2017, duke sjellë si rrjedhojë mosrealizimin e masave vijuese, që lidhen me hartimin e propozimeve për ndryshim dhe miratimin e tyre. Edhe në rastet kur kjo analizë është realizuar (si p.sh. propozimet për ndryshimin e Kodit të Familjes lidhur me martesën e hershme), nuk ka pasur përparim në shqyrtimin dhe miratimin e tyre.

Mungesa e kapaciteteve të brendshme ka bërë që pjesa më e madhe e Bashkive kanë hartuar planet

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMITË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në %50	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ⁵¹	246 195 000	89.6%	206,455,000	83.9%	56.6%	43,4%
2 Mosrealizim ⁵²	28 457 500	10.4%	0.0			
Gjithsej	274 652 500	100%				

50. Përqindjet janë rrumbullakosura

51. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

52. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

sociale vendore (ku përfshihen masat për mbrojtjen e fëmijëve) me ekspertizë të jashtme, mbështetur financiarisht nga donatorë të ndryshëm. Një tjetër sfidë e procesit është mungesa e analizës së kostove dhe, për rrjedhojë, buxhetimit të planit, duke vështirësuar zbatueshmërinë e tyre. Mes tyre, edhe kryerja e analizës së kostos për administrimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve, një masë e parashikuar, por e pazbatuar e Agjendës. Një panoramë e këtyre problematikave vjen edhe në Raportin e ‘Monitorimit të Zbatimit të Ligjit 18/2017’ me fokus disa Bashki të Shqipërisë⁵³.

Mbetet sfidë thelbësore mungesa e kapaciteteve në burime njerëzore, kapacitete teknike dhe burime financiare për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, si në nivel qendror ashtu dhe në nivel vendor. Kjo situatë vë në diskutim zbatimin e plotë të kuadrit ligjor të miratuar, duke filluar nga punësimi i PMF-ve sipas të gjitha përcaktimeve normative.

ASHDMF-ja mbetet ende me të njëjtën organigramë dhe kapacitete njerëzore që nga krijimi i saj, duke qenë kështu me burime të kufizuara kundrejt detyrave dhe përgjegjësi që i ngarkon legjislati.

Megjithë përpjekjet për përmirësime ligjore, ende mbetet e paqartë struktura që do të udhëheqë procesin e edukimit në vazhdim për profesionistët e fushës sociale (përfshi ata të mbrojtjes së fëmijëve). Pritet të realizohet hartimi i një programi sistematik të zhvillimit të kapaciteteve profesionale, sipas roleve dhe funksioneve të profesionistëve.

Programet e trajnimit mbeten ende të orientuara nga përparësitë/mbështetja e donatorëve. Bashkërendimi sektorial mbetet i vështirë, duke krijuar vonesa dhe mosrealizime. Mbetet e parealizuar ngritja dhe vënia në funksionim e Grupit Teknik Ndërmatoror pranë Këshillit Kombëtar të Fëmijëve. Përveç rolit koordinues të ASHDMF-së, është detyrë dhe përgjegjësi e secilës prej ministrive të linjës të përmbushin detyrimet në kuadër të Agjendës, sidomos në lidhje me vlerësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të sektorëve përkatës në çështje të mbrojtjes së fëmijëve.

Harmonizimi i punës së sektorëve të tjerë me konceptet e mbrojtjes së fëmijëve mbetet ende një sfidë. Ndonëse legjislati parashikon si duhet të funksionojë sistemi i referimit të rasteve të identifikuara në nevojë për mbrojtje për secilin sektor (arsim, shëndetësi etj.), ka nevojë për udhëzues dhe instrumente praktike për profesionistët e këtyre fushave për të zbatuar siç duhet interesin më të lartë të fëmijës dhe hallkat e referimit për administrimin e rastit.

Sigurimi i cilësisë në ofrimin e shërbimeve sociale dhe, në mënyrë të veçantë, vlerësimi i kapaciteteve të profesionistëve të fushave të ndryshme, në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve, nuk është realizuar. Megjithëse është ASHDMF-ja në rolin përgjegjës për realizimin e kësaj mase, praktikisht, ndërmarrja e një vlerësimi të tillë do të duhet të kryhet nga çdo sektor si pjesë e vlerësimeve profesionale dhe të njohurive të punonjësve të tyre.

53. Terre des hommes & ANTTARC (2020) “Raport Vlerësimi me Fokus Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr.18 /2017” – Link

Mungesa e vlerësimit të nevojave, apo vlerësimit të impaktit të masave të ndërmarra për mbrojtjen e fëmijëve, impaktit faktik në jetën e fëmijëve, arritjeve konkrete të ndërhyrjeve të realizuara nga puna e bashkërenduar e GTN-ve kanë sjellë si rrjedhojë edhe mungesën e një plani të ngritjes së kapaciteteve dhe të hartimit të moduleve/ kurrikulave të trajnimit.

Një sistem kombëtar elektronik i të dhënave për mbrojtjen e fëmijëve dhe, për pasojë, një sistem i unifikuar të dhënash që mbledh informacion mbi fëmijët që janë përfitues të programeve të mbrojtjes sociale në tërësi mbetet ende i parealizuar, duke vështirësuar programimin e efektshëm të ndërhyrjeve të qëndrueshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve ende nuk ka përgatitjen e mjaftueshme për të trajtuar shfaqjen e larmishme të dhunës ndaj fëmijëve në vend. Kuadri normativ karakterizohet ende nga boshllëqe në legjislacion, mekanizma dhe shërbime të dobëta referimi dhe përgjegjësi institucionale ende të paqarta për t'u zbatuar në praktikë. Profesionistët e vijës së parë (përfshirë stafin shëndetësor, punonjësit e policisë, mësuesit ose punonjësit e tjerë të shërbimit publik) mbeten në nevojë për aftësim të vazhdueshëm profesional për administrim të rasteve. Për më tepër, ekziston një mungesë e vazhdimësisë së shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, duke filluar nga parandalimi, identifikimi i hershëm e deri tek rehabilitimi.

Sa u përket programeve të prindërimit pozitiv, nuk ka pasur ecuri në përfshirjen e këtyre programeve në sistem. Kuadri i përmirësuar ligjor i parashikon programet e prindërimit si një nga masat për mbështetjen e familjes dhe parandalimit të ndarjes së fëmijës nga familja. Përveç nismave të prezantuara nga organizata të ndryshme, pjesë e ndërhyrjeve të tyre në nivel vendor, nuk ka pasur ndonjë zhvillim në lidhje me pilotimin e programeve të prindërimit, testimit të impaktit dhe dokumentimit të tyre për ndërhyje të mëtejshme.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Partnerët e angazhuar në zbatimin e masave të parashikuara për arritjen e këtij objekti kanë përfshirë institucione qendrore dhe të qeverisjes vendore, në mënyrë të veçantë: Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, që kanë luajtur një rol udhëheqës në bashkërendimin e veprimeve të zbatuara nga ministri të linjës dhe organizma ndërkombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve – UNICEF-i, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Save the Children, World Vision, Terre des Hommes, të cilat kanë dhënë mbështetje teknike dhe financiare në plotësimin e kuadrit ligjor, ngritjes së mekanizmave vendorë të mbrojtjes së fëmijëve, ngritjes së kapaciteteve të PMF-ve, ofrimit të shërbimeve mbrojtëse dhe të administrimit të rastit.

OBJEKTIVI 4

Përmirësimi i aksesit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Studimi Kombëtar mbi Bullizmin dhe Ekstremizmin e Dhunshëm në Sistemin Arsimor Shqiptar (mbështetur nga Këshilli i Evropës në 2017)⁵⁴ u pasua me hartimin e politikave kundër bullizmit dhe paraqitjen e një Plani Veprimi (Roadmap). Bazuar në paketën burimore të hartuar, morën trajnim koordinatorët e 21 shkollave, si dhe gjithë trupa e mësuesve të këtyre shkollave. Të 21 shkollat kanë hartuar dhe zbatojnë Planin e Veprimit kundër Bullizmit. Janë ndërmarre aktivitete ndërgjegjësuese, si Ditët e Hapura të Luftës Kundër Bullizmit dhe informim të fëmijëve përmes metodologjisë “peer learning”, janë ngritur këndet e vlerave në klasa, ku nxënësit paraqesin rëndësinë e vlerave në ndërtimin e marrëdhënieve njerëzore dhe aktivitete proaktive me përfshirjen e komunitetit për trajtimin e fenomenit të bullizmit.

Në bashkëpunim me UNICEF-in, janë ngritur kapacitetet e personelit arsimor në arsimin e detyruar në mbi 40 % të shkollave, përmes ofrimit të materialit burimor “Ndërhyrjet për

sjelljet pozitive, si mënyrë për parandalimin e dhunës në shkollë”. Rreth 350 mësues në 21 shkolla të arsimit parauniversitar po pilotojnë këtë qasje për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në shkollë, si dhe janë aftësuar për të planifikuar dhe zbatuar veprimtari që kontribuojnë në realizimin e këtij synimi. Janë ngritur 4 rrjete profesionale të parandalimit të dhunës në shkolla me rreth 100 mësues anëtarë të këtyre rrjeteve. Janë trajnuar 10 000 nxënës për të manifestuar sjellje pozitive që çojnë në uljen e dhunës në shkollë.

Janë hartuar paketa informuese, manuale dhe materiale të tjera burimore për mësues, nxënës dhe prindër mbi “abuzimin seksual” për arsimin parauniversitar. Në të gjitha shkollat e vendit, janë ngritur këndet “Stop dhunës në shkollë”, si dhe, çdo vit, shkollat hartojnë planin vjetor me aktivitete për trajtimin dhe parandalimin e dhunës në shkollë. Komisionet e Etikës dhe Komisionet e Disiplinës trajtojnë çdo rast të raportuar të veprimeve të dhunshme në shkollë.

Janë hartuar tregues për matjen dhe vlerësimin e pranisë së dhunës në shkollë dhe janë bërë pjesë

54. Link

e instrumenteve të standardizuar të vlerësimit të performancës së institucioneve arsimore. Ka nisur bashkëpunimi me partnerët për zhvillimin e një protokollit gjithëpërfshirës për parandalimin dhe raportimin e dhunës, bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla, si pjesë e krijimit të një sistemi funksional të raportimit. Manuali COMBI – “Komunikim për Ndryshimin e Sjelljes” është akredituar dhe treguesit e tij janë pjesë e inspektimeve që zhvillojnë specialistët në institucionet arsimore. Gjetjet pasqyrohen në raportet e vlerësimit, që hartohen nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në ndihmë të mësuesve në arsimin parauniversitar.

Kapacitetet e personeleve të institucioneve rezidenciale në lidhje me legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve, pasojat e dhunës dhe metodat e disiplinimit pozitiv janë fuqizuar si rezultat i trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), me mbështetjen edhe të partnerëve ndërkombëtarë. Vëmendje e veçantë i është kushtuar mbështetjes profesionale të personeleve të institucioneve rezidenciale gjatë periudhës së karantinës, si pasojë e COVID – 19. SHSSH-ja, mbështetur edhe nga partnerët, ka realizuar një program supervizimi dhe mbështetjeje psikoemocionale online për personelet e karantinuara së bashku me fëmijët. Ofrimi i sesioneve mbi vëmendjen dhe të kuptuarin e vetvetes, mirëqenien emocionale, administrimin e dinamikave në situatë të jashtëzakonshme

etj., kanë pasur si synim uljen e stresit tek personeli, me qëllim një administrim sa më të mirë të gjendjes dhe realizimin e mbështetjes emocionale edhe për fëmijët në institucione. Sa i përket adresimit të punës së detyruar të fëmijëve, është aprovuar VKM Nr. 479, datë 17.6.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.108, datë 15.02.2017, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve në Punë⁵⁵”, ku është shtuar Shtojca II, në formën e një Udhëzuesi praktik për inspektorët e punës për identifikimin dhe kontrollin e formave të papranueshme të punës së fëmijëve, si dhe reagimit të duhur ndaj saj. Ky dokument është hartuar nga Inspektorati Kombëtar i Punës, në bashkëpunim me ASHDMF-në dhe me mbështetjen e OSBE-së. Udhëzuesi krijon një lidhje funksionale bashkëpunimi ndërmjet inspektorëve të punës dhe punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor lidhur me identifikimin, referimin dhe marrjen në mbrojtje të fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht.

Në këtë kuadër, është miratuar Vendimi Nr. 129, dt. 13.03.2019, “Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”. Ndërkohë që, me vendim të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, është miratuar “Plani Kombëtar i Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, duke përfshirë edhe fëmijët në situatë rruge 2019-2021”⁵⁶. Ky Plan pasqyron angazhimin

55. Link

56. Link

e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, me detyra të qarta, për të parandaluar, identifikuar dhe ofruar mbrojtje për çdo fëmijë që ndodhet në rrezik, apo në situatë shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge.

Angazhimet e parashikuara në këtë Plan Veprimi janë përfshirë dhe bërë pjesë e Planeve Vendore Sociale të bashkive, të cilat e kanë identifikuar si një çështje parësore. Kështu, janë hartuar plane vendore të veçanta për fëmijë në situatë rruge dhe të shfrytëzuar ekonomikisht në bashkitë Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë, Korçë, Shkodër dhe Bulqizë.

Çështja e sigurisë së fëmijëve online është një nga fushat më të trajtuara në vitet e fundit, mbështetur në njohuritë/studimet e kryera nën kujdesin e UNICEF-it:

- Studimi (Anketa) Kombëtar mbi "Përvojat e Fëmijëve Online"⁵⁷ (2019) shqyrton se si fëmijët e përjetojnë aksesin në internet, çfarë aktivitesh bëjnë dhe cilat janë rreziqet që hasin në mjedisin digjital;
- Studimi Cilësor "Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe gatishmërisë institucionale për trajtimin e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në hapësirën kibernetike"⁵⁸;
- Studimi "Çështjet e Humbura"⁵⁹ hulumton gjendjen, si edhe barrierat që hasin agjencitë ligjzbatuese shqiptare për të pasur një reagim frytdhënës ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve online.

Mbështetur në këto njohuri dhe standardet ndërkombëtare, u hartua dhe miratua VKM-ja nr. 465, dt. 03.07.2019, "Për masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesin në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet".

Një Plan Veprimi, me detyra dhe përgjegjësi konkrete, është nënshkruar mes Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Brendshme dhe CRCA-së në Shqipëri. Në drejtim të mundësimin të internetit të sigurt për fëmijë, AKCESK-ja ka krijuar një Portal të ri Online, ku institucionet përgjegjëse mund të raportojnë faqe me përmbajtje të paligjshme dhe/ose të papërshtatshme për fëmijët, me qëllim bllokimin e tyre. Vetëm si rezultat i raportimeve të Linjës Kombëtare të Ndhmës për Fëmijët ALO 116 111 përmes ASHDMF-së, gjatë periudhës mars - maj 2020, janë raportuar 60 faqe me përmbajtje të dëmshme dhe të paligjshme për fëmijë. Të gjitha këto faqe janë hetuar dhe mbyllur. AKCESK-ja, me mbështetjen e UNICEF-it, gjatë 2019-s, ka përfshirë një kapitull të posaçëm për fëmijët në projekt-Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (2021 – 2025). Gjithashtu, AKCESK-ja dhe UNICEF-i kanë botuar⁶⁰ "Udhëzuesin për njehsimin e politikave të sektorit të industrisë për mbrojtjen e fëmijëve në internet" (2019). Gjatë kohës së pandemisë COVID-19, në mbështetje

57. Link

58. Link

59. Link

60. Link

të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, autoriteteve arsimore, OJQ-ve dhe institucioneve që synojnë t’iu ofrojnë fëmijëve akses në platforma dhe pajisje digjitale të sigurta, janë botuar: 1) Udhëzimi “Si të mbrojmë fëmijët gjatë përdorimit të internetit në pajisjet digjitale⁶¹” dhe 2) Udhëzuesi teknik “Mbrojtja e sigurisë në internet e fëmijëve në platformat elektronike të mësimin në Shqipëri»⁶².

Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit 2020-2025, e miratuar me VKM 1084 datë 24.12.202⁶³, përmban një kapitull të dedikuar për fëmijët.

Janë zhvilluar takime lidhur me sigurinë e përdorimit të internetit nga fëmijët dhe masat që duhet të merren për të parandaluar aksesin në përmbajtje të paligjshme dhe të dëmshme nga fëmijët, shoqëruar me fushata ndërgjegjësimi në shkollat 9-vjeçare. Gjatë vitit 2019, UNICEF-i dhe AKCESK-ja, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, trajnuan 312 (178 vajza dhe 134 djem) edukatorë bashkëmohatarë në përdorimin e manualit “[Këshilluesit e vegjël për sigurinë online](#)”⁶⁴, në 7 rajone dhe 12 shkolla të Shqipërisë (Tiranë, Elbasan, Fier, Lezhë, Kukës dhe Dibër). Manuali u hartua për t’u përdorur nga këshilluesit bashkëmohatarë të moshave 13-14 vjeç (klasa 7 dhe 8). Gjatë vitit akademik 2019

– 2020, janë zhvilluar sesione ndërgjegjësuere me 12 286 fëmijë (6 250 vajza dhe 6 036 djem). Loja interaktive i-child⁶⁵, e cila ndihmon fëmijët që të aftësohen në 8 kategori (mediat sociale, privatësia, materialet e dëmshme, bullizmi kibernetik, reklamat, lojërat online, të dhënat personale dhe grooming) është aksuesuar dhe ka ndihmuar mbi 5 578 fëmijë dhe të rritur.

Prej 2019-s, është zbatuar iniciativa “[Friendly Wi-Fi](#)”⁶⁶ që përfaqëson një zgjidhje teknologjike në mbrojtje të fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme dhe të paligjshme në internet. Deri tani, (2020) iniciativa është shtrirë si rezultat i bashkëpunimit mes Bashkisë së Tiranës dhe UNICEF-it në 13 hapësira publike dhe 4 biblioteka publike të kryeqytetit. Nën drejtimin e Bashkisë së Tiranës, tre ofruesit kryesorë të internetit në vend⁶⁷ i janë bashkuar standardit duke u certifikuar si “Ofrues të Miratuar - Approved Provider”. Vetëm përgjatë 2019-ës, një nga hapësirat publike, “Friendly Wi-Fi”; bllokoi 43 000 kërkesa për të aksesuar përmbajtje të kategorizuara në listat e zeza të internetit dhe 4 000 përmbajtje me abuzim seksual e pornografi me të rritur.

Për fëmijët dhe të rinjtë, gjatë vitit 2020, Bashkia Tiranë dhe UNICEF-i Shqipëri sollën nismën novatore “BiblioTech”, një koncept në formën e hapësirave fizike (bibliotekave publike) që

61. Link

62. Link

63. Link

64. Link

65. Link

66. Wi-Fi Miqësor

67. AlbTelecom; ABCom; Tring

mundësojnë të nxënit dhe zhvillimin në fushën e njohurive digjitale, duke mësuar njëkohësisht rreth sigurisë dhe mbrojtjes në internet. Pritet që, në 2021-shin, kjo nismë të shtrihet në Bashkitë Korçë dhe Shkodër.

Gjatë vitit 2020, u iniciua fushata kombëtare #TëBesoj, e cila synon të ndërgjegjësojë publikun e gjerë mbi problematikën e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve përmes vendosjes së siluetave të fëmijëve në vende publike, ku secila prej tyre paraqet një histori të vërtetë abuzimi të ndodhur ndaj një fëmije shqiptar. Sektori privat, si p.sh. Qendra Tregtare Toptani e Kalaja e Toptanit, e përqaftuan nismën duke mundësuar hapësirat. Bashkitë e Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Beratit dhe Korçës i janë bashkuar kësaj fushate.

Në ofrim të shërbimeve të specializuara për fëmijët-viktima të abuzimit seksual, apo formave të tjera të rënda të dhunës, është përruar ngritja e qendrës LILIUM, pranë mjediseve të Qendrës Spitalore Nënë Tereza në Tiranë, plotësisht me fonde të buxhetit të shtetit. Kjo qendër është e para në Shqipëri që ofron modelin socio-shëndetësor, me një ekip multidisiplinar, me mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës të policisë, prokurorisë, avokatë dhe infermierë. Ajo do të japë shërbim të specializuar e të integruar sipas standardeve 24 orë çdo ditë të javës. Që nga hapja e saj, kanë marrë shërbime në këtë qendër 60 viktima të dhunës seksuale, prej të cilëve, 48 fëmijë. Qendra ka zhvilluar disa takime informuese me

NJMF-të lidhur me funksionimin dhe shërbimet që ofron, duke u bërë pjesë e sistemit të referimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Trajnime të veçanta janë ofruar edhe për fuqizimin e kapaciteteve të vetë punonjësve të kësaj qendre. Ka përfunduar rikonstrukcioni i Qendrës dhe përshtatja e mjediseve të saj në përmbushje të standardeve ndërkombëtare e kombëtare të miratuara. Gjatë pandemisë, u përgatit një rregullore e brendshme e funksionimit dhe administrimit të rasteve në kushtet e COVID-19-s.

Aktualisht, MSHMS-ja, në bashkëpunim me UNICEF-in, mbështetur në analizën e kryer mbi nevojat për realizimin e ndërhyrjeve ndërsektoriale në këtë fushë, po punojnë për ngritjen e dy qendrave kombëtare të specializuara për administrimin dhe trajtimin e rasteve të abuzimit seksual e formave të rënda të dhunës për fëmijët në Shkodër dhe Vlorë.

ASHDMF-ja ka organizuar një seri fushatash, në kuadër të Ditës Evropiane kundër Abuzimit dhe Shfrytëzimit Seksual të Fëmijëve, si dhe gjatë Javës së të Drejtave të Fëmijëve. ASHDMF-ja ka prodhuar materiale informuese dhe sensibilizuese lidhur me abuzimin seksual online dhe ka organizuar aktivitete ndërgjegjësuese në 9 bashki të largëta të vendit, si dhe sesione informuese online me aktorë vendorë.

Është rritur numri i shërbimeve që ofrojnë mbështetje psikologjike në distancë, si shërbimi psikologjik falas, "Linja e gjelbër 0884040" dhe shërbimi që ofron Urdhri i Psikologut nëpërmjet

“Psikologët shqiptarë online” Prej 2019-s, në mbështetje të raportimit të rasteve të dhunës dhe keqtrajtimit të fëmijëve, është realizuar mbështetja e platformës telefonike (Linja Kombëtare e Këshillimit të Fëmijëve Falas) [ALO 116 111](#), edhe nga burimet financiare të Qeverisë. Në bashkëpunim edhe me UNICEF-in e CRCA-në, ALO 116 111 ka trajtuar dhe referuar kërkesat e fëmijëve sipas nevojave të përcjella. Shërbimi është në dispozicion të fëmijëve në të gjithë vendin, 24 orë në 7 ditë të javës dhe çdo ditë të vitit. Vetëm në vitin 2019, rreth 4 765 fëmijë kanë marrë këshillim përmes linjës. Për shkak të COVID-19-s, kërkesat për këtë shërbim kanë qenë të shtuara.

Përgjatë 2019-s dhe 2020-s, UNICEF-i ka mbështetur organizatën “Foundation Together Albania” për të ofruar modelin e këshillimit psikosocial për fëmijët dhe të rinjtë online - [NukJeVetëm](#). Një ekip i specializuar profesionistësh, mjekë, psikologe dhe psikiatër këshillojnë përmes web-it fëmijët dhe të rinjtë në problematika të raportuara mbi raste abuzimi, shfrytëzimi, trafikimi të qenieve njerëzore, përdorimit të substancave abuzive, seksualitetit, mendimeve vetëvrasëse, depresionit etj. Këshillimi është pa pagesë, anonim dhe mbështetet në modelin e “përgjegjesisë sociale” të profesionistëve, të cilët i ofrojnë shërbimet e tyre pa përfitim financiar.

Shërbime emergjente dhe strehim i sigurt në situata krize janë ofruar nga Organizata Nisma për Ndryshim Shoqëror - ARSIS. Ky shërbim i

integruar është i vendosur në Tiranë, por mbulon raste nga i gjithë territori i Shqipërisë. Gjatë vitit 2020, është realizuar mbështetja e 88 rasteve të fëmijëve në rrezik të lartë, ndër të cilët fëmijë-viktima të abuzimit seksual, trafikimit, fëmijë pa kujdes prindëror, në situatë rruge, viktima të shfrytëzimit, të mitur të huaj të pashoqëruar etj.

Në 2020-n, 380 fëmijëve me aftësi të kufizuara të dëgjimit, prindërve dhe kujdestarëve të tyre të prekur nga mbyllja dhe izolimi i shkaktuar nga COVID-19, përmes UNICEF-it dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë, iu sigurua mundësia për të aksesuar dhe komunikuar nevojat e tyre. 15 video u adoptuan për të dhënë informacion mbi kërkimin e ndihmës, raportimin e abuzimit dhe dhunës, trajtimin e stigmës, këshilla për prindërit në lidhje me mbrojtjen në internet etj.

Është miratuar Vendimi Nr. 111, dt. 06.03.2019, “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijëve”, me qëllim garantimin e të drejtave të fëmijëve të pashoqëruar. Qëllimi i këtij Vendimi ishte ngritja e një sistemi të integruar të mbrojtjes dhe bashkërendimit të efektshëm të të gjitha institucioneve shtetërore dhe organizatave jofitimprurëse në trajtimin e kërkesave për kthim/ripranim të fëmijëve të pashoqëruar (shqiptarë/të huaj) dhe inkuadruar mbrojtjen nëpërmjet kthimit të sigurt dhe riintegritit të tyre. Zbatimi i VKM-së është realizuar përmes bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit (policisë kufitare dhe migracionit) në nivel qendror dhe vendor, bashkërenduar nga ASHDMF-ja.

Gjatë 2020-s, nga strukturat në varësi të Policisë së Shtetit/Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, janë identifikuar dhe trajtuar 72 raste të të miturve të huaj të pashoqëruar, për të cilët janë ndjekur procedurat e nevojshme, në përputhje me dispozitat e Vendimit të sipërpërmendur⁶⁸. Me mbështetjen dhe punën e IOM-it, UNCHR-së dhe CARITAS-it, janë përmirësuar kapacitetet pritëse në pikat kufitare, tek qendrat e përkohshme të strehimit në Gerhot, Gjirokastrë, Kapshticë, Korçë, Kakavijë, Qendra e Azilkërkuesve në Babrru të Tiranës, dy qendrat multifunkionale të shërbimeve sociale për kategori vulnerabël, përfshirë të miturit e pashoqëruar të administruar në Gjirokastrë dhe në Ersekë, Korçë. Të gjitha këto struktura pritëse kanë mjedise të përshtatura për të miturit.

Është realizuar rishikimi i Procedurave Standarde të Veprimit, miratuar me VKM-në nr. 499, dt. 29.8.2018, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit", që ngarkon strukturat e Mbrojtjes Sociale në Bashki dhe NJMF/PMF me detyrimin e identifikimit të fëmijëve, së bashku me strukturat e Policisë së Shtetit. Në këtë kuadër, organizata Të Ndryshëm & Të Barabartë ka trajnuar PMF-të nga 61 Bashkitë.

Gjatë vitit 2020, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ka kryer rishikimin e përshkrimeve të punës të funksioneve "Për hetimin e krimeve ndaj të miturve dhe dhunën në familje", me detyra të veçanta "për

identifikimin, mbrojtjen dhe referimin e fëmijëve-viktima dhe/ose viktimave të mundshme të trafikimit", sipas përcaktimeve të "Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit", të miratuara me VKM-në nr.499, dt. 29.08.2018.


Në 2020-n, programi "Transformimi i Reagimit Kombëtar ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria"⁶⁹, me fokus rajonet Tiranë, Kukës, Dibër dhe Shkodër, ka ofruar mbështetje për 24 fëmijë Viktima të Mundshme të Trafikimit (VMT)/Viktima të Trafikimit (VT), të identifikuar në sajë të punës së Ekipeve Lëvizëse në komunitet; 127 fëmijë të mbështetur në kuadër të ndihmesës që iu ofrohet VMT/VT-ve në vend, nëpërmjet shërbimeve nga organizatat e specializuara, si mbështetje ligjore dhe administrative, shkollim dhe aftësim për tregun e punës, strehim i sigurt, përkujdesje shëndetësore dhe psikosociale; 210 fëmijë të asistuar me shërbime emergjence, prej të cilëve, 60% në nevojë për shërbime emergjence për mbrojtjen e fëmijëve në stacionet e policisë dhe 37% e tyre në nevojë për strehim të sigurt; 198 adoleshentë dhe të rinj në rrezik për trafikim janë fuqizuar përmes programit të aftësive të jetës. Një numër rastesh janë identifikuar si adoleshentë të pashoqëruar në rrezik për trafikim në territorin e Shqipërisë. Origjina e tyre raportohet kryesisht nga Egjipti, Palestina dhe Siria dhe janë ndihmuar me strehim në qendrat e emergjencës, në bashkëpunim me ASHDMF-në dhe me Policinë e Kufirit dhe të Migracionit.

68. Vendimi Nr. 111, datë 06.03.2019 "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijëve"

69. Programi është i mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatuar nga një koalicion OJF-sh të drejtuar nga UNICEF.


PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 95% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)



INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 4 është rreth 15.8 milionë lekë⁷⁰ ose 1.0% e kostonë së përgjithshme të Agjendës. 81.7% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët. Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 79.2% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa për 5 masa (ose 20.8%) nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të porealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



70. Shifra e plotë 15,850,000

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMITË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në % ⁷¹	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ⁷²	14 275 000	79.2%	14 275 000	100%	79.7%	20.3%
2 Mosrealizim ⁷³	1 575 000	20.8%				
Gjithsej	15 850 000	100%				

79.7% e shpenzimeve faktike të raportuara kanë si burim financimi buxhetin e shtetit dhe 20.3% fondet e donatorëve. Për një nga fushat e Objektivit 4, është raportuar financimi i një projekti me vlerë rreth 76 milionë lekë për periudhën 2016-2019. Shuma nuk është përfshirë në tabelë, pasi 3 nga masat e përfshira nuk janë të kostuara. Gjithashtu, raportimi është bërë në total dhe jo i ndarë sipas masave.

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Fëmijët në Shqipëri janë ende sot të prekshëm ndaj rrezikut të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit. Dhuna fizike, emocionale dhe psikologjike, si dhe ajo seksuale ndodhin sot në shumë mjedise, përfshirë shtëpinë, shkollën, komunitetin dhe botën virtuale. Dhuna online, në kontekstin e vendit, është një rrezik dhe shqetësim që kërkon të trajtohet më vete për shkak të veçorive dhe risive që ajo paraqet. Sa i përket trajtimit të formave të ndryshme të dhunës tek fëmijët, vihen re mungesa të theksuara në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, që nga identifikimi i hershëm, referimi dhe trajtimi i tyre. Kategoritë më

vulnerabël, si fëmijët nga shtresat më të varfra të popullsisë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në institucione rezidenciale, adoleshentët që i përkasin komunitetit LGBTI, fëmijët migrantë apo refugjatë, si dhe fëmijët që i përkasin komuniteteve rome dhe egjiptiane janë në rrezik të shtuar ndaj formave të ndryshme të dhunës, si bullizmi, stigma, abuzimi apo trafikimi.

Mungojnë të dhëna statistikore të unifikuara dhe, për pasojë, programimi i efektshëm i ndërhyrjeve. Mbledhja e të dhënave bëhet në mënyrë të shpërndarë nga institucionet përgjegjëse dhe nuk ndihmon apo informon analizën gjithëpërfshirëse të fenomenit.

Një çështje shqetësuese është ajo e **abuzimit dhe shfrytëzimit seksual në internet** të fëmijëve në Shqipëri. Kërkohen masa si forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial me aktorë të linjës, por edhe jotradicionalë, si agjencitë rregullatore, sektori privat dhe industrial TIK; hetim i efektshëm dhe ndëshkim i autorëve të krimeve kibernetike ndaj fëmijëve; trajtim i boshllëqeve të kapaciteteve të profesionistëve, prindërve,

71. Përqindjet janë rumbullakosura

72. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

73. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

kujdestarëve, fëmijëve dhe të rinjve; parandalim i abuzimit seksual të fëmijëve në internet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe krijimit të hapësirave të sigurta për lundrimin në internet (në bashkëpunim me sektorin privat); forcim i kuadrit ligjor dhe rregullator për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet; si dhe investime në zgjidhje teknologjike dhe miqësore ndaj fëmijëve në lidhje me kërcënime të ndryshme kibernetike.

Rastet në rritje të **abuzimit seksual dhe shfrytëzimit** nxjerrin në pah mangësi në shërbime të specializuara, që do t'i shërbenin interesit më të lartë të fëmijës, si dhe mungesën e protokolleve dhe profesionistëve të specializuar. Ka mangësi në ofrimin e shërbimeve të integruara multisektoriale për **fëmijët e mbijetuar të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës**. Edhe pse modeli i qendrës LILUM për ofrimin e shërbimeve të integruara për viktimat e dhunës seksuale, apo formave të rënda të dhunës rezulton një zhvillim tejet pozitiv, për trajtimin e rasteve të të miturve, nevojitet konceptimi dhe materializimi i një modeli të specializuar për fëmijë jo vetëm të integruara por edhe të diversifikuara, që të bëjë bashkë aktorët në fushën e mbrojtjes dhe drejtësinë për të mitur.

Zgjerimi i rrjetit të qendrave të **shërbimeve të specializuara** për fëmijët në nevojë për mbrojtje mbetet ende një përparësi. Shërbime të tilla të specializuara i gjejmë të vendosura në nivel kombëtar (Tiranë), apo në nivel rajonal, dhe nevojat e filozofia e ofrimit të shërbimit sa më pranë përfituesit nuk është përmbushur. Ka nevoja

në zhvillimin e kompetencave profesionale të PMF-ve dhe figurave të tjera profesionale vendore në trajtimin e rasteve specifike të fëmijëve-viktima të dhunës seksuale, viktimat/viktima të mundshme të trafikimit etj.

Buxhetimi i institucioneve publike në nivel qendror dhe në atë vendor nuk përputhen me angazhimet e bëra në legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve, apo me angazhimet e marra në kuadër të reformës së shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe në politikat përkatëse.

Në Shqipëri, si pothuajse kudo në Evropë dhe në të gjithë botën, masat e izolimit nga **COVID 19 dhe ofrimi i ndërprerë i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve** kanë përkeqësuar cënueshmërinë e fëmijëve që jetojnë në varfëri, në strehëza të përkohshme, në institucione rezidenciale, në qendra zhvillimore për fëmijë me aftësi të kufizuar, në qendrat e parburgimit, qendrat e përkohshme të migracionit dhe në institucione të tjera të mbyllura. Për shkak të pandemisë, fëmijët që kanë qenë viktimat dhe dëshmitarë të dhunës në familje tani janë në pozitë edhe më të vështirë, pasi, nga njëra anë, ata mund të qëndrojnë të mbyllur së bashku me abuzuesit, por nga ana tjetër, edhe nëse arrijnë të kërkojnë ndihmë, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve është shumë i kufizuar për t'iu përgjigjur nevojave të tyre. Punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve nuk shihen si profesionistë të linjës së parë, për rrjedhojë, rastet e dhunës mund të mbeten të paidentifikuara, të pafuara dhe të patrajtuara.

Pavarësisht miratimit së fundmi të Planit Kombëtar të Veprimit 2019-2021 për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, ngritja e një sistemi të monitorimit të **punës së fëmijëve** dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si **fëmijët në situatë rruge**, mbetet ende sfidë. Po kështu, mbetet i parealizuar, por mëse i nevojshëm, studimi dhe njohja e këtij fenomeni.

Një numër joproportional i **viktimave të trafikimit të fëmijëve** në vend mbeten ende fëmijët romë dhe egjiptianë. Puna në klubet e natës dhe industrinë e argëtimit është një rrezik kryesor për trafikimin e vajzave. Trafikimi për lypje të detyruar dhe veprimtari kriminale është një rrezik i madh i trafikimit për djemtë. Në disa raste, trafikimi lehtësohet ose tolerohet nga prindërit e fëmijës. Në shumë raste brenda kufijve të Shqipërisë, ekziston nevoja për të njohur trafikimin si një fenomen vendas, por edhe ndërkombëtar. Administrimi i rasteve, shpesh, nuk i zgjidh problemet e fëmijëve-viktima të trafikimit. Çështjet e trafikimit janë një shqetësim i veçantë për të rinjtë nga zonat rurale dhe të largëta, për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, fëmijët romë / egjiptianë në situata rruge etj.

Sa i përket marrjes në mbrojtje të **fëmijëve të huaj të pashoqëruar**, vihen re mungesa si procedurale dhe infrastrukturore. Mungojnë

Procedurat Standarde të Veprimit të posaçme për identifikimin, pritjen dhe trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar në Shqipëri me shtetësi të huaj ose pa shtetësi. Aktualisht për trajtimin e tyre, zbatohen procedurat standarde për shtetasit e huaj të parregullt, ku janë integruar dhe përcaktuar masa të veçanta për trajtimin e të miturve. Por, ndaj të miturve, nuk parashikohen lehtësira për pajisje me dokumentacion dhe statusi i tyre është krejtësisht i paqartë gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri.

Vendimi nr. 111, datë 06.03.2019, "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijëve" parashikon veprimet dhe procedurat që do të duhet të ndiqen vetëm për dy kategori: fëmijët si azilkërkues dhe VMT/VT-të, por nuk ka parashikime për fëmijët që janë të huaj të pashoqëruar dhe që nuk përfshihen në asnjë nga kategoritë më sipër. Për pasojë, lind nevoja e rishikimit. Nga ana tjetër, legjislacioni në fuqi nuk parashikon ofrimin e shërbimeve për shtetasit e huaj, të cilët nuk kanë përfituar statusin e azilkërkuesit, apo që kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe luftërave, çka vështirëson së tepërmi ofrimin e shërbimeve për këta fëmijë, duke filluar me strehimin, sigurimin e përkthyesit, ofrimin e menjëhershëm të shërbimit psikologjik dhe atij ligjor.

Gjithashtu, janë vënë re vështirësi në përcaktimin e moshës së të miturve, e cila mbështetet kryesisht në vetëdeklarim. Administrimi i rasteve të të miturve të pashoqëruar, në pjesën dërrmuese të rasteve, nuk shihet si një proces i integruar, por paraqet tiparet e shërbimeve të fragmentarizuara. PMF-të kanë njohuri tejet të përgjithshme për administrimin e këtyre rasteve dhe pak ose aspak dijeni për instrumentet ligjore kombëtarë e ndërkombëtarë për trajtimin e kësaj kategorie të miturish. Shërbimet e kujdesit alternativ komunitar mungojnë plotësisht, ose janë të pamjaftueshme.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Institucione të linjës - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministria e Brendshme/Policia e Shtetit, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar, Njësitë Qendrore Vendore, donatorë dhe organizma ndërkombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve, si Këshilli i Evropës, Bashkim Evropian, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, UNICEF-i, Save the Children, Terre des Hommes; UNCHR-ja, IOM-i, organizata të tjera të shoqërisë civile, si CARITAS-i, ALO 116 111, CRCA/ECPAT-i, Të ndryshëm & të barabartë, Qendra Vatra, Tjetër Vizion, SHKEJ-i, Nisma për Ndryshim Shoqëror - ARSIS, Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë, Foundation Together Albania, sektori privat si AlbTelecom-i, ABCom-i, Tring-u, Sophie etj.


SHTYLLA STRATEGJIKE 3

Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët


Objektivat 5-14

SHTYLLA STRATEGJIKE 3 NË SHIFRA


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (në nr. & %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në nr. & %)



MASAT E BUXHETUARA DHE TË RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në nr. & %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzime të planifikuara në % ⁷⁴	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit Buxheti	Donatorët
1 Realizim ⁷⁵	991 294 500	79.3%	851 757 189	85.9%	40.6%	59.4%
2 Mosrealizim ⁷⁶	258 571 868	20.7%	-	-		
Gjithsej	1 249 856 868		-	-		

74. Përqindjet janë rumbullakosura

75. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

76. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera


OBJEKTIVI 5

Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së kujdesit e edukimit në fëmijërinë e hershme (0 – 6 vjeç)

ARRITJET KRYESORE


Mbështetur në raportimet e bashkive, mbledhur nga ASHDMF-ja, në vitet e fundit, është rritur numri i fëmijëve 0-3 vjeç që regjistrohen dhe ndjekin çerdhet.

GRAFIKU 5: NUMRI I FËMIJËVE 0-3 VJEÇTË REGJISTRUAR NË ÇERDHE



Janë hartuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit (MARS) standardet e zhvillimit dhe të nxënies për fëmijët 0-3 vjeç. Këto standarde janë dërguar në MSHMS, si dhe në të gjitha bashkitë e vendit. Përqindja neto e regjistrimit në nivelin parashkollor është rritur ndjeshëm ndër vite.

GRAFIKU 6: PËRQINDJA E FËMIJËVE 3-6 VJEÇTË REGJISTRUAR NË KOPSHT, NË KRAHASIM ME NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË FËMIJËVE 3-6 VJEÇ



Një këtë fushë, është arritur përparim, veçanërisht, duke përmirësuar kornizën kurrikulare për arsimin parashkollor⁷⁷ dhe standardet e zhvillimit e mësimin për fëmijët nga 3 deri në 6 vjeç⁷⁸, si dhe monitorimin e kornizës për vlerësimin e arsimit parashkollor. MASR-ja, me mbështetjen e UNICEF-it, ka miratuar Standardet Profesionale të Formimit të Përgjithshëm të Mësuesit të Arsimit Parashkollor⁷⁹, si dhe Programet e Arsimit Parashkollor për Moshën 3 - 4 vjeç⁸⁰. Këto dokumente rregullatore përfshijnë koncepte të edukimit mbështetur mbi kompetenca, ndërthurur me elemente të të drejtave, barazisë gjinore,

77. Link

78. Link

79. Link

80. Link

mosdiskriminimit etj. Në lidhje me programet e prindërimit pozitiv në femijërinë e hershme, raportohet se janë trajnuar të gjithë mësuesit e arsimit parashkollor publik. Orientimet për gjithëpërfshirjen, regjistrimin e 5-6-vjeçarëve në kopsht dhe në klasat përgatitore kanë vijuar të jenë pjesë e udhëzimeve të dërguara në fillim të çdo viti shkollor nga MASR-ja.


Njësitë arsimore vendore hartojnë plane dhe veprimtari për realizimin e gjithëpërfshirjes. 100% e tyre zbatojnë standardet, kurrikulën dhe programet e unifikuara të miratuara nga MASR-ja. Nga MASR-ja mbledhen edhe të dhëna dhe raporte për ecurinë e procesit.

Në 2020-n, me mbështetjen e UNCEF-it, është hartuar programi i trajnimit dhe trajnuar 700 mësues parashkollorë e 150 drejtues të kopshteve mbi metodologjinë e të nxënimit me fokus fëmijët.

Gjatë pandemisë COVID-19, përmes bashkëpunimit të MASR-së dhe UNICEF-it, platforma interaktive mësimore online, Akademia.al, mundësoi që 77 858 fëmijë të ciklit parashkollor të qasin/aksesojnë materialet edukative të përshtatura sipas moshës. Ndërsa përmes platformës online, Akelius, në gjuhën angleze, u ofrua mësim për 8 fëmijë refugjatë/emigrantë. Gjithashtu, rreth 50 000 individë u arritën përmes fushatës #mësojmëngashtëpia në media, përfshirë televizionin dhe mediat sociale, me qëllim rritjen e aftësive të prindërve për edukimin e fëmijëve të vegjël. Gjatë 2020-s, përmes bashkëpunimit me NjQV-të, MASR-në dhe UNICEF-in, janë mbështetur 400 çerdhe dhe kopshte (18 200 fëmijë) me paketa higjienike dhe dezinfektimi.


PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020

STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)




INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 5 është rreth 24.6 milionë lekë⁸¹, ose 1.5% e koston së përgjithshme të Agjendës. 60.0% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti duhet të mbulohen nga donatorët dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit.


Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 35.3% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 11 masa (ose 64.7%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të porealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



Shpenzimet e planifikuara për zbatimin e këtij objekti janë realizuar në masën 18.3%. Tri masa të planifikuara me fonde donatorësh, buxheti i të cilave është sa 54.5% e buxhetit të këtij objekti, raportohen të porealizuara.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në % ⁸²	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ⁸³	4 512 500	18.3%	4 512 500	100%	100%	
2 Mosrealizim ⁸⁴	20 080 000	81.7%	0			
Gjithsej	24 592 500	100%				

81. Shifra e plotë 24,592,500

82. Përqindjet janë rumbullakosura

83. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

84. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e koston/buxhetit në raport me masat e tjera

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Është domethënëse niveli i lartë i mosrealizimit të masave me fokus grupmoshën e fëmijëve 0-3 vjeç. Në kuadër të një ndërhyrjeje ndërsektoriale dhe proceseve të decentralizimit e transferimit të përgjegjësive nga niveli qendror në atë vendor, institucionet përgjegjëse - MSHMS-ja dhe Bashkitë - duhet të udhëheqin përpjekjet në këtë drejtim.

Miratimi i standardeve dhe programeve të zhvillimit për fëmijërinë e hershme në moshën 0-3 vjeç, ngritja e kapaciteteve vendore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve të kësaj grupmoshe, si edhe ngritja e kapaciteteve të edukatorëve/kujdestarëve duhet të kthehen në përparësi në të ardhmen.

Programet e prindërimit pozitiv nuk janë të hartuara dhe të integruara në të gjitha fushat e shërbimeve. Kjo lidhet, përgjithësisht, edhe me mënyrën e gabuar të hartimit të Masave të Veprimit, duke e ndarë fëmijën si përfitues nga familja. Një qasje e re, e pasqyruar, në të gjithë fushat e veprimit, me fokus ngritjen e kapaciteteve të prindërve, dhe trajtimin e normave sociale të dëmshme për mirërritjen e fëmijëve, duhet të përshkojë Agjendën e ardhshme.

Një përparësi e mbartur nga më parë mbetet edhe ndryshimi i ligjit për të universalizuar vitin parashkollor, për t'i dhënë një shtysë më të madhe regjistrimit të fëmijëve të kësaj grupmoshe dhe krijimit të një tranzicioni pozitiv të të nxënimit në vitet në vazhdim të arsimit bazë.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, institucione arsimore në nivel vendor, Bashkitë, UNICEF-i.

OBJEKTIVI 6

Përmirësimi i cilësisë dhe aksesit në arsim për fëmijët në arsimin bazë

ARRITJET KRYESORE

Me miratimin më 23/07/2018 të ligjit nr. 48/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (të ndryshuar), sigurohet një qasje e re e përgjegjësive të institucioneve përgjegjëse për sistemin arsimor parauniversitar. Me riorganizimin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, është krijuar Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP). Këto struktura marrin rol kryesor për sigurimin e cilësisë së shërbimit në institucionet e arsimit parauniversitar. Ligji përcakton për herë të parë konceptin e vlerësimit të arritjeve në arsimin fillor.

Angazhimi i institucioneve qendrore ndaj ngritjes së një mekanizmi të përbashkët për identifikimin e fëmijëve jashtë sistemit shkollor dhe integrimin e tyre në shkollë u rikonfirmua me nënshkrimin e marrëveshjes tripalëshe mes Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), MSHMS-së dhe MASR-së "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor". Në vijim të zbatimit të nismës "Çdo Fëmijë në Shkollë" dhe mekanizmave për fëmijët jashtë shkolle, është miratuar Urdhri i Përbashkët nr. 292 "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së

detyrimit shkollor", dt. 19.07.2019. Është hartuar dhe miratuar manuali i trajnimit për monitorimin e fëmijëve jashtë sistemit arsimor dhe fëmijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën, për institucionet arsimore në nivel vendor, i cili është përditësuar në funksion të dokumenteve të përditësuar për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në shkollë⁸⁵. Në vitin 2018, u përgatit një udhëzim i ri administrativ për mënyrën se si duhet të raportojnë shkollat për braktisjen e shkollës, me ndihmën e UNICEF-it. Ndër vite, në NjQV-të e Durrësit, Korçës, Lezhës dhe Shkodrës, ofruesve të shërbimeve në fushën e shëndetësisë, arsimit, policisë, shërbimeve sociale dhe njësisë për mbrojtjen e fëmijëve iu ofrua informacion për zbatimin e këtij mekanizmi, si edhe 1 200 mësues. Paralelisht me këtë përpjekje, u zhvillua një fushatë ndërgjegjësuese, duke synuar prindër dhe fëmijë të grupeve në nevojë, për t'i informuar edhe ata mbi procedurat për regjistrimin e fëmijëve në shkollë. Gjatë pandemisë COVID-19, rreth 300 nxënës në rrezik për braktisje të shkollës morën mbështetje të specializuar socio-emocionale, ndërsa 700 mësues u trajnuan për të siguruar mbështetje të veçantë për këta fëmijë.

Në vitin 2017, u riaktivizua sistemi ROMALB, ku janë hedhur të dhënat për fëmijët romë dhe egjiptianë

85. Link

për vitin 2016, mbi të cilat do të krahasohen të dhënat për vitet në vijim.

Të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë, si dhe ata me aftësi të kufizuar, përfitojnë transport falas për distanca më të mëdha se 2 km të institucionit arsimor nga vendbanimi i tyre, sipas VKM-së nr.682, datë 29.07.2015 e ndryshuar. Të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë, me aftësi të kufizuar, si dhe kategori të tjera në nevojë (16 kategori), në klasat 1-12, përfitojnë tekstet shkollore në përdorim falas, sipas VKM-së nr. 486, datë 17.6.2020, "Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar". Është ngritur mekanizmi i mbështetjes financiare (bursave) për kategorinë e fëmijëve në nevojë, në zbatim të VKM-së nr. 854, datë 24.12.2019, për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 666, dt. 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar.

Për fëmijët me shtetësi të huaj që regjistrohen në kopsht/shkollë, po shihet mundësia e hartimit të një udhëzimi të ri për arsimimin e fëmijëve azilantë. Tashmë, për ta, ka një Plan Veprimi, ku veprimtaritë kryesore janë:

- Trajtim i veçantë psiko-social nga psikologu i shkollës;
- Punë e diferencuar nga secili mësues, për të përshtatur lëndën me nivelin e gjuhës shqipe që ata zotërojnë;

- Orë shtesë për mësimin e gjuhës shqipe me mësuesin e gjuhës shqipe në shkollë;
- Përfshirje e tyre në veprimtaritë e shkollës që ndihmojnë për mësimin e gjuhës shqipe dhe integrimin e tyre.

Gjatë 2020-s, përmes platformës mësimore online, Akelius, (në gjuhën angleze), u siguroa mësimdhënia për 37 fëmijë refugjatë/emigrantë në Shqipëri. Me udhëzimin e MASR-së, nr.17, dt. 9.5.2018, programi i mundësisë së dytë nuk do të vijojë më. Të gjithë fëmijët e mundësisë së dytë, në shtator 2018, u integruan në klasat e zakonshme dhe, me ta, zbatohet Plani Edukativ Individual (PEI).

Në përgjigje të situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe mbështetur në analizën e nevojave të krijuara⁸⁶, MASR-ja, ndihmuar nga UNICEF-i, siguroi mjedise të përkohshme të mësimdhënies për 400 fëmijë, paralelisht, duke ofruar mbështetje emocionale dhe psikologjike.

Gjatë kohës së pandemisë COVID-19, përmes bashkëpunimit të MASR-së dhe UNICEF-it, rreth 31 000 mësues dhe 385 000 nxënës të arsimit fillor, deri tek arsimi i mesëm e i lartë, përfituan nga të mësuarit online përmes platformës mësimore interaktive, [Akademi.al](#); deri më tani, rreth 5 000 video mësimore janë përgatitur dhe shpërndarë përmes kësaj platforme. Për të lehtësuar aksesin e fëmijëve në këtë platformë, janë shpërndarë edhe 5 000 pajisje në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Vodafone-in. Paralelisht, janë hartuar dhe shpërndarë udhëzuesit për përdorim të sigurt të platformave online të të nxënës⁸⁷; është hartuar manuali për Platformën

86. Link


87. Link

'LearnIn' të të nxënit në situata të jashtëzakonshme dhe janë trajnuar mbi 350 mësues, me qëllim fuqizimin e aftësive të tyre për mësimdhënie në distancë/ose të përzier⁸⁸; janë hartuar standardet për informacion, komunikim dhe teknologji për mësuesit, si dhe trajnuar rreth 1 200 mësues lidhur me këto standarde.

Me hapjen e shkollave, MASR-ja dhe UNICEF-i nxorën udhëzimet e sigurisë, të cilat u zbatuan në 2 1000 shkollat në rang vendi. Rreth 460 000 fëmijë përfituan nga materialet higjienike dhe, përmes Save the Children dhe World Vision, siguruan 17 000 maska tekstile për grupet e fëmijëve në nevojë. MASR-ja dhe UNICEF-i, prej 2018-s, kanë ngritur komisionet e emergjencës në institucionet arsimore në 6 rajone dhe trajnuar rreth 98 mësues, në kuadër të zvogëlimit të rrezikut të fatkeqësive/katastrofave natyrore⁸⁹.

PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektivi.

88. Link

89. Link


90. Shifra e plotë 236 185 000

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)



INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 6 është rreth 236.1 milionë lekë⁹⁰, ose 14.5% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 61.2% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiivi janë konsideruar si hendek financiar. Informacioni mbi

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 92.9% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 1 masë (ose 7.1%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të porealizuara nga institucionet. Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 37.1% e shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për Objektivin 6. Realizimi i pjesshëm i shpenzimeve është kryesisht për masën "Sigurimi i transportit falas për në shkollë dhe kopshte i fëmijëve romë dhe egjiptianë që i kanë shkollat/ kopshtet larg (edhe nën 2 km), për arsye sigurie të justifikuar." MASR-a mbulon shpenzimet e transportit vetëm për rastet mbi 2 km. 67.4% e shpenzimeve faktike të raportuara kanë si burim financimi buxhetin e shtetit dhe 32.6% fondet e donatorëve.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në % ⁹¹	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ⁹²	236 185 500	95%	87 728 000	39.1%	67.4%	32.6%
2 Mosrealizim ⁹³	42 840 000	5%				
Gjithsej	236 185 000	100%				

91. Përqindjet janë rumbullakosura

92. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

93. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Pavarësisht përpjekjeve dhe ndërhyrjeve të vazhdueshme, rezultoni të ketë ndryshime në mundësitë për të aksesuar dhe në arritjen e rezultateve pozitive arsimore mes fëmijëve, sidomos, mbi bazën e përkatësisë së pakicave minoritare, gjinisë dhe vendndodhjes gjeografike. Kjo gjë i kufizon mundësitë e shumë prej tyre në të ardhmen për punësim dhe jetesë. Në nivel vendor, pritet një bashkëpunim ndërinstitucional më i fortë për të punuar me fëmijët dhe familjet e tyre për trajtimin e barrierave që çojnë në braktisjen e shkollës. Identifikimi i fëmijëve jashtë sistemit shkollor duhet të shoqërohet me ndryshimet e nevojshme në sistemin e informacionit (EIS) për të krijuar një bazë të saktë elektronike të dhënash, që përfshin fëmijët e regjistruar në sistemin publik dhe atë jopublik. Modeli/programi i identifikimit dhe integritit të fëmijëve jashtë sistemit shkollor të shtrihet edhe përtej arsimit bazë.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, institucionet arsimore në nivel qendror dhe vendor, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Njësitë e Qeverisjes Vendore; UNICEF-i, Save the Children, World Vision.

OBJEKTIVI 7

Përmirësimi i mekanizmave për mjedise gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar

ARRITJET KRYESORE

Koncepti i shkollës qendër komunitare mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe paraqet një qasje gjithëpërfshirëse, që ndërlidh të gjitha aspektet e reformës në arsim me vendosjen e fëmijës në qendër të vëmendjes, ku ndërtohet partneriteti shkollë – familje - komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi. Në këtë frymë, me mbështetjen edhe të partnerëve, MASR-ja raporton se 100% e shkollave hartojnë Plane Veprimi mbështetur në vetëvlerësimin e brendshëm, të pasqyruara në portalin shqk.edu.al.

Janë trajnuar të gjithë koordinatorët e shkollave dhe, në disa shkolla, janë trajnuar nxënës, prindër dhe përfaqësues të komunitetit. Vazhdon puna për ngritjen e kapaciteteve të sa më shumë fëmijëve, prindërve dhe aktorëve të tjerë. 270 shkolla planifikojnë çdo vit veprimtari për Shkollat Qendër Komunitare, të cilat janë monitoruar rregullisht, përfshirë në lidhje me përmbushjen e standardeve

gjithëpërfshirëse në shkolla. Për vlerësimin e nevojave të profesionistëve të mësuesisë, psikologjisë dhe punës sociale në lidhje me gjithëpërfshirjen, janë testuar rreth 17 000 mësues në të gjithë vendin. U përgatit raporti i studimit dhe u përcaktuan nevojat për mësuesit në sistem me vjetërsi 1-19 vjet. Testimi për përcaktimin e nevojave bëhet çdo 4 vjet, sipas udhëzimit nr. 1, dt. 201.1.2017 “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”.

Për të realizuar të drejtën për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, MASR-a, në bashkëpunim me UNICEF-in, Save the Children, dhe World Vision, ka zhvilluar një Plan Veprimi për Arsimin Gjithëpërfshirës në Koherencë me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara – Komenti i Përgjithshëm mbi Arsimin Gjithëpërfshirës. 1100 mësues ndihmës janë përfshirë tashmë në sistem për të siguruar rritjen e aksesit në shkollë për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në 2020-n, përfundoi edhe vlerësimi


i nevojave të zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës⁹⁴ për të informuar nevojën për mbështetje në vitet në vijim.

Terre des Hommes ka hartuar një plan të rritjes së kapaciteteve për personelit e shërbimit psiko-social në sistemin parauniversitar, në përputhje me Manualin e hartuar. Në 2020-n, MASR-a dhe UNICEF-i ka trajnuar 70 psikologë edhe për barazinë gjinore.

Mbështetur në analizën e sektorit⁹⁵, MASR-a, në bashkëpunim me UNICEF-in, ka hartuar Projekt-Strategjinë e Arsimit deri në 2026-n, me fokus të veçantë në identifikimin dhe përfshirjen e grupeve më të marginalizuara në arsim, si edhe përfshirjen e komponentëve të barazisë gjinore. Strategjia pritet të miratohet në 2021-shin.

PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektivi.

94. Link

95. Link


96. Shifra e plotë 193 769 368

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020

STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)




INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 7 është rreth 193.7 milionë lekë⁹⁶, ose 11.9% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 12.7% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektivi është planifikuar të mbulohet nga fondet e donatorëve.


Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMITË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për shpenzimet faktike për 55.6% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 4 masa (ose 44.4%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të parealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 90.1% e shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për Objektivin 7. 85.9% e shpenzimeve faktike të raportuara kanë si burim financimi buxhetin e shtetit dhe 14.1% fondet e donatorëve.

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Masat e parashikuara mbi Buxhetimin Elastik nuk kanë gjetur zbatim gjatë periudhës 2017 – 2020. Mungon ekspertiza teknike dhe burimet financiare për të realizuar një studim, apo për të pilotuar e modeluar një ndërhyrje të tillë. Është e rëndësishme që, përtej mësuesit ndihmës, shkollat të kenë mjediset, pajisjet dhe personelin e nevojshëm të mirëtrajnuar për të siguruar një mjedis gjithëpërfshirës për fëmijët, veçanërisht, ata me aftësi të kufizuara. Përparësi në vitet në vijim duhet të vazhdojë të jetë zbatimi i Projekt-Strategjisë të Arsimit, që përfshin vendosjen në dispozicion të burimeve të nevojshme financiare, monitorimin dhe vlerësimin e efektshmërisë së masave të përfshira në të.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,
 Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar,
 World Vision, Save the Children, Terre des Hommes, UNICEF.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në % ⁹⁷	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ⁹⁸	174 550 000	90.1%	174 550 000	100%	85.9%	14.1%
2 Mosrealizim ⁹⁹	19 219 368	9.9%				
Gjithsej	193 769 368	100%				

97. Përqindjet janë rumbullakosura

98. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

99. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

OBJEKTIVI 8

Përmirësimi i proceseve demokratike në shkolla

ARRITJET KRYESORE

Si pjesë e procesit të saj të përgjithshëm të reformimit dhe demokratizimit, Shqipëria ka ndërmarrë reforma të rëndësishme në arsim, përfshirë decentralizimin e qeverisjes së shkollës.

Me hartimin dhe zbatimin e standardeve për Shkollat si Qendër Komunitare, janë rritur mundësitë për një pjesëmarrje më të gjerë të grupeve të interesit në strukturat qeverisëse të shkollës, veçanërisht, të fëmijëve dhe prindërve. Me ndihmën edhe të organizatave e donatorëve mbështetës, janë realizuar veprimtari fuqizuese për pjesëtarët e Qeverive të Nxënësve dhe Bordeve të Prindërve.

Një risi e nr. 48/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 69/2012, Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar) është krijimi i bazës ligjore për Këshillin Kombëtar të Prindërve, si një strukturë e prindërve në nivel kombëtar. Gjithashtu, ligji siguron përmirësimin e kriterëve dhe standardeve profesionale të lidershit të institucioneve shkollore.

Të gjitha shkollat kanë programe për trajnimin e prindërve. Këto janë të planifikuara në tema

të veçanta, në orët e takimeve me prindër, ose veprimtari të tjera shkollore. Çdo institucion arsimor, në fillim të vitit shkollor, ngre Këshillin e Prindërve që formohet nga Këshillat e Prindërve të Klasës. Këshilli i Prindërve të shkollës ka përfaqësuesin e vet në Bordin e Shkollës. Janë ngritur Këshillat Rajonalë të Prindërve nga të cilat është formuar Këshilli Kombëtar i Prindërve, një organ këshillimor për MASR-në me mandat 4-vjeçar.

Të gjitha shkollat përfshijnë Qeveritë e Nxënësve në hartimin dhe miratimin e planit vjetor të shkollës, duke mundësuar realizimin e veprimtarive që përmbushin funksionet e tyre, sipas udhëzimit të ndryshuar në tetor 2019. Gjatë vitit 2020, është ngritur Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë, organ përfaqësues në nivel kombëtar, që ka për qëllim pjesëmarrjen aktive të Qeverisë së Nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të Shqipërisë në proceset e vendimmarrjes dhe rritjes së cilësisë së procesit mësimor.


Komisionet e Etikës në shkolla kanë detyrimin e trajtimit të të gjitha rasteve të dhunës, apo sjelljeve të dhunshme të raportuara. Detyrat janë detajuar

në “Rregulloren e funksionimit të institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me Urdhrin nr. 31, dt. 28.1.2020. Në kartën e performancës, një element i monitorimit është “krijimi i një mjedisi psiko-social që synon eliminimin e dhunës (fizike, psikologjike, sjelljeve të rrezikshme). (Pyetësor me prindër, nxënës, mësues). Për vitin shkollor 2018-2019, këto komisione kanë trajtuar rreth 4 365 raste.¹⁰⁰

Si pjesë e procesit të reformës në arsim, përfshihet prezantimi i kurrikulës së mbështetur në kompetenca. Reforma e teksteve shkollore është zhvilluar paralelisht me reformën kurrikulare. Tekstet shkollore iu janë nënshtruar një konkursi sipas standardeve të mirëpecaktuara, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe konventat e ratifikuara nga Shqipëria, ku promovimi, edukimi dhe respektimi i të drejtave, barazisë gjinore, mosdiskriminimit etj. kanë qenë tejet të qarta.


PROGRESI I MASAVETË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020

STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)



Treguesi i rezultatit për vlerësimin e progresit të këtij objekti rezultoi i realizuar në masën 100%, që do të thotë se, gjatë periudhës raportuese, ka një përmirësim të dukshëm në procese demokratike në shkolla.

INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 8 është rreth 18 milionë lekë¹⁰¹, ose 1.1% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 61.5% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti duhet të mbulohet nga donatorët dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit.

100. Informacioni i raportuar për komisionet etike në shkolla duhet parë i ndërlidhur me atë që raportohet në Objektivin 4.

101. Shifra e plotë 18,062,500


Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMITTË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për shpenzimet faktike për të gjitha masat e kostuara/buxhetuara.

STATUSI I RAPORTIMITTË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMITTË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në % ¹⁰²	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ¹⁰³	18 062 500	100%	18 062500	100%	61.5%	38.5%
Gjithsej	18 062 500	100%				

102. Përqindjet janë rumbullakosura

103. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

REFLEKTIVE PËR TË ARDHMEN

Vendimet në lidhje me burimet financiare të shkollave vijojnë të merren në nivel qendror nga Ministria, Drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore arsimore, çka e zvogëlon autonominë e tyre. Paralelisht, kapaciteti i shkollave për të reflektuar mbi politikat dhe praktikën e tyre është kyç për t'i përdorur me efektshmëri burimet shkollore. Duhet më shumë investim në rritjen e kapacitetit planifikues dhe vetëvlerësimit, ku shkollat të kuptojnë vlerën e vërtetë të këtyre proceseve. Fuqizimi i mekanizmave të pjesëmarrjes së prindërve dhe nxënësve në shkolla përbën një masë që duhet të jetë përparësi e së ardhmes.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

institucionet arsimore,

në partneritet të ngushtë me UNICEF-in,

Save the Children dhe World Vision.

OBJEKTIVI 9

Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në drejtësi

ARRITJET KRYESORE

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve është një ndër përparësitë kyçe të Ministrisë së Drejtësisë (MD), e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare, nën objektivin madhor “Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen e efektshme procedurale”.

Në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor civil, penal dhe administrativ, në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve, janë miratuar:

- Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”. Kodi përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që

përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç. Kodi ka reformuar trajtimin e të miturve përpara institucioneve të drejtësisë penale, duke mundësuar masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal, ose zbatimin e masave të drejtësisë restauruese, si mundësi e parë nga organi kompetent.

- 6 akte nënligjore shoqëruese të Kodit¹⁰⁴ (edhe një projekt-vendim në pritje të miratimit). Gjithashtu, paketa e 9 urdhrave dhe udhëzimeve¹⁰⁵ të MD-së, në zbatim të Kodit, është e miratuar dhe tashmë ka filluar zbatimin e tyre nga institucionet ligjzbatuese.
- Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”
- “Strategjia e Drejtësisë për të Miturit”¹⁰⁶, e shoqëruar me Planin e Veprimit, me vizionin

104. Link

105. Link

106. Link

e garantimit të një drejtësie miqësore për fëmijë dhe mbrojtjes së interesin më të lartë të tyre”. Është krijuar Mekanizmi Monitorues i Strategjisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve në nivel të lartë drejtues të 17 institucioneve, që janë njëkohësisht edhe institucione përgjegjëse në zbatimin e strategjisë, dhe është siguruar raportimi periodik i progresit¹⁰⁷.

- Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ku (neni 11) të miturit janë cilësuar si subjekte të posaçme, të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre, janë përfitues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 79, dt. 30.05.2019¹⁰⁸, përcakton rregulla mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur. Gjithashtu, me anë të këtij vendimi, ngarkohen Këshillat e Gjykatave për zbatimin e tij dhe përditësimin e listës së gjyqtarëve që specializohen në fushën e drejtësisë penale për të mitur e trajnimin vazhdues të tyre. Rezultat i menjëhershëm është ndjerë në zbatimin e Vendimit, duke çuar në rritjen e numrit të gjyqtarëve të angazhuar në çështjet të drejtësisë për të mitur nga 12 (2018) në 143 (2002).
- Ministria e Drejtësisë ka ndër marrë nisma ligjore lidhur me disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9062, dt. 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 9695, dt. 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, gjithashtu,

i ndryshuar. Ndryshimet që propozohen për përmirësim synojnë të ofrojnë zgjidhjet më optimale që garantojnë interesin e tij më të lartë, si dhe nevojën e fëmijës për t’u rritur dhe edukuar në një mjedis familjar sa më të përshtatshëm për mirëqenien e tij, kur familja biologjike nuk ka mundësi t’i ofrojë një mjedis të tillë.

Si pjesë e zbatimit të kuadrit ligjor, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare e kombëtare, janë hartuar kurrikulat e trajnimeve të profesionistëve dhe janë zhvilluar trajnime të shumta nga institucionet përgjegjëse:

- Shkolla e Magjistraturës ka miratuar manualin e trajnimit mbi drejtësinë për të mitur për gjyqtarë e prokurorë dhe ka zhvilluar 13 aktivitete trajnimi gjatë të cilave kanë marrë pjesë dhe janë trajnuar 132 gjyqtarë e 150 prokurorë.
- Akademia e Sigurisë ka organizuar 4 sesione trajnimi dyjavore, gjatë të cilave janë trajnuar 180 punonjës policie, të cilët do të trajtojnë rastet/çështjet me të mitur.
- ASHDMF-ja ka trajnuar 7 PMF të qyteteve Tiranë, Dibër, Shkodër, Elbasan, Laç, Librazhd, Përrenjas, Kamëz, Durrës, Vlorë, Korçë, Maliq dhe Lezhë.
- Dhoma e Avokatisë Shqiptare ka përgatitur udhëzues dhe trajnim mbi Drejtësinë Miqësore për të Miturit, dhe, veçanërisht, rolin e Avokatit në Përdorimin e Programeve

107. Link

108. Link

të Drejtësisë Restauruese dhe Masave të Shmangies nga procesi penal për fëmijët në konflikt me ligjin. Gjithashtu, është zhvilluar kursi/trajnimi online me pjesëmarrjen e 30 avokatëve, 24 prej të cilëve e kanë kaluar me sukses këtë kurs.

- Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka trajnuar 17 ndërmjetës në Tiranë, Durrës, Korçë dhe Elbasan.
- Shërbimi i Provës ka trajnuar 75 punonjës të trajnuar mbi drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin tek të miturit.
- Janë shtuar në kurrikulën e trajnimit të personelit të burgjeve që punon me të miturit edhe temat mbi intervistimin motivues, modelin RNR (risku-nevoja-reagimi), zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë sociale.
- Është hartuar Programi Mësimor dyjavor për “Teknikat e Intervistimit Shkencor të të Miturve”.
- Qendra (Zyra) e Zhvillimit për Drejtësinë Penale për të Miturit në prokurori ka përfunduar tashmë manualin e hetimeve në fushën e drejtësisë penale për të mitur. Manuali prej afërsisht 100 faqesh është një “manual xhepi” praktik dhe përmban listat e kontrollit për tema të rëndësishme të procesit hetimor, që do të përdoren nga hetuesit e krimit dhe punonjësit e policisë.
- Në lidhje me ngritjen e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, në bashkëpunim dhe me aktorë ndërkombëtarë, janë diskutuar modulet konkrete të trajnimit, duke u përqendruar tek grupet vulnerabël.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) ka tashmë të krijuar dhe funksionale faqen zyrtare ndihmajuridike.gov.al, në të cilën është botuar çdo informacion që lidhet me ndihmën juridike të garantuar nga shteti, duke siguruar kështu informacion dhe mundësi për të zbatuar dhe përfituar nga ky sistem. Për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, është duke vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes platformës juristionline.al. Materialet që targetojnë të miturit përmbajnë informacion në gjuhë të thjeshtë (joteknike), të kuptueshme dhe të qartë mbi sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet e përfitimit, mënyrës së zbatimit dhe ofruesit e këtij shërbimi (mbështetur nga CRCA/ ECPAT-i). Janë ndërtuar 5 Qendra të shërbimit të ndihmës juridike në Lushnjë, Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë. Në 2020-n, janë autorizuar 10 OJF për të ofruar ndihmë juridike falas, mes tyre edhe organizata që punojnë me fëmijët.

Për sa i përket përshtatjes së infrastrukturës fizike miqësore ndaj të miturve:

- Në 2020-n, me mbështetjen e UNICEF-in, ka përfunduar përshtatja infrastrukturore, mobilimi dhe pajisja me aparataturat e nevojshme e 7 Njësive për Intervistimin e të Miturve, (në Drejtoritë Vendore të Policisë në Korçë, Sarandë, Fier, Peshkopi, Kukës, Berat dhe Gjirokastrë). Të pajisura me teknologjinë e fjalës së fundit dhe në respekt të standardeve, do të shërbejnë për fëmijët e të rinjtë në kontakt ose në konflikt me ligjin. Gjithashtu, këto mjedise do të përdoren për intervistimin

e viktimave të krimeve seksuale dhe atyre të trafikimit. Gjithashtu, 4 hapësira miqësore pranë Komisarariatit nr.5 dhe 6 janë përfunduar në Bashkinë Tiranë dhe Kamëz, si dhe në Komisariatin Kurbin dhe Lezhë dhe janë në funksion të plotë të përdorimit (mbështetur nga NISMA dhe World Vision).

- Ambientet pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë përshtatur, duke ofruar hapësirat e duhura fizike.
- Gjatë kësaj periudhe, mbështetur tek të dhënat e dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se janë përshtatur mjediset në 9 Prokurori pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, duke krijuar mjedisë miqësore për të miturit.

Në kuadër të zbatimit të kuadrit ligjor, janë nënshkruar 33 marrëveshje mes MD-së dhe Bashkive¹⁰⁹. Objekti i nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve mes Palëve është vendosja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për realizimin dhe mbikëqyrjen e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe dënimi për të miturit në konflikt me Ligjin. NICEF-i ka përgatitur një projekt-udhërrëfyes mbi "Bashkërendimin Vendor të Drejtësisë Miqësore për Fëmijët dhe Administrimin e Bashkërenduar të Rastit të Fëmijëve në Konflikt ose Kontakt me Ligjin."

Në rastin e Bashkive Gjirokastër dhe Berat, marrëveshjet janë tripalëshe mes MD-së, Bashkive

përkatëse dhe UNICEF/Save the Children, me qëllim zbatimin e një modeli ndërsektorial të administrimit të të miturve në konflikt dhe në kontakt me ligjin. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, deri tani, 296 fëmijë kanë marrë ndihmë ligjore falas, mbështetje psiko-sociale, shërbime të drejtësisë restauruese, mbështetje për integrim ekonomik, referim etj.; 120 fëmijë dhe të rinj kanë marrë informacion mbi parandalimin dhe zgjidhjen me metoda restauruese të konflikteve dhe njohjes së të drejtave e shërbimeve që përfitojnë të miturit autorë, viktimë, dhe dëshmitarë të veprave penale; 204 prindër kanë marrë pjesë në programet e prindërimit pozitiv; 62 profesionistë janë trajnuar mbi administrimin ndërdisiplinar/sektorial të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin.

Gjatë vitit 2020, përmes mbështetjes së Terre des Hommes, janë hartuar protokollit i punës për administrim të rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin, instrumenti i monitorimit të protokollit dhe manuali i trajnimit të trajnerëve për protokollin. Këto priten të miratohen nga MSHMS-ja dhe MD-ja në 2021-n. Ndërkohë, mbështetur në këto dokumente, ka nisur zbatimi i modelit të shërbimeve të integruara në Bashkinë e Tiranës, në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashkinë Tiranë. Si rrjedhojë, është bërë e mundur mbështetja me plane individuale të riintegrit të 25 fëmijëve e të rinjve në konflikt/kontakt me ligjin, të cilët janë referuar nga Shërbimi i Provës dhe/ose PMF-të e Bashkisë Tiranë. Pranë MD-së, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimi të Përparësive dhe Statistikave, një

109. Link

strukturë përgjegjëse për procesin monitorues dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Në këtë kuadër, MD-ja boton të dhëna dhe analizë të tyre si pjesë e Vjetarit Statistikor¹¹⁰. MD-ja, me mbështetjen e UNICEF-it, ka ndërtuar Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili, për herë të parë, do të sigurojë unifikimin dhe kompjuterizimin në kohë reale të të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur, me qëllim përmirësimin e politikave shtetërore për fëmijët. Në përmbushje të detyrimit ligjor¹¹¹, sistemi përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, që nga çasti kur të miturit hyjnë në zinxhirin e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë e deri kur dalin prej tij; të dhëna të cilat mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Sistemi i mundëson MD-së dhe organeve të tjera publike të mbledhin të dhëna dhe të gjurmojnë edhe rastet e të miturve viktime apo dëshmitarë të krimit.


Në përmbushje të detyrimit për informim ligjor të fëmijëve dhe familjeve, gjatë vitit 2019, është hartuar, përmes konsultimit me fëmijët, versioni miqësor për fëmijët i ligjit "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", shoqëruar me veprimtari prezantuese të tij. Në këtë drejtim, portali "Zëri i fëmijëve" i është shtuar faqes elektronike të ASHDMF¹¹²-së dhe përmban edhe materiale informuese lidhur me edukimin ligjor të fëmijëve. Gjithashtu, është hartuar dhe vënë në zbatim

paketa e re kurrikulare me njohuri juridike, e cila iu është bërë e njohur mësuesve të qytetarisë nëpërmjet trajnimeve. E gjithë politika arsimore ka në themel parimet e demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe të shtetit të së drejtës. Kjo shprehet në të gjitha dokumentet themelore të kurrikulës:

- Korniza kurrikulare (si parim);
- Dimension që trajtohet në mënyrë progresive, sipas moshës në të gjithë kurrikulën e lëndës Qytetaria për klasat 1-10;
- Edukimi ligjor përbën boshtin e programit të lëndës Qytetaria, klasa 10.
- Gjatë pandemisë së COVID-19, institucionet janë udhëhequr nga Nota Teknike¹¹³, që shërben si udhërrëfyes për 1.vendosjen e një moratoriumi për hyrjet e reja të të miturve në mjedise të privimit të lirisë; 2.lirimin e të gjithë atyre të miturve që mund të lirohen në siguri të plotë dhe 3.mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së gjithë atyre të miturve që iu duhet të mbeten në burgim.

PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



110. Link


111. Link

112. Link

113. Link


Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020

STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)




Dy treguesit më të spikatur të realizuar janë ulja e theksuar e numrit të të miturve në paraburgim: nga 43 (2016) në 19 (2019). Po kështu, koha mesatare e qëndrimit të të miturve në paraburgim është zvogëluar ndër vite dhe, aktualisht, është nën 90 ditë, në përputhje kjo me standardet e Kodit.

INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 9 është rreth 170.7 milionë lekë¹¹⁴, ose 10.5% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 79.2% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa


tjetër nga donatorët. Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 73.7% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 5 masa (ose 26.3%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të porealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 61.8% e shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për Objektivin 9. Realizimi i një mase është raportuar me fonde të donatorëve, por masa nuk është e kostuar dhe nuk është përfshirë në raportim.

114. Shifra e plotë 170 705 000

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMITË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

	Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në %115	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Donatorët
1	Realizim ¹¹⁶	167 780 000	98.3%	105 528 060	62.9%	67.7%	32.3%
2	Mosrealizim ¹¹⁷	2 925 000	1.7%				
	Gjithsej	170 705 000	100%				

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Krijimi i institucioneve të reja në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit është kusht për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për të vënë në zbatim aktet nënligjore, masat alternative të dënimit, si dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri. Për këtë qëllim, mbetet si përparësi vazhdimi i punës për ngritjen e institucioneve: *Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve*, institucion ky i konceptuar si një mekanizëm në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që do të hartojë programe parandaluese dhe do të mbikëqyrë për një periudhë 6-mujore të miturit pas përfundimit të dënimit. *Institucioni i Edukimit dhe Rehabilitimit të të Miturve*, institucion ky i konceptuar si një mekanizëm pranë të cilit do të zbatohen programet e rehabilitimit dhe riintegrimin për të miturit që janë dënuar nga gjykata me dënimin e kufizimit të lirisë. Institucioni do të funksionojë si një institucion gjysmë i hapur, ku të miturve do t'iu kufizohet liria e veprimt/lëvizjes në atë masë që parandalohet kryerja e veprave penale prej tyre dhe, veçanërisht, synohet riintegrimi dhe rishoqërimi i të miturit në komunitet.

Po kaq i rëndësishëm mbetet vazhdimi i punës në rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të

fushës, si edhe bashkëpunimi ndërmjet hallkave të sistemit të drejtësisë dhe strukturave të pushtetit vendor për të zbatuar në praktikë legjislacionin për drejtësinë për të miturit.

Pavarësisht ndryshimeve të ndodhura në Kodin e Familjes në lidhje me birësimet, duhet ende punë për ta bërë funksional mekanizimin e deklarimit të braktisjes, me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe duke mos i mbajtur këta të fundit “peng” në institucionet rezidenciale deri në mbushjen e moshës madhore. Kjo rezulton në pengimin e fëmijëve pranë familjeve biologjike dhe, nga ana tjetër, pamundësinë për gjetjen e një familjeje alternative, përmes vendosjes së tyre pranë një familjeje birësuese.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, Urdhri i Psikologut, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve; Zyrat në nivel vendor të Shërbimit të Provës dhe NJMF-të, UNICEF-i, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, EU/Euralius, UNDP-i, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, CRCA/ECPAT-i Shqipëri, Nisma për Ndryshim Shoqëror - ARSIS, World Vision, Terre des Hommes, Save the Children; Qendra e Berlinit për Ndërmjetësimin e Integruar, Fondacioni “Zgjidhja e konflikteve dhe pajtimi i mosmarrëveshjeve”.

115. Përqindjet janë rrumbullakosura

116. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi ‘realizim’ i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

117. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

OBJEKTIVI 10

Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor për foshnjat dhe fëmijët

ARRITJET KRYESORE

Në 2018-n, sistemi shëndetësor u riorganizua përmes krijimit të strukturës së Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH), që përfaqëson tërësinë e institucioneve përgjegjëse për administrimin dhe ofrimin e shërbimit shëndetësor parësor e shërbimit spitalor¹¹⁸. OSHKSH-ja u shtri në të gjithë territorin me 4 Drejtori Rajonale të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe 36 degë të Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor në të gjitha rrethet e Shqipërisë (NJVKSH).

Në 2019-n, me mbështetjen e UNFPA-së, u riaktivizua Komiteti i Shëndetit Riprodhues, si një organizëm që do të drejtojë dhe bashkërendojë përpjekjet në këtë fushë. Përparësitë e caktuara nga Komiteti përfshijnë mes të tjerave: ndryshimin e Ligjit të Shëndetit Riprodhues, rishikimin e udhëzuesve dhe protokolleve klinike për kujdesin shëndetësor parësor, krijimin e një sektori të

posaçëm për shëndetin riprodhues në MSHMS etj. Në këtë frymë, po rishikohen dokumentet kryesore të 10-vjeçarit të fundit të miratuar në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës, si dhe është përgatitur projektligji për shëndetin riprodhues.

Standardet e shërbimit të konsultoreve për nënën dhe fëmijët janë hartuar dhe përfshirë në paketën bazë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Në 2017-n, MSHMS-ja, në bashkëpunim me UNFPA-në, ka hartuar protokollat dhe paketën e trajnimit për shërbimet shëndetësore, me fokus shëndetin riprodhues, në kohë krize dhe situatash të jashtëzakonshme. Ndërkohë, ndër vite, është kryer trajnimi i personelit të qendrave shëndetësore lidhur me zbatimin e udhërrëfyesve, protokolleve dhe standardeve përkatëse për shëndetin e gruas shtatzënë, nënës dhe mirërritjes së fëmijës.

Në kuadër të COVID-19-s, me mbështetjen e UNFPA-së, është hartuar manuali "Përgatitja dhe

118. Link

reagimi ndaj nevojave të shëndetit seksual dhe riprodhues në situatë pandemie të COVID-19-s” Ky manual shërben si Paketë Minimale Fillestare e Shërbimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues dhe në përputhje me Standardet Minimale të Sferës në Përgjigjen Humanitare. Në lidhje me këtë, gjatë 2020-s, nëpërmjet zbatimit të teknologjisë, janë ofruar 20 sesione online për 360 punonjës të qendrave shëndetësore dhe strukturave vendore të OSHKSH-së.

MSHMS-ja ka hartuar standardet e qendrave publike dhe jopublike të ofrimit të shërbimeve të integruara, me qëllim parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme, përfshirë HIV/AIDS-in dhe Tuberkulozin për të gjitha kategoritë e rrezikuara, si dhe të ofrimit të mbështetjes për kategoritë e prekura, përfshirë fëmijët.

Në 2019-n, skema e rimbursimit të barnave është zgjeruar për të përfshirë fëmijët dhe të rinjtë deri në 25 vjeç që vuajnë nga diabeti, të cilët mund të tërheqin 2 herë në vit sasinë e plotë të fushave falas për matjen e glicemisë, duke i kursyer çdo familjeje 12 mijë lekë të reja në muaj.

Pilotimi i qasjes multidisiplinare të ofrimit të shërbimit në Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor është realizuar nëpërmjet zbatimit të një ndërhyrjeje në Durrës: “Bashkë për shëndetin e fëmijëve me aftësi të kufizuara” - me fokus rritjen e kapaciteteve të punonjësve shëndetësorë të kujdesit parësor në lidhje me identifikimin dhe referimin në kohë

të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shërbimet shëndetësore. Strukturat e operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor vazhdojnë monitorimin mbi plotësimin e treguesve të shëndetit riprodhues në qendrat shëndetësore.

UNICEF-i ka vazhduar mbështetjen në zhvillimin e kapaciteteve të punonjësve të kujdesit shëndetësor për të përdorur një qasje holistike të kujdesit për fëmijët, përgatitjen e instrumenteve të standardizuar për ofrimin e shërbimeve dhe zhvillimin e mekanizmave për bashkëpunimin ndërsektorial¹¹⁹. 180 punonjës të kujdesit shëndetësor në 4 rajone (Tiranë, Korçë, Elbasan, Vlorë) kanë fituar njohuri dhe aftësi për vizitat në shtëpi. Elementet e zhvillimit të fëmijëve, identifikimit të hershëm të aftësive të kufizuara, mbrojtjes së fëmijëve, çështjet gjinore u prezantuan për herë të parë në trajnimet e akredituara të profesionistëve të kujdesit shëndetësor. Gjatë vitit 2018, nga Shërbimi i Psikiatrisë, Klinika e Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoleshentëve në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës, u hartuan protokolle të trajtimit të disa prej çrregullimeve më të shpeshta të shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët, të zbatueshëm në të tre nivelet e ofrimit të kujdesit shëndetësor (Primar, Sekondar dhe Terciar):

- Protokollin Klinik për trajtimin e depresionit tek fëmijët dhe adoleshentët;
- Protokollin i Kujdesit Diagnostiko dhe Terapeutik për Çrregullimet Obsesion- Kompaseve tek Fëmijët dhe Adoleshentët;

119. Bazuar në konsultimet me përfaqësuesit në fushën shëndetësisë, mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve, si dhe përfaqësuesit e qeverisë vendore.

- Protokoli Diagnostik dhe Terapeutik për sjelljet vete dëmtuese të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Në kuadër të masave ndaj COVID-19-s, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe USAID-in, 1136 punonjës të kujdesit shëndetësor, në 38 institucione të ofrimit të shërbimit, u siguruan me pajisjet e mbrojtjes vetjake. Bashkërenduar nga OSHKSH-ja, u shpërndanë dezinfektantë për 10 000 punonjësit në të gjitha (407) Qendrat e Kujdesit Shëndetësor Parësor. Universiteti i Mjekësisë ka nisur hartimin e protokollove të parandalimit dhe mbrojtjes ndaj infeksioneve për shërbimin e neonatologjisë dhe pediatrik në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. Ndërkohë, janë siguruar strukturat shëndetësore me pajisje, si monitore, defibrilatorë etj. Një fushatë komunikimi për prindër e fëmijë #përqafojmëmezëmër ka arritur me mesazhet për mbrojtjen ndaj COVID-19-s më tepër se 500 000 fëmijë.


Gjithashtu, ka vazhduar sigurimi i programit të vaksinimit dhe shumëfishimi i vaksinave të gripit falas për fëmijët dhe familjet në nevojë, sipas përcaktimeve të Institutit të Shëndetit Publik. Nuk ka pasur ndërprerje në ofrimin e shërbimeve për kujdesin e gruas shtatzënë apo të shëndetit të fëmijëve.

ISHP-ja, në bashkëpunim me AKSHI-n, kanë përmirësuar sistemin e informacionit të vaksinimit online dhe po punojnë që ta lidhin atë me të gjitha sistemet e tjera shtetërore, siç janë regjistri i gjendjes civile, e-albania etj. Sistemi i përmirësuar

është testuar dhe po punohet me trajnimin e personave kryevaksinatore e, më pas, vaksinatore, për t'u shtrirë gradualisht në të gjithë vendin.


PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)



INFORMACION MBI BUXHETIN

Sistemi shëndetësor në Shqipëri është një partneritet i kombinuar midis sektorit publik dhe atij privat, por shteti siguron pjesën më të madhe të shërbimeve në fushën e promovimit, parandalimit, diagnostikimit dhe kurimit. Sektori privat mbulon shërbimet farmaceutike dhe ato stomatologjike, si dhe disa klinika diagnostikuese specialitetesh, të përqendruara kryesisht në Tiranë. Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 10 është rreth 217.9 milionë lekë¹²⁰ ose 13.4% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 95.7% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti është planifikuar me burime financiare nga donatorët. Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në % ¹²¹	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ¹²²	215 332 500	96%	215 332 500	100%	4%	96%
2 Mosrealizim ¹²³	2 587 500	4%				
Gjithsej	217 920 000	100%				

120. Shifra e plotë 217 920 000


121. Përqindjet janë rumbullakosura

122. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

123. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

Institucionet kanë dhënë informacion për shpenzimet faktike për 75% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa për, 4 masa (ose 25.0%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të përealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 98.8% të shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për Objektivin 9. 92.9% e shpenzimeve faktike lidhet me zbatimin e vetëm një mase, që është rritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor, të kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor.

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Ndryshimi i kohëve të fundit i strukturës së organizimit të kujdesit shëndetësor me prezantimin e OSHKSH-s nxjerr në pah nevojën për të çuar më tej punën për racionalizimin e shërbimeve dhe burimeve financiare e njerëzore.

Në përgjigje ndaj numrit në rritje të vdekshmërisë neonatale, duhet të merren masa për të rritur cilësinë e ndjekjes së shëndetit të gruas shtatzënë, por edhe kujdesit neonatal në të gjitha hallkat e shërbimit, përfshirë atë spitalor dhe të kujdesit shëndetësor parësor.

Lidhur me vaksinimin, puna duhet të vijojë për të siguruar vazhdimësinë dhe trajtuar barrierën e qëndrimeve mospranuese të prindërve/kujdestarëve, sidomos ndaj vaksinës së fruthit.

Identifikimi i hershëm i problemeve të zhvillimit ka mbetur problematik ndër vite, shoqëruar edhe me mungesën e shërbimeve të rehabilitimit.

Përparësi duhet të marrë mirëqenia/shëndeti mendor i prindërve/kujdestarëve dhe fëmijëve, si faktor kyç i mbarëvajtjes së fëmijëve. Trajtimi i stigmës, deri tek ngritja e shërbimeve të aksesueshme, të përshtatshme, të specializuara duhet të përfshihen në strategjitë përkatëse.

Sistemi shëndetësor përfaqëson mundësinë më të mirë për të identifikur dhe referuar rastet e dhunës të familje. Deri më tani, kjo mbetet shumë pak e realizuar.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, UNICEF-i, UNFPA-ja, World Vision, USAID-i, Qendra Shqiptare për Popullsi dhe Zhvillim.

OBJEKTIVI 11

Krijimi i mjedisit mbështetës për ofrimin e praktikave optimale të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Aktualisht, mbi 50 për qind e të gjithë materniteteve në Shqipëri janë certifikuar si Spitale Miqësore me Foshnjat, duke iu përmbajtur procesit me 10 hapa të ushqyerjes me gji brenda mjedisve të institucionit.

Në vitin 2017-2018, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë së Kombeve të Bashkuara (FAO) kryen *“Studimin e vlerësimit të statusit të ushqyerjes dhe njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të ushqyerjes tek adoleshentët”*. Gjithashtu, në 2019-n, në bashkëpunim me UNFPA-në, u realizua anketa *‘Sjelljet e shëndetshme tek fëmijët e moshës shkollore 11, 13 dhe 15 vjeç’*, që përbën një vlerësim të situatës dhe njohurive rreth ushqyerjes, si dhe qasjeve e praktikave të zakoneve të ushqyerjes tek fëmijët në moshë shkollore. Pranë ISHP-së, është ngritur sistemi i mbledhjes së

të dhënave për monitorimin e rritjes së fëmijëve, si dhe për praktikën e ushqyerjes, i cili mbledh informacion nga të gjitha konsultoret e fëmijës në shkallë vendi. Është trajnuar, përmes mbështetjes së UNICEF-it, 100% e personelit shëndetësor dhe, tashmë, përgatiten raportet vjetore me të dhëna në nivel kombëtar.

MSHMS-ja, MASR-ja, ISHP-ja, Ministria e Bujqësisë dhe UNICEF-i janë angazhuar për të rishikuar hartimin e standardeve të ushqyerjes së shëndetshme dhe tregtimit të ushqimeve në mjediset shkollore.

Në 2018-n, me vendim të Ministrit të MSHMS-së, u krijua Komiteti Kombëtar për Çrregullimet e Pamjaftueshmërisë Jodike. Bazuar në propozimet e këtij Komiteti, u dekretuan propozimet për ndryshimet ligjore¹²⁴ të lidhura me Ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008 i ndryshuar “Për parandalimin e


124. Ligji 12/2020 – Link

çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut". Këto ndryshime mbështeten në rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), Këshillit Ndërkombëtar për Kontrollin e Çrregullimeve të Mungesës së Jodit (ICCIDD) dhe UNICEF-it. Po përgatitet VKM-ja "Për përcaktimin e tarifave lidhur me mbulimin e shpenzimeve për marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike për përcaktimin e nivelit të jodit në kripën ushqimore të jodizuar", në zbatim të ligjit të sipërpërmendur, gjithashtu me ndihmën e UNICEF-it. Është organizuar një trajnim me pjesëmarrjen e 60 profesionistëve nga NJVKSH-te, me synim zhvillimin e kapaciteteve institucionale, në zbatim të Ligjit të lartpërmendur.

Për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave nga monitorimi i kripës ushqimore të jodizuar, janë shpërndarë 12 kompjuterë për Laboratorët Rajonalë të Shëndetit Publik në 12 qarqe dhe janë furnizuar me kite të shpejtë NJVKSH-të në të gjithë vendin.


PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020

STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)




INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 11 është rreth 20.4 milionë lekë¹²⁵, ose 1.3% e kostonë së përgjithshme të Agjendës. 61.7% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët.

Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

125. Shifra e plotë 20 450 000


STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 40% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 6 masa (ose 60%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të parealizuara nga institucionet.

Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 21.2% e shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për Objektivin 11. 62.3% e shpenzimeve faktike është realizuar me fonde të donatorëve dhe 37.7% me fonde të buxhetit të shtetit.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Në vijim, merr përparësi hartimi dhe zbatimi i planit të komunikimit për ndryshim të praktikave të ushqyerjes, apo monitorimit të zbatimit të strategjive dhe ligjeve ekzistuese për ushqyerjen.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoritë Rajonale të Operatorit Shëndetësor, OBSH-ja, UNFPA-ja, UNICEF-i, FAO-ja dhe organizata të tjera partnere.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në %126	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ¹²⁷	4 332 500	21.2%	4 332 500	100%	37.7%	62.3%
2 Mosrealizim ¹²⁸	16 117 500	78.8%				
Gjithsej	20 450 000	100%				

126. Përqindjet janë rrumbullakosura

127. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

128. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

OBJEKTIVI 12

Përmirësimi i sistemit shëndetësor dhe shërbimeve që ofrohen për adoleshentët, duke i bërë ato miqësore

ARRITJET KRYESORE

Edukimi seksual dhe promovimi i sjelljeve të shëndetshme rezultojnë të jetë zbatuar me integrimin dhe vënien në jetë të kurrikulës mbi edukimin gjithëpërfshirës të shëndetit seksual (klasat 4-12). MASR-ja raporton se është përgatitur paketa kurrikulare dhe janë realizuar trajnime ToT për edukimin seksual në 13 DAR . MSHMS-ja synon të rishikojë udhërrëfyesit dhe protokollet klinike për kujdesin e shëndetit të adoleshentëve dhe të rinjve.

Së fundmi, MASR-ja ka strukturuar organizimin e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore¹²⁹. Tashmë, për çdo 500-700 nxënës, do të jetë në mbështetje një psikolog/punonjës social; kjo edhe në rastet kur shkolla ka, të paktën, 10 nxënës me aftësi të kufizuara. Tashmë, në sistemin e arsimit parauniversitar, janë 174 punonjës socialë dhe 429 psikologë të kualifikuar.

Në shërbim të fëmijëve në sistemin arsimor publik, janë të angazhuar 2 086 personel mjekësor (108 mjekë, 109 stomatologë dhe 1 869 infermierë), ndërsa në sektorin arsimor privat, rreth 96 personel mjekësor (37 mjekë, 15 stomatologë dhe 44 infermierë)¹³⁰.


Është miratuar nga Komiteti Teknik i Ekspertëve Udhëzimi 543/1, dt. 21.08.2020, "Mbi kujdesin dhe masat kundër COVID-19-s në strukturat arsimore parauniversitare për vitin shkollor 2020-2021". Këtu përcaktohet bashkëpunimi i koordinatorit mjekësor, epidemiologut të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, mjekut të familjes dhe shkollës për të trajtuar çdo rast të nxënësve apo mësuesve me shenja të infektimit nga COVID-19, si dhe për hetimin e thelluar epidemiologjik të gjurmimit të kontakteve brenda dhe jashtë shkollës. Në mbështetje të zbatimit të këtij Udhëzimi, është rritur me 30% numri i epidemiologëve në terren.

129. Link

130. Vetëm 27 të marrë privatisht nga këto institucione


PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)



INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 12 është rreth 166.4 milionë lekë¹³¹, ose 10.2% e kostonë së përgjithshme të Agjendës. 59.2% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiivi janë planifikuar me fonde të donatorëve dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit. Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** vetëm për një masë të kostuar/buxhetuar, ndërsa, për 7 masa (ose 87.5%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të porealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



131. Shifra e plotë 166 380 000

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMITË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në % ¹³²	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ¹³³	1 350 000	0.8%	4 525 000	335.2%	29.8%	70.2%
2 Mosrealizim ¹³⁴	165 030 000	99.2%				
Gjithsej	166 380 000	100%				

Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 2.7% e shpenzimeve të planifikuara totale për objektivin 12. 70.2% e shpenzimeve të raportuara janë financuar nga donatorët.

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Përparësi mbetet puna për hartimin e udhërrëfyesit dhe protokollat klinike për kujdesin e shëndetit të adoleshentëve dhe të rinjve, me fokus të veçantë grupet më vulnerabël.

Deri më tani, nuk është trajtuar mjaftueshëm shëndeti mendor i adoleshentëve, si një aspekt i rëndësishëm i mirëqenies së tyre. Për më tepër, në kushtet e pandemisë së COVID-19-s dhe në vazhdim. Ky element i shëndetit duhet të trajtohet në Strategjinë e Shëndetësisë dhe atë të Agjendës së Fëmijëve 2021-2025, me qëllim për të reflektuar integrimin e masave në të gjithë sektorët/fushat që punojnë me fëmijët/adoleshentët.

Siç trajtohet edhe në Objektivin 11, aspekti i ushqyerjes së shëndetshme të adoleshentëve duhet të qaset me masa konkrete, në ndërveprim me të gjithë aktorët e fushës.

Për shkak të grupmoshës, duhet pasur parasysh që, përkrah masave që kanë në fokus profesionistët, duhet të vendosen si përparësi ato që krijojnë mundësinë e ndërveprimit me adoleshentët dhe fuqizimin e aftësive të tyre.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit,

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

UNFPA-ja, UNICEF-i,

Qendra Shqiptare për Popullsi dhe Zhvillim.

132. Përqindjet janë rumbullakosura

133. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

134. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera


OBJEKTIVI 13

Fuqizimi i mekanizmave dhe kapaciteteve për të ofruar mbrojtje dhe përkujdes shoqëror më të mirë ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë

ARRITJET KRYESORE

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës¹³⁵ dhe ajo Buxhetit të Familjes¹³⁶ janë kryer çdo vit duke realizuar kështu masën e parashikuar në Agjendë. INSTAT-i, në përputhje me standardet statistikore evropiane, ka botuar treguesit e varfërisë relative për fëmijët dhe familjet me fëmijë. Gjithashtu, ka konsoliduar analizën krahasimore të të dhënave për fëmijët përmes përfshirjes së elementit të analizës krahasimore ndër vite¹³⁷.

GRAFIKU 7: PËRQINDJA E FËMIJËVE (0 - 17 VJEÇ), QË JANË NË RREZIK PËR TË QENË TË VARFËR



Mbështetur në vlerësimin e dinamikës së përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike¹³⁸, hartëzimit të transfertave të mbrojtjes sociale për familjet e varfra¹³⁹, Raportit të Vlerësimit të kontributit të UNICEF në Reformën e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror¹⁴⁰, Raportit të Zbatimit të

135. Link

136. Link

137. Link

138. Realizuar në vitin 2019, në bashkëpunim me Bankën Botërore, në kuadër të projektit “Modernizimi i Asistencës Sociale”

139. Link

140. Link

Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015-2020, MSHMS-ja, mbështetur nga UNICEF-i hartoi Planin e Veprimit dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale deri në 2023-shin. Kjo strategji përfshin tri reformat kryesore: atë të skemës së ndihmës ekonomike, të skemës së pagesës për aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e kujdesit shoqëror.

Është miratuar Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe ka nisur procesi i përgatitjes së akteve nënligjore në zbatim të këtij Ligji. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë mënyrën e dhënies së ndihmës ekonomike (NE), pagesave të aftësisë së kufizuar dhe bonusit të bebeve, si dhe të garantojë mbrojtje sociale për të gjithë qytetarët. Deri në shtator 2020-n, janë 88 321 fëmijë deri në moshën 18 vjeç anëtarë të familjeve që përfitojnë nga skema e NE-së; 598 fëmijë me status jetim trajtohen me NE, për 379 fëmijë të vendosur në shërbim kujdestarie, përfitohet pagesa e kujdestarisë. Nga skema e bonusit, për çdo të porsalindur (40 mijë lekë për fëmijën e parë, 80 mijë lekë për fëmijën e dytë dhe 120 mijë lekë për fëmijën e tretë), kanë përfituar prej vitit 2019 rreth 32 000 fëmijë dhe familje. Tashmë, familjet përfitojnë nga rritja me 50% e masës mesatare të NE-së, nga 3 500 deri në 5 600 lekë në muaj. Subvencionet shtesë të NE-së për familjet me fëmijë të vegjël për vaksinimin dhe arsimimin e tyre aplikohen çdo muaj. Kompensimet e energjisë elektrike akordohen çdo muaj për familjet dhe, po ashtu, marrin të gjitha përfitimet e tjera, si libra shkollorë falas, çerdhe e kopshte falas, banesa sociale, bursa për fëmijët që arsimohen etj., duke siguruar që, në çdo politikë të re, të kemi

mundësinë që t'i kthejmë në përparësi familjet e skemës së NE-së.

Në reagim të tërmetit të 26 nëntorit 2019, MSHMS-ja mbështeti 233 248 familje, të pastreha dhe ato që humbën banesat për shkak të tërmetit, me asistencë ushqimore dhe joushqimore, si asistencë strehimi, duke përfshirë dërgimin në banesë të pagesave të përfituara nga programi i mbrojtjes sociale dhe sigurimeve shoqërore, pakove ushqimore dhe joushqimore, si dhe barnave të rimbursueshme.

Në kushtet e pandemisë së COVID-19-s, nga skema e NE-së, rreth 63 510 familje përfituan dyfishin e pagesës së ndihmës ekonomike. Ndërsa 4 524 familje, të cilat kishin aplikuar për ndihmë ekonomike nga muaji korrik 2019 deri në mars 2020 dhe nuk kishin përfituar nga kjo skemë, pavarësisht se nuk bënë pjesë në skemën e NE-së, përfituan pagesë. Në tri Bashki (Shkodër, Durrës, Korçë), UNICEF-i mbështeti rreth 2 800 fëmijë (1 699 familje) me transferta të pakushtëzuara parash. Kjo ndërmarrje përbën gurin e themelit për ngritjen e sistemit të mbrojtjes sociale si përgjigje ndaj fatkeqësive. Për këtë kuadër/kontekst, u hartuan në bashkëpunim dhe me partnerë të ndryshëm Standardet e Procedurave të Veprimit.

Gjatë pandemisë, u siguruan paketa ushqimore për 17 381 fëmijë dhe 8 784 familje. Përmes mbështetjes së aktorëve të ndryshëm, u shpërndanë paketa higjieno-sanitare tek 207 337 fëmijë dhe 58 120 të rritur.

Ligji Nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror” është plotësuar nga 8 VKM dhe një sërë udhëzimesh¹⁴¹. Parashikimi i shërbimeve të reja apo riformulimi i shërbimeve ekzistuese, solli nevojën e rishikimit të paketës së standarteve të cilësisë së shërbimeve të mbrojtjes sociale. Gjatë periudhës së raportimit janë miratuar standardet për shërbimet e qendrat e menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale¹⁴², standardet për asistencën në shtëpi për personat me aftësi të kufizuar (përfshirë dhe fëmijët), ato për institucionet e përkujdesjes shoqërore për fëmijët 16-18 vjeç¹⁴³.

Fondi Social, si mekanizëm financimi për pushtetin vendor, dhe mënyrë prokurimi të shërbimeve sociale për OJF-të, u operacionalizua për herë të parë në 2019, përmes të cilit MSHMS disbursoi në prill 2020 tek 14 bashki për ngritjen e 14 shërbimeve të reja fondin 61 412 587 Lekë¹⁴⁴ dhe për 12 shërbime të specializuara në 6 qarqe me vlerë 62 000 000 Lekë; vlera totale e financimit për vitin 2020 shkon në **123 412 582** Lekë. Ndërkohë për vitin 2019-2020 (duke llogaritur që 5 shërbime filluan të financohen që në tetor 2019), vlera në total e financimit shkon në **149 195 353** Lekë. Për vitin 2020 konkretisht janë financuar 9 shërbime të reja për fëmijë në 9 bashki me vlerë 36 782 666 Lekë, nga 14 bashkitë përfituese. Synohet që deri në fund të vitit 2022 të financohen 35 bashki.

Ngritja dhe funksionimi i këtyre shërbimeve mbetet për t’u monitoruar në vijim. Gjithsesi, aktualisht, shërbimet e kujdesit shoqëror publik përbëjnë një përqindje të vogël (më pak se 6.4%) të shpenzimeve të përgjithshme për mbrojtje shoqërore.

Pavarësisht përmbushjes së kuadrit ligjor dhe pilotimit të një sërë nismash shërbimesh shoqërore në nivel vendor në vitin 2019, shërbimet për fëmijët zënë 27% të shërbimeve të ofruara nga shërbimet shoqërore publike, ku rreth 69 qendra sociale ofrojnë shërbime për fëmijë. Gjithashtu, 3 bashki, ose 71% e tyre, nuk kanë shërbime për fëmijë, 37 bashki, ose 61% e bashkive, nuk ofrojnë shërbime për individë me aftësi të kufizuara dhe 39 bashki, ose 64% e tyre, nuk ofrojnë shërbime për individë në nevojë.

Procesi i hartimit të planeve sociale ka qenë gjithëpërfshirës me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm me rol në garantimin e mbrojtjes sociale, përfshirë këtu mbrojtjen e fëmijëve. Procesi është kryer me mbështetje të ekspertizës së jashtme ofruar nga organizata të ndryshme si UNICEF-i, UNDP-ja, Save the Children, World Vision dhe ka shërbyer edhe si një mundësi ngritjeje kapacitetesh të aktorëve vendorë në mbledhje dhe analizim të dhënash për vlerësimin e nevojave dhe planifikimit të shërbimeve, mbështetur në nevojat dhe burimet vendore. Aktualisht, 50 Bashki kanë plane sociale të

141. Link

142. Link

143. Link

144. Qendra Multifunkionale për Zhvillimin e Fëmijëve dhe Fuqizimin e Familjeve (Kurbini, Sarandë, Vlorë); Shërbimi Lëvizës në Familje për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar (Peshkopi, Elbasan, Librazhd, Lezhë); Qendër Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar (Lushnje), Qendër Emergjence për Fëmijët në Situata Rreziku të Mënjëhershëm (Maliq); Qendër për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen (Durrës); Shërbime për Viktimat e Dhunës me Bazë Gjinore, ku do të trajtohen edhe fëmijët (Gjirokastrë).

buxhetuara dhe të miratuara; 10 Bashki nuk i kanë miratuar ende planet e tyre sociale, si dhe Bashkia Memaliaj nuk e ka filluar ende procesin e hartimit. Janë miratuar ndryshimet ligjore në ligjin “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”¹⁴⁵. Ka arritje në miratimin e VKM-së nr. 624, dt. 29.07.2020 “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”¹⁴⁶, si dhe VKM-së nr. 848, dt. 28.10.2020, “Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të veprimtarive të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre”¹⁴⁷, në zbatim të ligjit nr.121/2016.

Ndërkohë, Universiteti i Tiranës/Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, mbështetur nga UNICEF-i, ka ngritur Platformën për Mbrojtjen dhe Shërbimet Sociale në Shqipëri (sociale.al), me qëllim për t’iu mundësuar profesionistëve një burim informacioni të përditësuar për politikën në fushën e mbrojtjes dhe shërbimeve sociale, ligjet, standardet, protokollet dhe manualët e punës. Gjithashtu me asistencën e UNICEF-it është trajnuar i gjithë stafi social në 61 bashki “on-the job-training” për përdorimin e Sistemit Elektronik të Intëguar të Shërbimeve (MIS SHKSH).


145. Ligji Nr.141/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 163/2014, “Për urdhrin e punonjësve social në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

146. Link

147. Link


PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020

STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)




INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 13 është rreth 195.7 milionë lekë¹⁴⁸, ose 12.0% e koston së përgjithshme të Agjendës. 57.9% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti janë planifikuar të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët. 14.6% e koston së objektit është vlerësuar si hendek financiar.


Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për **shpenzimet faktike** për 72% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 7 masa (ose 38.0%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të porealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



Pesha e shpenzimeve të planifikuara për masat me status realizim është sa 94.9% e shpenzimeve të përgjithshme të planifikuara për Objektivin 13. 83.3% e shpenzimeve faktike të raportuara kanë si burim financimi buxhetin e shtetit. Për masën "Financimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror (që targetojnë fëmijët) në NJQV" janë raportuar shpenzime rreth 4.96 herë më të mëdha se planifikimi.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në % ¹⁴⁹	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim ¹⁵⁰	185 697 000	94.9%	231 515 629	124.7%	83.3%	16.7%
2 Mosrealizim ¹⁵¹	10 060 000	5.1%				
Gjithsej	195 757 000	100%				

148. Shifra e plotë 195,644,500

149. Përqindjet janë rumbullakosura

150. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

151. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e koston/buxhetit në raport me masat e tjera

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Baza e të dhënave me bazë anketat e INSTAT duhet të shfrytëzohen për të evidentuar nivelin e varfërisë multidimensionale tek fëmijët. Mbi gjithçka, prioritet duhet të ketë përdorimi i këtyre evidencave në hartimin e politikave për të adresuar varfërinë, sidomos në realitetin e pasojave të COVID-19.

Kostimi dhe financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror mbetet ende një sfidë; adresimi i të cilës do të thotë, mes të tjerash për pushtetin qendror: hartimin e kriterëve dhe metodologjisë së kostimit të shërbimeve, si edhe plotësimin me aktet nenligjore, (menjehere pas miratimit) të ligjit të prokurimeve, ku një kapitull më vete i është dedikuar procedurave të prokurimit të shërbimeve sociale .

Pushteti vendor i duhet të plotësojë detyrimin e planifikimit, ofrimit dhe monitorimit të shërbimeve të standardizuara dhe të specializuara për grupet e identifikuar në nevojë si p.sh:

- Programe të ndërhyrjeve të hershme të fuqizimit të familjeve për parandalimin e ndarjes së fëmijëve nga familja biologjike;
- Adresimi i problematikave që lidhen me praktikën e prindërimit pozitiv, shëndetin mendor të prindërve apo edhe të fëmijëve që më pas bëhen pjesë e sistemit rezidencial;
- Ngritja dhe menaxhimi i shërbimeve të specializuara për fëmijët në nevojë për mbrojtje (si p.sh. për fëmijët viktime të abuzimit seksual, viktime të trafikimit, fëmijët/

adoleshentët përdorues të substancave abuzive, etj) si dhe të qendrave të emergjencës.

- Gjetja e zgjidhjeve për financimin e shërbimeve, duhet të shoqërohet me:
- Ngritjen e strukturave të vlerësimit të rastit dhe referimit në të gjitha NjQV;
- Fuqizimin e kapaciteteve të këtyre strukturave, përfshirë në fushën e menaxhimit të fondeve.

Për më tepër, duhet të pilotohen, të paktën në disa NjQV, modele/praktika të ofrimit të plotë të shportës së shërbimeve shoqërore, në bashkëveprim me skemat e ndihmës ekonomike, dhe të vlerësimit të ri biopsiko-social të aftësisë së kufizuar. Kështu do të hidheshin hapat drejt konsolidimit të sistemit të integruar të mbrojtjes shoqërore.

Aktualisht, monitorimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror ndodh nga disa aktorë: Strukturat e shërbimeve sociale në nivel vendor¹⁵², Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRSHSSH), nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror (DPSHSSH), Avokati i Popullit, audite të ndryshëm, etj. Inspektimit kryhen nga Inspektoriati i Shërbimeve Sociale. Gjatë periudhës së raportimit, nuk ka ndryshime të strukturave monitoruese (DPSHSSH & DRSHSSH) dhe inspektuese (Inspektoriati), duke shënuar mozbatimin e masave të planifikuara në Agjende. Gjithësesi, Bashkia duhet të ngrejë përsëpari strukturat e saj, si autoriteti përgjegjës për vlerësimin e nevojave, ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve.

152. Për ato shërbime që operojnë brenda territorit të tyre

Në lidhje me kategorinë e fëmijëve të grupmoshës 15 – 18 vjeç pa kujdesin e duhur prindëror dhe nën kujdes rezidencial, rekomandohet të ngihet një model që të synojë aftësimin për jetën dhe përgatitjen e tyre për jetesë të pavarur, bazuar dhe në procesin e deinstitutionalizimit të filluar tashmë me shërbimet publike të përkujdesit për fëmijë, por që duhet të shtrihet dhe në shërbimet jopublike rezidenciale. Zgjidhja e dhënë me ndarjen e kësaj grupmoshe dhe krijimin e një shërbimi të ri në nivel kombëtar përdor sërish sistemin rezidencial të shërbimit dhe jo një shërbim alternativ. Përveç kësaj, ngritja e një qendre kombëtare për këtë grupmoshë që pret të rinj nga gjithë territori i Shqipërisë, sjell si rrjedhojë edhe problemet dhe traumat e shkëputjes së marrëdhënie sociale e emocionale të fëmijës/të rinjve nga një ambient i njohur.

Nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuar duhet të marrin prioritet si përmes përmirësimit të skemës së pagesës për aftësinë e kufizuar edhe përmes shërbimeve shoqërore për këtë grup fëmijësh.

Për të adresuar në mënyrë efektive situata të tjera emergjence, duhet të vazhdojë puna për ngritjen dhe integrimin e skemes së transfertave humanitare në kesh, si pjesë e sistemit të mbrojtjes shoqërore.

Mbetet prioritet profesionalizimi i forcës së punës dhe ofruesve të shërbimeve sociale, nëpërmjet krijimit të një sistemi të kualifikimit, supervizimit, mbështetjes, licensimit, akreditimit dhe mbledhjes/ raportimit të të dhënave.

Së fundmi, nevojitet dokumentimi/vlerësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të reja që po zbatohen nga aktorë të ndryshëm, si p.sh. Shërbimin Lëvizës “Tungjatjeta Jetë” për fëmijët me aftësi të kufizuar (Bashkitë Librazhd, Dibër dhe Lezhë me organizatën Eorld Vision), apo shërbimi “Shtëpia e Gjyshes/ Shtëpia Tjetër” (Bashkitë Tiranë, Kamëz, Elbasan dhe Shkodër me OJF ‘Të ndryshëm & Të barabartë). Kjo do të ndihmonte në nxjerjen e mësimave të nevojshme dhe replikimin e atyre modeleve që rezultojnë efektive.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Njësitë e Qeverisjes Vendore, UNICEF-i, UNDP-ja, Banka Botërore, Save the Children, World Vision, Santa di Frontiera, Terre des Hommes.

OBJEKTIVI 14

Fuqizimi i familjes për të trajtuar rreziqet e pasojat e varfërisë dhe parandaluar ndarjen e fëmijës nga familja

ARRITJET KRYESORE

Nga shqyrtimi i planeve sociale, gjatë shqyrtimit të 41 aplikimeve të ardhura (Nëntor 2020), në kuadër të aplikimit për financim nga Fondi Social për vitin 2021, lidhur me burimet shtesë njerëzore në sektorin e përfshirjes sociale në bashki, për vitin 2019-2020 janë raportuar 127 nëpunës vendorë. Kapacitetet njerëzore në bashki janë rritur me nëpunës shtesë dhe në sektorët e administrimit, monitorimit dhe vlerësimit të ndihmës ekonomike (NE) me rreth 131. Shtesat në staf kanë ndodhur vetëm në 25 bashki.

Gjithësesi, sektori i vlerësimit të nevojave dhe referimit është funksional vetëm në 39% të bashkive. Në disa njësi administrative nuk arrihet kriteri numerik i vendosur nga ligji për caktimin e një punonjësi social apo një punonjësi të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve; në raste të tjera, si rezultat i burimeve financiare të pamjaftueshme, administrata vendore funksionon me një numër minimal punonjësish duke ngarkuar një person me më shumë se një detyrë.

Është plotësuar kuadri ligjor për ngritjen e ndërmarrjeve sociale përmes miratimit të VKM-ve dhe Urdhërave të nevojshëm për zbatimin e Ligjit nr. 65/2016 datë 9.6.2016 *‘Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë’*¹⁵³. Ndër to mund të përmendim miratimin e VKM nr. 56, datë 31.1.2018 *‘Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara’*, e cila krijon mundësinë për punësimin e individëve/familjeve që kanë vështirësi integrimi në tregun e punës, duke i dhënë përparësi kategorisë përfituese të ndihmës ekonomike, familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar dhe të atyre në kujdes rezidencial. Deri në mars 2020, kanë përfituar statusin e ndërmarrjes sociale 8 OJF¹⁵⁴.

Në zbatim të VKM-së nr. 882, datë 24.12.2019 *‘Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike’* është përgatitur Plani i Masave për zbatimin e programit të daljes nga skema e ndihmës ekonomike 2020-2022, i cili është miratuar me urdhër të përbashkët të

153. Link

154. Për 2019, Shoqata “Prindërit e fëmijëve autike” ka marrë statusin e ndërmarrjes sociale

Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

“Programi i daljes” ka si qëllim promovimin e integritit në jetën shoqërore të familjeve përmes programeve të nxitjes së punësimit, aftësimin profesional dhe shërbimeve sociale, në mënyrë që kjo skemë të mos përdoret si një mekanizëm përfitimi që mund të çojë në papunësi të zgjatur tek familjet përfituese të ndihmës ekonomike dhe ta shndërrojë atë në një skemë aktive, për shkak se ky është një përfitim i kufizuar në kohë (5 vite). Kjo realizohet përmes një mekanizmi ndër-institucional, i cili është Plani i Veprimit Individual (PIV), ku administratori social duhet të bashkëpunojë me NJVNR-të dhe agjentët e punësimit. Në zbatim të kësaj skeme në vitet 2018-2019, janë punësuar 5,697 individë dhe kanë kryer kurse të formimit profesional 846 individë, pjesë e skemës së ndihmës ekonomike.

Në Shqipëri, janë gjithsej 9 Institucione të Përkujdesit Shoqëror (IPSH) publike për fëmijë, 18 jopublike për fëmijë dhe 5 qendra zhvillimi për PAK-un. Në tetor 2020 raportohet se 223 (91F dhe 132M) fëmijë pa kujdesin prindëror janë në sistemin rezidencial në 9 IPSH publike; 76 fëmijë në 5 qendra zhvillimi për PAK (42 F dhe 34M). Numri i fëmijëve pa kujdes prindëror që jetojnë në institucionet rezidenciale është zvogëluar në krahasim me vite më parë.

Por, në vitin 2019, ka një ulje të numrit të fëmijëve të rikthyer në familje biologjike nga IPSH-ja

publike. Kjo ulje vjen si rrjedhojë e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore për t’u shprehur me vendim për qëndrimin apo rikthimin në familje të fëmijëve të pranuar si raste emergjente dhe, njëkohësisht, punës së pamjaftueshme nga strukturat vendore për fuqizimin e familjeve të këtyre fëmijëve.

379 është numri i fëmijëve të vendosur në familje kujdestare deri në Shtator 2020. Shumica dërrmuese e rasteve të kujdestarisë janë me lidhje gjaku dhe vetëm 10 raste familjesh pa lidhje gjaku. Asnjë NJQV nuk ka hartuar dhe miratuar listën e familjeve kujdestare pa lidhje gjaku.

Në kuadër të Lgjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” dhe Ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” janë miratuar të paktën 5 VKM dhe 6 Udhëzime, të cilat trajtojnë dhe rregullojnë aspekte apo faza të institucionalizimit, si dhe mbështetjen apo mbrojtjen që i jepet fëmijës, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme rezidenciale dhe/ose komunitare. Në Shtator 2020 është miratuar [Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022](#)¹⁵⁵ edhe pse zbatimi i këtij plani nisi më herët, në kuadrin e fushatës #fëmijëttëparët#. Gjatë kësaj faze (të parë) 9 skuadra terreni, të mbështetura nga UNICEF dhe Save the Children përfunduan vlerësimin dhe hartimin e planeve individuale tranzicioni dhe zhvillimi për 232 fëmijë në sistemin rezidencial publik, si dhe vlerësimin ekonomik-social për 144 familje (prindër dhe familjarë të tjerë). Gjetjet e vlerësimit dëshmojnë se 85% e fëmijëve të

155. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 9.9.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, 2020–2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij”

vendosur në IPSH publike kanë familjen biologjike, me të cilat ruajnë kontakte; gjithsesi koha e qëndrimit të tyre në institucion është më tepër se dy vite. Për më tepër, Mbi 30% e fëmijëve rezidentë janë viktime të neglizhimit, abuzimit dhe shfrytëzimit. 70% e fëmijëve të vlerësuar kanë vonesa në zhvillim. Institucionet nuk ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e tyre moral, psikologjik dhe emocional.

Analiza e kuadrit ligjor në fuqi me fokus kujdesin alternative dhe deinstitutionalizimin u realizua me qëllimin identifikimin e problematikave të mundshme që krijojnë pengesa apo vështirësi në procesin e deinstitutionalizimit të fëmijëve nga qendrat rezidenciale. Gjetjet dhe rekomandimet do të sjellin një rakordim më të mirë ndërmjet ligjeve të ndryshme, si dhe një përmirësim të procedurave të kujdesit alternativ.

Ministria e Drejtësisë inicioi procesin e ndryshime të ligjit të birësimeve, si dhe të Kodit të Familjes, për të përmirësuar procesin e birësimeve dhe sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri.


Në mbështetje të zbatimit të mëtejshëm të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, është ngritur Komiteti drejtues ndërinstitucional, koordinues e mbikqyrës, përbërja dhe funksionet e të cilit janë të përcaktuara me Urdhrin e Ministrit Nr. 156/2020. Grupi i ekspertëve, në bashkëpunim me institucionet qëndrore, në cilësinë grupit teknik të punë, mbështetur nga UNICEF, ka hartuar: 3 modele të reja

shërbimesh dhe procedurash (Qendra për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen, Shërbimi i Kujdestarisë Alternative Profesionale si edhe Udhëzues i Procedurave për Deinstitutionalizimin e Fëmijëve), të cilat pritet të dakortësohen nga komiteti drejtues dhe të miratohen, si dhe më pas të zbatohen (pilotohen gjatë vitit 2021).

Janë ngritur skuadrat e koordinimit vendor (SVK), ku fokusi i takimeve ka qenë diskutimi i rasteve specifike që mund të jenë potenciale për të nisur procesin e ribashkimit, zhvillimin e vlerësimeve të familjeve, ndjekjes së hapave sipas procedurave gjyqësore, menaxhimin e rasteve, mbështetjes së stafit të IPSH dhe profesionistëve të shërbimeve sociale, zhvillimit të planit të zhvillimit individual për secilin fëmijë, nxitjen e takimeve ndërsektoriale sipas nevojës së çdo rasti, dhe sigurimi i shërbimeve mbështetëse të nevojshme.

PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA


STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË NR. & %)




Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

156. Vendimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 548, date 01.10.2020 "Për ngritjen dhe funksionimin e komitetit drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020-2022"

STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (NË NR. & %)




STATUSI I BUXHETIMIT/KOSTIMIT TË MASAVE NË AGJENDË (NË NR. DHE %)



TREGUESIT E REZULTATIT 2017-2020


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (NË NR. DHE %)



Institucionet kanë dhënë informacion për

shpenzimet faktike për 77.8% të masave të kostuara/buxhetuara, ndërsa, për 2 masa (ose 22.2%), nuk raportohen shpenzime. Këto të fundit korrespondojnë me masat e kostuara dhe të raportuara si të porealizuara nga institucionet.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE ME INFORMACION FINANCIAR (NË NR. DHE %)



INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për Objektivin 14 është rreth 6 milionë lekë¹⁵⁷, ose 0.4% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 63.4% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti është planifikuar të mbulohet nga donatorët dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit.

Informacioni mbi burimet e financimit dhe shpenzimet, i raportuar nga institucionet përgjegjëse, është si më poshtë:

Niveli i shpenzimeve të raportuara është sa 106.5% e shpenzimeve të planifikuara për masat e realizuara. Për një masë të financuar nga donatorët, janë raportuar shpenzime faktike më shumë se sa planifikimi. Shpenzimet e realizuara nga donatorët janë në masën 79.8% të shpenzimeve faktike për masat e realizuara. Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 94% e shpenzimeve të planifikuara të përgjithshme për Objektivin 14.

157. Shifra e plotë 6,035,000

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA, MASAT E REALIZIMITË SHPENZIMEVE DHE BURIMI I FINANCIMIT

	Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet të planifikuara në %158	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Donatorët
1	Realizim ¹⁵⁹	5 322 500	77.8%	5 670 500	106.5%	20.2%	79.8%
2	Mosrealizim ¹⁶⁰	712 500	22.2%	0			
	Gjithsej	6 035 000	100%				

REFLEKTIME PËR TË ARDHMEN

Mungesa dhe fuqizimi, aty ku ekzistojnë, i stafëve lokale sociale dhe mungesa e burimeve financiare të nevojshme në dispozicion sjellin vështirësi në identifikimin e hershëm e proaktiv të rasteve të familjeve në nevojë për mbështetje dhe ofrimin të shërbimeve. Qëndron nevoja e mbështetjes për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës dhe NJVNR në mënyrë që të zhvillohen dhe implementohen planet shumëdimensional të fuqizimit të familjes, të cilat adresojnë nevojat e fëmijës dhe familjes sikurse dhe menaxhimin e rastit. Për më tepër nevojitet sigurimi i ndërhyrjeve dhe mbështetjes direkte për secilin rast të vlerësuar në nevojë (adresimi i nevojave të veçanta, shërbimeve shëndetësore, mbështetjes për edukim).

Sfidë mbetet zhvillimi dhe sigurimi i implementimit të planeve të transformimit gradual jo vetëm të të 9 IPSH-ve (Institucione të Shërbimeve të Përkujdesit) publike, po dhe ato jo publike, në shërbime multidisiplinare e multifunkionale për fëmijën dhe familjën, duke zbatuar interesin më të lartë të fëmijës. Kjo do të kërkonte, zgjatjen e Planit ekzistues Kombëtar të Deinstitutionalizimit, përtej 2022, me buxhet të nevojshëm, me qëllim shtrirjen e procesit në të gjithë vendin. Prioritet kryesor mbetet përmirësimi i kuadrit ligjor, përfshirë ndryshimet në Kodin e Familjes, jo vetëm duke u

përqëndruar në aspektet që lidhen me birësimin, por për të adresuar në mënyrë adekuate të gjitha boshllëqet dhe pengesat që janë evidentuar në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve por edhe nën kontekstin e reformave të vazhdueshme legjislative siç është ajo administrative, e drejtësisë penale për të mitur, legjislacioni i shërbimeve shoqërore. Ngritja e shërbimit të kujdestarisë profesionale; zbatimimi i planeve individuale për fëmijët në institucionet rezidenciale; transformimi i qendrave aktuale rezidenciale (pilotimi Korçë dhe Vlorë) në qendra të shërbimeve mbështetëse për familjet me fëmijë; ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimit për të mbuluar profesionalisht këto shërbime- janë prioritetet afatshkurtra.

Një vëmendje të veçantë (prioritizim) i duhet dhënë nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendrat e zhvillimit, duke filluar nga vlerësimi më i detajuar i rasteve dhe hartimit të planeve individuale. Fokusi do të jetë hartimi dhe zbatimimi i modelit të shërbimit për jetesë gjysëm të pavarur dhe të pavaruar (për fëmijët mbi 14 vjeç përfshirë fëmijët me AK).

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, UNICEF-i, Save the Children, Nisma për Ndryshim Shoqëror - ARSIS, Bethany Social Services.

158. Përqindjet janë rumbullakosura

159. Në kontekstin e informacionit financiar, statusi 'realizim' i referohet ndërmarrjes së, të paktën, një veprimi, në kuadër të masës së përcaktuar

160. Masat e mosrealizuara janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e kostos/buxhetit në raport me masat e tjera

SHTOJCAT

Shtojca 1

Lista e institucioneve raportuese

Institucione në nivel qendror:

Institucioni
Parlamenti/ Grupi parlamentar Miqtë e Fëmijëve
Avokati Popullit
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve
Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale
Shërbimi Social Shtetëror
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Ministria e Drejtësisë
Drejtoria e Burgjeve
Shërbimi i Provës
Ministria e Kulturës
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural/ AKU
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
INSTAT
AKCESK
AMA

Organizata të Shoqërisë Civile:

Organizata
Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
Nisma për Ndryshim ARSIS
Plan & Go
Save the Children
Terre des Hommes
Të Ndryshëm & të Barabartë
Vatra
World Vision
UNICEF
Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve

Institucione në nivel vendor:

Institucioni
Belsh
Bulqizë
Cërrik
Delvinë
Divjakë
Finiq
Fushë-Arrëz
Gjirokastër
Gramsh
Himarë
Kamëz
Kavajë
Klos
Kolonjë
Korçë
Krujë
Kuçovë
Kukës
Kurbin
Lezhë
Librazhd
Lushnjë
Maliq
Mat
Mirditë
Patos
Peqin
Përrenjas
Pukë
Pustec
Roskovec
Sarandë
Shijak
Skrapar
Shkodër
Tepelenë
Tiranë
Tropojë
Ura Vajgurore
Vau i Dejës
Vlorë
Vorë

2017-2020

**RAPORTI
4-VJEÇAR
I ZBATIMIT**

TË AGJENDËS KOMBËTARE
PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

